




Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosova  
Qeveria -Vlada-Government



Ministria e Punëve të Brendshme  
Ministarstvo Unutrašnjih Poslova  
Ministry of Internal Affairs

Agjencia e Menaxhimit Emergjent  
Agencija o Upravljanju Vanrednim Situacijama  
Agency of Emergency Management



# VLERËSIMI I RREZIQEVE NGA FATKEQËSITË NATYRORE DHE FATKEQËSITË TJERA

Prishtinë  
Korrik, 2016



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosova  
*Qeveria -Vlada-Government*



**Ministria e Punëve të Brendshme**  
*Ministarstvo Unutrašnjih Poslova*  
*Ministry of Internal Affairs*

**Agjencia e Menaxhimit Emergjent**  
*Agencija o Upravljanju Vanrednim Situacijama*  
*Agency of Emergency Management*

# VLERËSIMI I RREZIQEVE NGA FATKEQËSITË NATYRORE DHE FATKEQËSITË TJERA

---

Prishtinë  
Korrik, 2016

## Përmbajtja

PARATHËNIE.....	4
VENDIM.....	4
I. VLERËSIMI I RREZIQEVE SI PJESË PËRBËRËSE E MBROJTJES DHE SHPËTIMIT NË REPUBLIKËN E KOSOVËS.....	6
II. PROFILI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS .....	7
2.1. Përkufizimi i shtetit .....	7
2.2. Pozita gjeografike, karakteristikat.....	8
2.3. Relievi .....	9
2.4. Klima e Kosovës.....	10
2.5. Reshjet atmosferike.....	10
2.6. Hidrografia .....	12
2.7. Përbërja pedologjike .....	14
2.8. Ndërtimi gjeologo-tektonik i Kosovës .....	15
2.9. Karakteristikat litostratigrafike.....	15
2.10. Bota bimore dhe shtazore .....	17
III. EKONOMIA E KOSOVËS .....	18
3.1. Treguesit ekonomik.....	18
3.2. Të ardhurat dhe zhvillimi shoqëror .....	18
3.3. Bujqësia.....	20
3.4. Energjia.....	21
3.5. Integrimet ekonomike dhe tregtia me jashtë .....	21
3.6. Transporti dhe komunikacioni .....	22
3.7. Telekomunikimi .....	22
IV. DEMOGRAFIA .....	23
4.1. Statistikat .....	23
4.2. Arsimimi .....	25
V. VLERËSIMI I RREZIQEVE .....	27
5.1. Krijimi i profilit të rreziqeve .....	27
VI. RREZIQET NATYRORE.....	30
6.1. Zjarret .....	30
6.2. Vërshimet.....	34
6.3. Tërmetet .....	40
6.4. Rrëshqitjet .....	47
6.5. Rrokullisjet e masave shkëmbore në territorin e Kosovës.....	50
6.6. Rreziqet tjera natyrore.....	52

VII. RREZIQUET NGA FATKEQËSITË TJERA.....	54
7.1. Deponitë nga industria minerare .....	54
7.2. Zonat e spostimeve dhe ngritjeve (Gjeo-rreziqet në minierat aktive dhe ato të braktisura) .....	57
7.3. Shpërthimet e pendave .....	58
VIII. RREZIQUET NË INFRASTRUKTURËN KRITIKE .....	61
8.1 Teknologjia Informativë.....	62
IX. RREZIQUET NË OBJEKTET KOLEKTIVE .....	65
9.1. Profili i rrezikut .....	65
X. RREZIQUET NË NDËRTESAT TEKNIKE TË NDJESHME - INFRASTRUKTURA TEKNIKE .....	68
10.1. Profili i rrezikut .....	68
XI. RREZIQUET GJATË TRANSPORTIT .....	72
11.1. Transporti rrugor .....	72
11.2. Transporti hekurudhor .....	73
11.3 Transporti rrugor me materie të rrezikshme .....	75
11.4 Transporti ajror .....	78
XII. RREZIQUET INDUSTRIALE .....	82
12.1 Energjia .....	82
12.2 Aksidentet industriale .....	95
12.3.Mbetjet industriale dhe të rrezikshme .....	96
XIII.RREZIQUET EPIDEMIOLOGJIKE .....	99
13.1 Rreziku i ndotjeve ( hedhjeve ) në ujë .....	99
13.2 Helmimet me ujë .....	100
13.3 Helmimet me ushqim.....	102
13.4 Gripi pandemik .....	104
13.5. Ethet Hemorragjike - Krime Kongo .....	105
13.6. Bruceloza.....	106
13.7.Tularemia .....	107
XIV. TRASHËGIMIA KULTURORE.....	110
14.1 Gjendja aktuale .....	110
XV. STRUKTURAT PËR MBROJTJE, SHPËTIM DHE NDIHMË.....	112
15.1 Kategorizimi i SSHMN-ve .....	112
XVI. VLERËSIMET PËRFUNDIMTARE.....	113
XVII. HARTAT .....	115
Legjislacioni .....	145

## PARATHËNIE

Dokumenti i Vlerësimit të Rreziqeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera në Republikën e Kosovës, bazohet në Ligjin Nr.04/L-027, si dhe në Rregulloren Nr. 28 / 2012 për Metodologjinë e Hartimit të **Vlerësimit të Rrezikshmërisë**.

Me këtë dokument identifikohen kërcënimet nga rreziqet në Republikën e Kosovës, si dhe bëhet vlerësimi i shkallës së rrezikshmërisë së tyre. Gjithashtu, me këtë vlerësim identifikohen mundësitë dhe nevojat për parandalimin, zvogëlimin e rreziqeve, reagimin, rimëkëmbjen dhe evitimin e pasojave nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera. Ky vlerësim, shërben si bazament për Planin e Reagimit Kombëtar në nivel qendror, si dhe Hartimin e Vlerësimit të Rreziqeve në nivel lokal, duke përfshirë resurset humane dhe teknike, shtetërore, private si dhe të OJQ-ve, me qëllim të mbrojtjes dhe shpëtimit të jetës së qytetarëve të Republikës së Kosovës nga fatkeqësitë natyrore, tekniko-teknologjike dhe faktori njeri.

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Brendshme, në mbështetje të nenit 145 ( paragrafi 2), të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenin 38 të Ligjit Nr.03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës, (Gazeta Zyrtare Nr.82, 21 tetor 2010 ), dhe neni 17 ( 5 dhe 6 ) të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive ( Gazeta Zyrtare , Nr 1/18 prill 2011), si dhe në mbështetje të nenit 44 ( paragrafi 2 ), të Ligjit nr. 04/L-027 për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera, ( Gazeta Zyrtare, Nr.22/19, tetor 2011, nxjerr:

## VENDIM

1. Themelohet Grupi Punues për rishikimin e dokumentit të Vlerësimit të Rreziqeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera, si dhe gjendjen emergjente në nivel vendi.
2. Grupin Punues nga pika 1 e këtij vendimi e përbëjnë:
  - 2.1. Nijazi Miftari – AME/MPB /kryesues;
  - 2.2. Hajriz Sejdiu – AME/MPB / anëtar;
  - 2.3. Muhamet Pllana - AME/MPB / anëtar;
  - 2.4. Hava Zeqiri - AME/MPB / anëtare;
  - 2.5. Përfaqësuesi i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal /anëtar;
  - 2.6. Përfaqësuesi i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik/anëtar;
  - 2.7. Përfaqësuesi i Ministrisë së Infrastrukturës /anëtar;
  - 2.8. Përfaqësuesi i Ministrisë së Shëndetësisë/anëtar;
  - 2.9. Përfaqësuesi i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural /anëtar;
  - 2.10. Përfaqësuesi i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor/anëtar;
  - 2.11. Përfaqësuesi i Ministrisë së Administratës Publike/anëtar;
  - 2.12. Përfaqësuesi i Ministrisë së Arsimit , Shkencës dhe Teknologjisë/anëtar;
  - 2.13. Përfaqësuesi i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit /anëtar;
  - 2.14. Përfaqësuesi i Ministrisë së Drejtësisë/anëtar;
  - 2.15. Përfaqësuesi i Ministrisë Komunitet dhe Kthim /anëtar;
  - 2.16. Përfaqësuesi i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë/anëtar;
  - 2.17. Përfaqësuesi i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale /anëtar;
  - 2.18. Përfaqësuesi i Koorporatës Energjetike të Kosovës /anëtar;

- 2.19. Përfaqësuesi i Kryqit të Kuq të Kosovës /anëtar;
- 2.20. Përfaqësuesi i Policisë së Kosovës;
- 2.21. Përfaqësuesi i Departamentit të Ujërave;
- 2.22. Përfaqësuesi i Institutit Hidro-meteorologjik të Kosovës;
- 2.23. Përfaqësuesi i Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik;
- 2.24. Përfaqësuesi i Agjencionit të Veterinës dhe Ushqimit;
- 2.25. Përfaqësuesi i Doganës së Kosovës;
- 2.26. Përfaqësuesi i Entit Sizmik të Kosovës;
- 2.27. Përfaqësuesi i Aeroportit Ndërkombëtar të Kosovës” Adem Jashari”;
- 2.28. Përfaqësuesi i Agjencisë së Mbrojtjes Kundër Rrezatimit;
- 2.29. Përfaqësuesi i Fakultetit të Fizikës;
- 2.30. Përfaqësuesi i Institutit të Mjekësisë së Punës;
- 2.31. Përfaqësuesi i Institutit të Onkologjisë.

3. Grupi punues obligohet ta përgatis dokumentin e vlerësimit të rrezikshmërisë nga pika 1 e këtij vendimi dhe dokumentet tjera përcjellëse, ashtu siç kërkohet me legjislacionin përkatës në fuqi.

4. Detyrat dhe përgjegjësitë e Grupit Punues janë:

Përgatitja e programit të punës,  
 Përgatitja e prezantimeve dhe prezantimi i tyre në nivelin qendror dhe lokal,  
 Themelimi grupit gjithëpërfshirës ndër-qeveritar për Hartimin e Vlerësimit të Rreziqeve,  
 Distribuimi i dokumenteve përfundimtare dhe dikasterëve përkatës, si dhe  
 Detyra tjera që dalin nga ky Udhëzim Administrativ.

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, më dt. 12.06.2014 ,nr. 391.



# I. VLERËSIMI I RREZIQEVE SI PJESË PËRBËRËSE E MBROJTJES DHE SHPËTIMIT NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

## Hyrje

Fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera (FNFT) të shkaktuara nga dukuritë natyrore apo nga faktori njeri, mund të rrezikojnë jetën e njerëzve, kafshëve, të mirat materiale, ambientin, infrastrukturën kritike dhe trashëgiminë kulturore. Dukuritë dhe fenomenet, qofshin ato natyrore apo të shkaktuara nga faktori njeri, manifestohen me rreziqe dhe paraqesin sfida me të cilat ballafaqohet njerëzimi. Prandaj, vlerësimi dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërmarrja e masave, veprimeve dhe aktiviteteve për parandalimin e tyre, është një nga prioritetet e Qeverisë së Republikës së Kosovës. Të gjitha vendet e botës janë të ekspozuara nga rreziqet të cilat në shkallë dhe përmasa të ndryshme paraqesin kërcënim për sigurinë fizike, pasurinë dhe interesat e vendit.

Në të gjitha periudhat e zhvillimit të njerëzimit, vende dhe rajone të ndryshme kanë qenë të prekura nga fatkeqësitë e ndryshme siç janë: tërmetet, vullkanet, stuhitë, shtrëngatat, ciklonet, vërshimet, përmytjet, orteqet, shembjet, rrëshqitjet, eksplozimet, etj..., të cilat janë manifestuar me përmasa dhe pasoja nga më të ndryshmet. Komuniteti, i vetëdijshëm për efektet dhe pasojat e këtyre rreziqeve çdo ditë e më shumë është duke i kushtuar rëndësi të veçantë vlerësimit dhe menaxhimit të FNFT-së dhe vënies nën kontroll të tyre.

Agjencia e Menaxhimit Emergjent bazuar në misionin, detyrat, përgjegjësitë si dhe në Rregulloren me Nr 28/2012 për Metodologjinë e Hartimit të Vlerësimit të Rrezikshmërisë, në bashkëpunim me institucionet qendrore, lokale, OJQ-të, si dhe palët tjera të interesit, ka hartuar draft/dokumentin: Vlerësimi i Rreziqeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera, përmes të cilës synon identifikimin, vlerësimin dhe ndërmarrjen e masave parandaluese dhe zbutjen-zvogëlimin e tyre. Rishikimi dhe plotësimi me të dhëna të reja i dokumentit të vlerësimit të rreziqeve është bërë në harmoni dhe rekomandime të dokumentit paraprak të hartuar në vitin 2009.

## II. PROFILI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS

### 2.1. Përkufizimi i shtetit

Republika e Kosovës është shtet i pavarur, sovran, demokratik, unik, dhe i pandashëm. Republika e Kosovës ushtron autoritetin e saj bazuar në respektimin e të drejtave dhe lirive të qytetarëve të vet dhe të gjithë individëve brenda kufijve të saj.

#### **Forma e Qeverisjes**

Kosova është Republikë demokratike e bazuar në parimin e ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancimit në mes tyre.

**Kuvendi i Republikës** - ushtron pushtetin legjislativ.

**Presidenti i Republikës** së Kosovës përfaqëson unitetin e popullit.

Presidenti i Republikës së Kosovës është përfaqësues legjitim i vendit brenda, jashtë dhe garantues i funksionimit demokratik të institucioneve të Republikës së Kosovës, në pajtim me Kushtetutën.

**Qeveria e Republikës së Kosovës** është përgjegjëse për zbatimin e ligjeve e politikave shtetërore dhe i nënshtrohet kontrollit parlamentar.

**Pushteti gjyqësor** është unik, i pavarur dhe ushtrohet nga gjykatat.

**Gjykata Kushtetuese** është organ i pavarur i mbrojtjes së kushtetutshmërisë dhe bën interpretimin përfundimtar të Kushtetutës.

Republika e Kosovës ka institucionet e veta për mbrojtjen e rendit kushtetues dhe të integritetit territorial, rendit dhe qetësisë publike, të cilat funksionojnë nën autoritetin kushtetues të institucioneve demokratike të Republikës së Kosovës.

#### **Spektori i Sigurisë**

Republika e Kosovës ka pushtet mbi zbatimin e ligjit, sigurinë, drejtësinë, sigurinë publike, inteligjencën, organet civile emergjente dhe mbi kontrollin e kufijve në territorin e vet.

#### **Forca e Sigurisë e Kosovës**

Forca e Sigurisë e Kosovës është forcë kombëtare e sigurisë për Republikën e Kosovës, dhe mund të dërgoj pjesëtarët e saj jashtë vendit në përputhje të plotë me përgjegjësitë e saj ndërkombëtare.

#### **Këshilli i Sigurisë së Kosovës**

Këshilli i Sigurisë i Republikës së Kosovës, në bashkëpunim me Presidentin e Republikës së Kosovës dhe Qeverinë, përgatit Strategjinë e Sigurisë për Republikën e Kosovës.

Këshilli i Sigurisë i Republikës së Kosovës ka edhe rol këshillues në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me sigurinë në Republikën e Kosovës.

#### **Policia e Kosovës**

Policia e Republikës së Kosovës mbanë përgjegjësinë për ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

Policia e Republikës së Kosovës është profesioniste dhe pasqyron shumëllojshmërinë etnike të popullit të Republikës së Kosovës.



## Agjencia e Kosovës për Inteligjencë

Agjencia e Kosovës për Inteligjencë zbulon, heton dhe mbikëqyr kërcënimet ndaj sigurisë në Republikën e Kosovës.

Agjencia e Kosovës për Inteligjencë është profesioniste, politikisht e paanshme, shumetnike dhe i nënshtrohet mbikëqyrjes nga Kuvendi.

## Prania Ndërkombëtare

Prania Ndërkombëtare Ushtarake ka mandatin dhe kompetencat e përcaktuara nga instrumentet relevante ndërkombëtare.

KFOR-i si pjesë përbërëse e aleancës ushtarake të NATO-s ka mandatin dhe përgjegjësin për mbrojtjen dhe sigurinë e Kosovës.

EULEX: Mision i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX) në kuadër të Politikës Evropiane për Mbrojtje dhe Siguri.

## Qeverisja Lokale dhe Organizimi Territorial

Njësi themelore e vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës është komuna.

Komunat gëzojnë shkallë të lartë të vetëqeverisjes lokale dhe inkurajojnë e sigurojnë pjesëmarrje aktive të të gjithë qytetarëve.

## Ndarjet Administrative

Pushteti vendor në Republikën e Kosovës ndahet në dy nivele: qendror dhe lokal, ndërsa ushtrohet nga 38 njësi komunale, të përqendruara në qytete dhe qyteza.<sup>1</sup>

## 2.2. Pozita gjeografike, karakteristikat

Republika e Kosovës ndodhet në pjesën Juglindore të Evropës, gjegjësisht në pjesën qendrore të Gadishullit Ballkanik (Ballkani Përendimor). Shtrihet në gjerësi gjeografike veriore prej 41°50' 58'' deri 42°15' 42'', dhe gjatësi gjeografike lindore prej 20°01'02'' deri 21°48'02'' (Plani hapësinor i Kosovës 2010-2020+). Ka sipërfaqe prej 10908 km<sup>2</sup>, kufizohet me: Shqipërinë, Maqedoninë, Serbinë dhe Malin e Zi. Në Republikën e Kosovës jetojnë 1.739.825 banorë dhe me dendësi prej 159 banorë/ km<sup>2</sup>, kufiri i saj me vendet fqinje kryesisht kalon nëpër male dhe ka karakter natyror.

**Tabela 1: Gjatësia e kufijve të Kosovës me shtetet fqinjë**

Shteti fqinjë	Gjatësia në km
Shqipëria	112 km
Maqedonia	161 km
Mal i Zi	77 km
Serbia	352 km
Totali	702 km


Republika e Kosovës me rajonin lidhet përmes rrjetit të transportit rrugor, hekurudhor dhe ajror. Pesë rrugë me Serbinë, dy me Maqedoninë dhe tri me Shqipërinë.

Kryeqyteti i Kosovës nga qendrat tjera të Gadishullit Ballkanik është: 90 km nga Shkupi, 120 km nga Nishi, mbi 200 km nga Sofja, rreth 300 km Tirana dhe rreth 350 km nga Beogradi.

<sup>1</sup> Shih në aneks hartën nr 1 .Ndarja administrative e komunave të Republikës së Kosovës

### 2.3. Relievi

Relievi i Kosovës përbëhet prej vargmaleve, maleve, fushëgropave dhe luginave (të krijuara me lëvizje tektonike, forma erozive dhe akumulative), etj. Rreth 63% të territorit është e mbuluar nga malet të cilat ndahen në disa grupe: malet periferike, qendrore, të larta, të mesme dhe të ulëta, ndërsa 37% mbulohet nga fusha dhe lugina.



*Harta nr.2. Relievi i Kosovës*

Malet periferike kanë pozitë skajore në formë të vargmaleve, grup maleve dhe maleve të veçuara të cilat shtrihen brenda dhe jashtë territorit të Kosovës. Në grupin e maleve periferike bëjnë pjesë: Alpet Shqiptare (Bjeshkët e Nemuna), Malet e Hasit me Pashtrikun, Malet e Sharrit me Koritnikun, Malet e Karadakut, Malet Lindore të Gallapit (Gollakut), Kopaoniku dhe Rogozna.

Malet qendrore janë male të ulta, janë të veçuara ose në grup male dhe shtrihen në brendësi të territorit të Kosovës, në mes Rrafshit të Kosovës dhe Rrafshit të Dukagjinit. Këto male në jug dhe në veri lidhen me Malet e Sharrit dhe Malin e Thatë, ndërsa në mes ndahen nga Fusha e Drenicës. Malet qendrore të Kosovës i përbëjnë: Caraleva, Lipovica, Goleshi, Berisha, Kosmaçi, Drenica dhe Çiçavica, të cilat shtrihen në lartësi mbidetare nga 800 m deri 1200 m. Kanjoni i Lumit Mirusha e ndan grupin e maleve, që shtrihen në jugperëndim të maleve qendrore e të cilat përbëhen prej maleve: Gajrak, Zatriq, Bajrak dhe Gremnik, me lartësi mbidetare e cila luhet nga 706 m deri 1039 m.

**Tabela 2. Majet kryesore në malet e Kosovës.**

Majet	Regjioni	Lartësia në metra (m)
Gjeravica	Pejë	2656
Bistra	Ferizaj	2640
Marjashi	Pejë	2530
Luboteni	Ferizaj	2496
Mali i Strelcit	Pejë	2377
Mali i Lumbardhit	Pejë	2335

Fushat dhe luginat përbëjnë një Reliev të lëshuar i cili është me fushëgropa, lugina lumore, lugina akullnajore, morena, pllaja, lugina grykore dhe forma tjera.

Nga fushëgropat më tipike janë: Fushëgropa e Dukagjinit, Fusha e Kosovës, e Llapit, Drenicës dhe e Anamoravës.

Pasuria tokësore – rreth 53% është tokë bujqësore, 41,8% janë tokë pyjore dhe 5.2% janë sipërfaqe tjera (e ndërtuar dhe ujore).

## 2.4. Klima e Kosovës

Kosova shtrihet në pjesën jugore të brezit të mesëm gjeografik të gjysmë-sferës veriore dhe i nënshtrohet ndikimeve klimatike mesdhetare-kontinentale dhe evropiane-kontinentale. Makro faktorët kryesorë klimatikë, të cilët ndikojnë në klimën e Kosovës janë: pozita e saj ndaj masave tokësore (Evropia dhe Afrika), masat ujore (Oqeani Atlantik dhe Deti Mesdhe), masat e ajrit (tropike dhe arktikemaritime apo kontinentale), pozita e sistemeve barike (maksimumi i azoreve dhe minimumi i Islandës). Faktorët lokal kryesor që ndikojnë në klimën e Kosovës janë: relievi, ujërat, trualli dhe bimësia.

Pjesa lindore e Kosovës, Fushëgropa e Kosovës, e Llapit, e Drenicës dhe e Ana-Moravës është më e ftohtë se sa ana perëndimore ( Rrafshi i Dukagjinit). Temperatura mesatare vjetore e Kosovës është 9.5°C. Muaji më i nxehtë është korriku (19.2°C) kurse muaj më i ftohtë është janari (-1.3°C). Temperatura mesatare vjetore më e larta është në Prizren (12°C), kurse më e ulëta në Podujevë (9°C).

## 2.5. Reshjet atmosferike

Në Kosovë paraqiten të gjitha format e reshjeve atmosferike. Rëndësinë më të madhe e kanë reshjet e shiut nëpër lugina dhe reshjet e borës në viset e larta malore.

Në pjesën lindore arrijnë sasinë mesatare vjetore prej 600 mm, ndërsa në pjesën perëndimore mbi 700 mm. Reshjet e borës paraqiten në pjesët e ulëta të Kosovës mesatarisht me kohëzgjatje prej 26 ditëve, kurse në viset malore mbi 100 ditë.

**Tabela 3: Sasitë mesatare të reshjeve në disa vendbanime të Kosovës 1948-1978.**

Nr	Lokacioni	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	mes/vjetore
1	Prishtinë	35	35	34	51	72	73	47	43	48	54	62	51	598
2	Prizren	65	56	59	61	72	59	58	38	65	62	79	73	747
3	Pejë	97	71	71	64	76	63	53	42	53	85	114	101	886
4	Mitrovicë	42	40	40	46	60	68	48	41	44	54	67	58	608
5	Gjilan		39	36	36	45	73	63	47	41	43	55	64	51
6	Gjakovë	108	90	78	74	75	47	52	43	75	90	123	127	981
7	Kamenicë	44	40	40	39	58	61	49	38	43	51	58	49	570
8	Podujevë	39	42	37	51	70	68	52	40	49	56	67	51	632
9	Lipjan	44	40	41	52	71	72	50	45	51	54	62	55	633
10	Rahovec	59	58	53	58	69	65	54	40	67	68	84	77	753
11	Skenderaj	45	43	35	47	60	49	52	42	43	54	71	59	600
12	Suharekë	49	47	50	57	76	66	48	41	59	59	67	65	687
13	Ferizaj	49	45	49	52	80	71	62	49	52	60	68	55	688
14	Vushtrri	45	41	35	45	61	62	50	48	48	65	67	57	615
15	Kaçanik	80	66	69	68	94	70	63	43	59	77	90	79	858

**Erërat**

Shpejtësia mesatare e erërave në Kosovë luhet midis 1.3 m/s (në Pejë) deri në 2.4 m/s (në Ferizaj). Shpejtësia maksimale e erërave arrin 31 m/s dhe zakonisht në muajt mars dhe prill. Në shumë lokalitete në Kosovë erërat kanë emërtime lokale.

**Tabela 4. Drejtimi i erës, shpejtësia mesatare mujore dhe vjetore (2005).**

Muajt	Drejtimi	Mujore	Vjetore
Janar	VP	1.1	
Shkurt	VP	1.5	
Mars	JP	1.7	
Prill	JP	2.3	
Maj	VP	1.8	
Qershor	JP	1.2	1.4m/s
Korrik	VRB	1.2	
Gusht	VRB	1.3	
Shtator	VP	1.1	
Tetor	VP	1.4	
Nëntor	VP	1.6	
Dhjetor	VP	1.4	



## Diellosja/Ditët me diell

Në bazë të vrojtimeve të diellosjes në katër stacionet metrologjie (Prishtinë, Ferizaj, Prizren, Pejë), Kosova ka mesatarisht 2066 orë me diell gjatë vitit ose mesatarisht 5,7 orë në ditë. Vlera më e lartë e diellosjes e regjistruar në Prishtinë është 2140 orë /vit(h/v) dhe më e ulta në Pejë: 1958 orë /vit (h/v). Gjatë vitit në muajin korrik ka më së shumti diellosje, kurse në dhjetor më së paku.

## 2.6. Hidrografia

Pjesa më e madhe e territorit të Kosovës i takon ujëmbledhësit të Detit të Zi (50,7%), pjesa tjetër (43,5%) i takon ujëmbledhësit të Detit Adriatik dhe pjesa e vogël prej 5,8% i takon ujëmbledhësit të Detit Egje. Ujëmbledhësit të Detit të Zi i takojnë lumenjtë: Sitnica, Ibri, Drenica, Llapi, Morava e Binçës dhe Krivareka. Ujëmbledhësit të Detit Adriatik i takojnë lumenjtë, Drini i Bardhë me degët: Lumi i Istogut, Pejës, Deçanit, Ereniku, Lumi i Prizrenit, Toplluha, Mirusha, Klina, Lumi i Pllavës dhe Restelicës në Opojë e Gorë, ndërsa ujëmbledhësit të Detit Egje i takojnë Lepenci dhe Nerodimja.

Brenda hapësirës territoriale të Kosovës janë të ndërtuara pesë akumulime sipërfaqësore të ujit: Gazivoda(Ujëmani), Batllava, Badovci, Përlepnicë, Livoqi i Epërm dhe Radoniqi. Ujërat minerale dhe termominerale kanë një shpërndarje në gjithë territorin e vendit por si më të njohura janë: uji termomineral në Kllokot, Ilixha/Pejë, Runik, Velekincë dhe Miresh/Gjilan. Në tabelën nr 5 janë paraqitur lumenjtë sipas gjatësisë dhe sipërfaqes së tyre<sup>2</sup>, ndërsa liqejtë akumulues në Kosovë në tabelën nr 6.<sup>3</sup>

2 Referenca: AKMM, 2010. Raport i Gjendjes së Ujërave në Kosovë, Prishtinë.

3 Referenca: Master Plani për Ujërat e Kosovës 1983-2000. Libri 1 Akumulacionet, Fletorja 1 Akumulacionet sipërfaqësore, MMPH –DU, Prishtinë.

Tabela 5. Karakteristikat e ujërrjedhave dhe ujëmbledhësve në Kosovë

Lumi	Sipërf. (S) km <sup>2</sup>	Gjatësia e lumit (L) km	Prurja (Q) m <sup>3</sup> /s	(q) l/sek/km <sup>2</sup>	Pjerrësia %	Perimetri i Pellgut (Km)	Rrjedhja vjetore x10 <sup>6</sup> (m <sup>3</sup> )	Reshjet efektive (mm)	Reshjet mesatare (mm)	Koeficienti i rrjedhës	Derdhja në Detin
Drini i Bardhë	4340.14	110.7	61.7		2.1	409.8	1946	452.5	900	0.508	Detin Adriatik
Sushica	49.4	17.25			9.4	32			1150		
LB.Pejë	464.8	57	10.21	24.13	2.5	128	200.66	760.1	1168	0.651	
LB.Deçanit	259.3	53	7.84	42.46	3.2	105	152.46	1337.4	1530	0.874	
Ereniku	519.3	51.74	12.16	26.73	3.9	109	383.04	841.8	1515	0.716	
Istogu	405.3	19.74	6.98		4.5	87			1200		
Klina	458.7	72.12	2.8	4.92	4.5	126	65.52	154.9	750	0.221	
Mirusha	336.7	37	1.661		1.7	83			700		
Toplluha	495	34.05	3.44		3.5	108			1000		
LB.Prizrenit	247.8	36.07	6.49	29.68	7.4	77	147.74	935.1	960	0.974	
Plava, Restelic	341.86	22.12	5.25	20.79	5.9	90.56	165.06	655	1080	0.644	
<b>Totali i pellgut</b>	<b>4682</b>	<b>110.7</b>	<b>61.01</b>		<b>2.1</b>	<b>409.8</b>	<b>1946</b>	<b>452.5</b>	<b>900</b>	<b>0.508</b>	
Ibri	4044.21	89.50	36.4	6.39	0.3	436.8	1148	218.4	782	0.301	Detin e Zi
Sitnica	2912	78	13.94	5.38	1.1	276	439.11	169.5	690	0.258	
M.Binçes	1564	76	8.7	5.99	1.5	216	330	188.8	736	0.256	
Kriva Reka	640.70	44.5	4.43	7.27	1.2	128	139.55	229.1	736	0.311	
Lepenci	653	50	8.4	14.91	4.6	130	190	469.8	912	0.516	Deti Egje
Nerodime	209.4	38.5			2.1	81.5			750		
<b>Totali i përgjithshëm</b>	<b>10 907.00</b>		<b>121.2</b>				<b>3.8*10<sup>6</sup></b>				

Tabela. 2. Të dhënat themelore për lumenjtë dhe pellgjet ujore<sup>10</sup>

10 Përpunuar nga Master Plani për Ujërat e Kosovës



**Tabela 6. Liqejtë akumulues në Kosovë.**

Rezervuari	Lumi	Sipërfaqja e Ujëmbledhësit	Vëllimi Milion [m <sup>3</sup> ]		Viti i ndërtimit	Lartësia e digës	Territori i ujitur nga sistemi	Destinimi		
			Shfrytëzues	Gjithsej				Për Ujitje	Ujë të pijes	Industri
Gazivoda/ Ujmani	Ibër	1060	350	390	1979	101	Zubin Potok Mitrovicë Vushtrri Prishtinë Skenderaj Drenas	20000 ha	Po	Po
Batlava	Batlavë	226	25.1	30	1960	46	Prishtinë Podujevë	Jo	Po	Po
Badovci	Graçanicë	103	20	26.4	1963	45	Prishtinë	Jo	Po	Po
Livoç	Livoç	53.6	-	-	-	-	Gjilan	Jo	jo	jo
Radoniq	Përrue	130	102	116.6	1982	61	Gjakovë, Rahovec, Prizren	10000 ha	Po	Jo
Prilepicë	Prilepicë	62	-	-	1982	40	Gjilan	Jo	Po	Jo
Gjithsej		1634.6	497.1	563						

(Raporti për gjendjen e ujërave 2015, AKMM, MMPH).

## 2.7. Përbërja pedologjike

Pjesa më e madhe e territorit ( 56%) është e mbuluar me toka të cilësisë së dobët, një pjesë tjetër e konsiderueshme (29%) është me toka të cilësisë mesatare dhe pjesa më e vogël (15%) me toka të cilësisë së mirë.

Tokat e dobëta shtrihen në relievin kodrinor-malor dhe janë krijuar me procesin e alterimit, erodimit dhe akumulimit të shtresave të materialit skeletor-guror e ranor. Tokat e mesme dhe të mira janë të lidhura për procesin e akumulimit të materialit të imët të liqenit neogjen dhe lumit në luginat e lumenjve, sidomos në rrjedhat e mesme dhe të poshtme të tyre. Në pjesën e rrafshët të Kosovës shtrihen edhe tokat më cilësore, sidomos në fundin e liqenit neogjen, rrafshet aluviale të lumenjve.

Tokat e cilësisë së mirë dhe mesatare zënë rreth 44% të fondit të tokës dhe ato përbëhen prej tokave humusore – 11% kryesisht në Rrafshin e Dukagjinit, tokave të murrme karbonate – 8,4%, aluviale 7,8%, smonicave, renzinave dhe tokave të zeza në shkëmbinj të serpentinerë. Pjesa më e madhe e sipërfaqeve me toka të dobëta përbëhen prej tokave të murrme të tharta, tokave aluviale skeletore, moçalore dhe tokave të tjera jopjellore.

Tokat e mira të cilat i shërbejnë prodhimtarisë bujqësore gjithnjë e më shumë po mbulohen me vendbanime, rrugë, objekte ekonomike e shërbyese. Në bazë të vlerësimeve mendohet se për çdo vit humbin 2000 ha tokë pune bujqësore. Rreth 1000 ha sipërfaqe bujqësore humbin përgjithmonë nga erozioni. Pjesa më e madhe e territorit të Kosovës ka pjerrtësi të vogël, të mesme ose të madhe, e cila goditet nga erozioni. Çdo vit nga Kosova në dete barten rreth 1.9 milion m<sup>3</sup> materie.

## 2.8. Ndërtimi gjeologo-tektonik i Kosovës

Kosova karakterizohet me një ndërtim mjaft kompleks gjeologjik, e përfaqësuar me shkëmbinjë me përbërje dhe vjetërsi të ndryshme gjeologjike, si dhe me struktura të ndryshme tektonike, shkëputëse dhe rrudhosëse. Shkëmbinjët më të vjetër janë ata të Parakembrit, Paleozoikut, Mezozoikut, Kenozoikut, ndërsa më të ri janë ata të Kuarternarit. Kjo shumëllojshmëri shkëmbore që na prezantohet në Kosovë dhe e cila ka regjistruar momente më të rëndësishme të zhvillimit gjeodinamik përbën një bazë të mirë të interpretimeve mbi zhvillimet gjeologjike që kanë ndodhur në Ballkan.

Duke u bazuar në studimet mbi ndërtimin gjeologjik të Kosovës, autorë të ndryshëm pranojnë ndarjen rajonale tektonike të Kosovës si me poshtë:

1. Masivi Dardan (Masivi Serbo-Kosovar-Maqedonas).
2. Zona e Vardarit:
  - Nën zona e brendshme e Vardarit,
  - Nën zona qendrore e Vardarit,
  - Nën zona e jashtme e Vardarit.
3. Zona e Sharrit:
  - Njësia e Drino-Ivanicës.
4. Zona Ofiolitike Qendrore.
5. Zona e Durmitorit.

## 2.9. Karakteristikat litostratigrafike

Në ndërtimin gjeologjik të Kosovës marrin pjesë një numër i madh i komplekseve litologjike, duke filluar nga Parakembri në Kuarternar.

**Formimet Proterozoike** janë shkëmbinjët më të vjetër të Kosovës, janë rreshtet kristalore të masës Dardane, që shtrihen në lindje të Kamenicës dhe Karaçevës. Ky kompleks i takon moshës së Rifej-Kembrianit, i ndërtuar prej gnajseve dhe leptinoliteve, mikashisteve, leukognejseve, amfiboliteve, kuarciteve dhe migmatiteve.

**Formimet Paleozoike** janë mjaft të përhapura në Kosovë dhe të zbuluara në Bjeshkët e Sharrit, Bjeshkët e Nemuna, Malet e Moknës dhe në rrethin e Trepçës.

**Formimet Paleozoike** të Bjeshkëve të Sharrit i takojnë Paleozoikut të poshtëm. Në përbërje të kësaj serie hyjnë: rreshtet kristalore me përbërje të ndryshme (epidot-aktinolite, klorit-sericitike, albit-klorit-sericitike dhe filitike), me ndërshtresa të gëlqerorëve me ortoceratide, krinoide dhe korale, pastaj kuarcitet, metakonglomeratet, shkëmbinjët bazik të metamorfizuar, granitoidet, gnejs-granatet etj. Seria Paleozoike e Bjeshkëve të Nemuna, është e zhvilluar në facien e shkëmbinjëve bazik të metamorfizuar dhe rreshtet e gjelbërta e sericitike, klorit-sericitike dhe klorite, të facies pelitike me metamorfizim të ulët, psefiteve dhe psamiteve me gëlqeror kristalor. Paleozoiku i Bjeshkëve të Thata dhe Moknës është zbuluar nën shkëmbinjët e Triasikut të poshtëm, i përfaqësuar me argjilohiste, filite, ranorë të metamorfizuar, gëlqerorë të mermerizuar, konglomerate, gabroide, diabaze, kuarc-keratofire, kuarc-porfire dhe piroklastite. Në rrethin e Trepçës, formimet e Paleozoikut të sipërm janë të përfaqësuar me rreshtet e gjelbërta, argjilofilite, argjilite me stralle, mermere dhe kuarcite.

**Formimet e Mesozoikut** kanë përhapje të konsiderueshme në territorin e Kosovës, ku Kretaku dhe Triasiku janë më të përhapur në raport me Jurasikun.

Triasiku është i përhapur në tri zona: Zonën e Vardarit, Zonën e Ofioliteve Qendrore dhe Zonën e Sharrit. Triasiku në Zonën e Vardarit është i përhapur në tre breza, me shtrirje VP-JL. I pari është brezi i Artanës (Novobërda), i cili shtrihet nga Artana deri në Preshevë.

Brezi i dytë shtrihet përmes Zonës së Vardarit dhe brezi i tretë shtrihet në pjesën perëndimore të Zonës së Vardarit, përgjatë anës perëndimore të Fushës së Kosovës. Triasiku në këtë zonë është i përfaqësuar me rreshpe me përbërje kuarcite, mermere, gëlqerorë të metamorfizuar, kuarcite dhe shkëmbinj magmatik. Triasiku komplet është identifikuar në rrethin e Trepçës. Triasiku ka një përhapje të madhe në Zonën e Ofioliteve Qendrore (Bjeshkët e Nemuna, Bjeshkët e Thata dhe Mokën). Triasiku i poshtëm është i përfaqësuar me konglomerate kuarcore, ranorë, argjilite, gëlqerorë bankorë të pasur me faunë, ranorë petëzor-argjilor, argjilite ranorike dhe gëlqerorë rreshpor të metamorfizuar me ngjyrë të zezë. Triasiku i mesëm në këtë territor është i përfaqësuar me serinë vullkanogjeno-sedimentare, gëlqerorët dhe dolomitet, përderisa Triasiku i sipërm është i përfaqësuar me gëlqerorë, gëlqerorë dolomitik dhe dolomite.

Në Zonën e Sharrit, Triasiku gjithashtu ka një përhapje të madhe, i cili është i identifikuar në pjesën e Koritnikut, Cvilenës, Lumbardhin e Prizrenit, Oshlanit, në një pjesë të Dragashit të izoluar dhe rreth Drinit të Bardhë. Në këtë pjesë Triasiku përfaqësohet me gëlqerorë të nuancave të ndryshme. Kontakti me sedimentet e Jurasikut është tektonik.

Formimet jurasike janë të përhapura kryesisht në Zonën e Vardarit, të shprehura në formën e dy brezave, të cilët në mes veti janë të ndara prej formimeve të Kretakut me shkëputje tektonike. Me studime paleontologjike është identifikuar vetëm Jurasiku i sipërm, i përfaqësuar nga gëlqerorët, ranorët, formacioni diabazo-strallor, metamorfitet dhe serpentinitet. Produktet Jurasike janë të zbuluara përgjatë rrjedhës së Drinit të Bardhë (afër Prizrenit), të përfaqësuar prej melanzhit olistostromik (argjillat me shkallë të ulët të metamorfizimit, argjilofilitet, argjiloshistet, strallet, diabazet, spilitet dhe keratofiret). Në rajonin e Brezovicës Jurasiku është i përfaqësuar prej ultramafiteve, shkëmbinjve metamorfik dhe melanzhi olistostromik.

Shkëmbinjte magmatik të Jurasikut janë të përfaqësuar nga ultrabazitet, granitet, diabazet, spilitet dhe gabrot, të cilët i takojmë në rajonin Mushtisht-Korishë, Ostrovicë, Masivi i Gjakovës dhe Rahovecit, të përfaqësuar me dunitet, harzburgite, serpentinite dhe peridotitet e serpentinizuar dhe me prezencën e dajkave piroksenite e gabroide.

**Formimet e Kretakut** janë mjaft të përhapura në territorin e Kosovës. Në kuptimin paleogeografik, sedimentet e Kretakut janë të formuar në kuadër të Zonës së Vardarit dhe Zonën e Ofioliteve Qendrore. Një brez i gjërë i formimeve të Kretakut shtrihet nëpërmes Zonës së Vardarit, duke filluar nga Rogozna, në perëndim të Mitrovicës, përmes Çiçavicës, Drenicës, Goleshit dhe Carralevës ku futen nën sedimentet e Basenit Neogjenik të Kosovës, prej ku vazhdon në Grykën e Kaçanikut drejt Maqedonisë. Këto formime i takojnë Kretakut të sipërm dhe shtrihen në mënyrë transgresive mbi ultramafitet e Jurasikut dhe përfaqësohen nga konglomeratet, ranorët, gëlqerorët, gëlqerorët mergelore dhe flishi. Brezi i mesëm shtrihet nga Kopauniku, në lindje të Prishtinës, Hajvalisë, Janjevës dhe në juglindje të Moravës së Binçës. Brezi i tretë shtrihet prej Artanës, nëpër Podujevë, drejtë veriut. Këta breza përfaqësohen nga formimet e Kretakut të poshtëm dhe të sipërm. Në kuadër të Ofioliteve Qendrore, sedimentet e Kretakut të sipërm ndërtojnë pjesët anësore të Basenit të Dukagjinit dhe Pashtrikut. Këto sedimente përfaqësohen nga shkëmbinjte e ndryshëm dhe bien në mënyrë transgresive mbi ultramafitet apo mbi formimet e Palezoikut të ri.

**Formimet e Terciarit** mbushin ultësirat tektonike të Dukagjinit, Kosovës, Drenicës, Llapit dhe Gjilanit, ku me hulumtime paleontologjike janë konstatuar Oligoceni, Mioceni, dhe Plioceni. Produktet vullkanogjene ndërtojnë rajonin e Stantergut, Kishnicë-Janjevës, Moravës së Binçës dhe Strezovc-Artanës.

**Formimet e Oligocenit** janë zbuluar në rajonin e Moravës së Binçës, të përfaqësuar me gëlqerorë numulitik, mergele, argjila karbonatike, ranorë, konglomerate, brekçie vullkanike, leucite dhe trahite. Në Basenin e Strezovcit Oligoceni është i përfaqësuar me sedimente liqenore (ranorë, argjila, mergele, gëlqerorë dhe konglomerate) dhe produkte vullkanike (andezite, tufe vullkanike dhe brekçie). Këto produkte shtrihen edhe në rrethin e Trepçës, Dubovcit (seria magnezitbartëse) dhe Drenicës.

Formimet e Neogjenit janë të përfaqësuara me sedimentet e Miocenit dhe Pliocenit, me shtresa të thengjillit dhe produktet vullkanogjene.

Depozitimet e Miocenit mbushin Basenin e Dukagjinit, Gjilanit, Moravës së Binçës dhe Krivarekës dhe janë të përfaqësuara prej argjilave alevrolitike, argjilave ranorike dhe mergelore, konglomerateve heterogjene, ranorëve, argjilave me ndërshtresa stralore, gëlqerorëve argjiloro-mergelor, tufeve dhe rrallë prej piroklastiteve e produkteve vullkanogjene.

Depozitimet Pliocenike, të cilat janë liqenore dhe të ujrave të ëmbël, në mënyrë transgresive mbulojnë formacionet Miocenike dhe mbushin basenet e Dukagjinit, Kosovës dhe Drenicës. Këto sedimente janë të përfaqësuara me konglomerate, argjila ranorike me konkrecione karbonatike, rrallë ranore (dysHEMEJA e thengjillit), pastaj argjilla mergelore, sedimente ranoro-argjilore dhe rrallë me ndërshtresa të gëlqerorëve silicoro-bigror (mbulesa e thengjillit), si dhe shtresa e thengjillit me trashësi të madhe.

Depozitimet Kuaternare mbulojnë fushat e rrafshata dhe shtretërit e lumenjëve të Drinit të Bardhë, Sitnicës dhe Moravës së Binçës, të përfaqësuara me sedimentet e teracave lumore, produkteve aluviale, proluviale, deluviale dhe morenave<sup>4</sup>.

## 2.10. Bota bimore dhe shtazore

### Bota bimore

Bashkësia e bimëve livadhore është mjaft e pasur, sidomos në pjesën perëndimore, ku ka më shumë livadhe e kullosa për shkak të reshjeve më të shumta dhe mundësisë së ujitjes së sipërfaqeve. Drunjtë endemik të vjetërsisë terciare janë disa: rrumbulli, armeni, pisha e bardhë, pisha e zezë dhe selvia. Në pjesët e rrafshata dhe shpate, në sipërfaqet e pa kultivuara, rritet shpargu (lloj bungu), ahu, qarri, lisi, dardha e egër, murrizi, thana, trëndafili i egër etj. Në viset bregore më e përhapur është bashkësia e ahut. Në Kopaonik, në disa bashkësi të vogla pyjore, haset dëllinja dhe ulza. Në zonën kalimtare prej fushës në viset bregore haset bashkësia e bagremit, pastaj mani i bardhë, mani i zi, lisi i zi, rrapi, plepi kanadez, dafina, frashri etj.

### Bota shtazore

Në zonën fushore e kodrinore haset iriqi lindor, miu fushor nëntokësor, miu shtëpiak. Në këtë zonë ku shtrihen pyjet jeton kaprolli, derri i egër, dreri dhe lepuri. Prej shpezëve në zonën fushore - kodrinore hasen: korbi i murrmë, laraska, shtura, harabeli fushor, qukapiku, pëllumbi, turtulli, thëllënza e fushës, shkurtëza, fani etj. Në zonën malore ku shtrihen edhe pyjet jetojnë: ariu i murrmë, dhia e egër, derri i egër, ujku, shqarthe i artë, shqarthe i bardhë, dhelpra, kaprolli, pula e egër e madhe dhe e vogël, pula e pyjeve, thëllënza, ketri etj. Ariu më tepër haset në zonën malore të Alpeve Shqiptare, në Sharr, Moknë etj.

4 Shih në shtojcë, harta nr.3. Gjeologjia e Kosovës.

## III. EKONOMIA E KOSOVËS

### 3.1. Treguesit ekonomik

Qeveria kosovare ka bërë përpjekje për ndërtimin e një ekonomie të tregut, mirëpo me gjithë përparimet e shënuara në vitet e fundit, Kosova mbetet ndër vendet më të varfra të Evropës. Prodhimi vendor bruto (PVB) i Kosovës numëron vetëm 5 miliardë dollarë amerikanë (me barazim të fuqisë blerëse), ndërsa me 2.300\$ PVB për krye, Kosova renditet e fundit në Evropë. Papunësia, që sipas vlerësime zyrtare ka kapluar 40% të fuqisë punëtore, është brenga kryesore për Republikën e Kosovës.

Të hyrat financiare për rindërtimin e vendit pas përfundimit të luftës sollën rritje ekonomike në tri vjetët e para, kurse më 2003-04 pati rënie për shkak të pamjaftueshmërisë së burimeve të brendshme dhe zvogëlimit të ndihmave ndërkombëtare. Inflacioni është i ulët, ndërsa tepricat buxhetore të herëpashershme janë kritikuar si mungesë e përpjekjeve të qeverisë për ta nxjerrë vendin nga skamja. Sidoqoftë, më 2007 pati deficit buxhetor, u shpenzuan 1.22 miliard dollarë amerikanë, ndërsa pati 1.19 miliard të hyra. Industria e nxjerrjes dhe përpunimit të xeheve është pothuajse jashtë funksionit.

Për t'i hapur rrugë zhvillimit ekonomik, janë privatizuar sipas numrit gjysma dhe sipas vlefës 90% e ndërmarrjeve shtetërore. Për dallim nga vendet e zhvilluara, përfshirë këtu edhe Shtetet e Bashkuara, Kosova ka shënuar rritje ekonomike gjatë viteve të fundit, mirëpo jo në shkallë të dëshirueshme për ta lehtësuar gjendjen e rëndë të popullsisë. (Shih tabelën nr 7).

Tabela 7. Treguesit ekonomik

Treguesit Ekonomik	
Papunësia <sup>5</sup>	33.1% <sup>vl. 2014</sup>
Rritja ekonomike	5.1% <sup>vl. 2007</sup>
Inflacioni	5.3% <sup>vl. 2007</sup>
Borxhi kombëtar	1,2 miliard \$ <sup>2007</sup>
Varfëria <sup>6</sup>	29,3% <sup>vl. 2014</sup>

### 3.2. Të ardhurat dhe zhvillimi shoqëror

**Papunësia** e lartë në Kosovë ka bërë që PVB të përqendrohet në sektorin e shërbimeve (60%), ndërsa pjesa tjetër është në mënyrë të barabartë e ndarë mes bujqësisë dhe industrisë. Për dallim nga shtetet e zhvilluara, ku sektori i shërbimeve ngërthen përqindje të lartë të punësuarve në korporata të mëdha financiare, të teknologjisë informative dhe shëndetësore, shërbimet në Kosovë përfshijnë kryesisht veprimtari të vogla private, të përqendruara në tregti me pakicë dhe ndërtimtari. Vetëm 0,25% e të punësuarve në vitin 2006 punonin për sipërmarrje të mesme dhe të mëdha me më shumë se 49 punëtorë. Në vitin 2007, 74.366 persona kanë qenë të punësuar në sektorin buxhetor.

**Shkalla e papunësisë** në vitin 2014 sillet rreth 35.3%, pra ka një rënje të vogël nga viti 2007 kur shkalla e papunësisë ishte 40%. Në vitin 2014, numri i personave që kanë kërkuar punë ka qenë 83323 persona. Punëkërkuar të grup-moshave 15-24 vjeçe 7741 persona ose 9.3% të numrit të përgjithshëm të punëkërkuarve të regjistruar, 3803 të gjinisë femërore dhe 3938

5 Indikatorët e tregut të punës nga Raporti i ASK.

6 Raporti i matjeve të fundit të Bankes Botërore, ASK dhe organizatave tjera relevante botërore.



të gjinisë mashkullore. Punëkërkues të grup-moshave nga 25 deri në 39 vjeçe ishin 41231 persona, të gjinisë femrore 18409 dhe të gjinisë mashkullore 22822. Paraqitur në përqindje të numrit të përgjithshëm të punëkërkuesve këto grup-mosha përbëjnë 49.5% të punëkërkuesve. Punëkërkues të grupmoshave nga 40-54 vjeçe ishin 26561 persona ose 31.9% të numrit të përgjithshëm të punëkërkuesve të regjistruar, të gjinisë femrore 11152 dhe të gjinisë mashkullore 15409 persona. Punëkërkues të regjistruar të moshave mbi 55 vjeçe ishin 7790 persona ose 9.3% nga këta 3206 femra dhe 4584 meshkuj. Numri i punëkërkuesve me diplomë universitare ishte 2511 persona ose 3.0% dhe atë 1422 femra dhe 1089 meshkuj, me shkollë të lartë të kryer ishin 320 persona ose 0.4% femra 107 dhe meshkuj 213.

**Sipas etnive** gjatë vitit 2014 kishim këtë përqindje të punëkërkuesve:

1. Shqiptarë 72908 persona ose 87,5% nga numri i përgjithshëm prej tyre femra 31929 dhe meshkuj 40979,
2. Serbë 3395 ose 4.1% prej tyre 1560 femra dhe 1835 meshkuj,
3. Minoritetet tjera 7020 persona ose 8.4 %, prej tyre 3081 femra dhe 3939 meshkuj, dhe
4. Komunitetet tjera 10415 persona ose 12.5%, prej tyre 4641 femra dhe 5774 meshkuj.<sup>7</sup>

**Shkalla e varfërisë** mbetet e rëndë, deri 29.3% jetojnë në varfëri me më pak se 1.72 €/ditë, ndërsa 10.2% në varfëri të skajshme me më pak se 1.20€/ditë.

Varfëria më tepër është e theksuar tek familjet:

- Me kryefamiljarë femër;
- Shumë-anëtarëshe veçmas mbi 7 anëtarë;
- Me më shumë fëmijë;
- Me të moshuar;
- Me persona të varur;
- Me persona të pa punë;
- Me persona me nivel të ultë shkollimi, dhe
- Familjet e komunitetit RAE .

Sipas të dhënave të DPSF/MPMS, në muajin korrik 2015 në nivel vendi, ndihmën sociale e kanë shfrytëzuar 26.947 familje, me 112.563 anëtarë të familjes.

Krahasuar me të dhënat nga viti 2006 kemi rënie të numrit të familjeve që shfrytëzojnë ndihmën sociale 40569, si dhe rënie të numrit të personave pjestarë të këtyre familjeve.

Departamenti i Pensioneve (DP), në kuadër të veprimtarisë së vetë, zbaton dhe operacionalizon politikat e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), nga sfera e sistemit pensional të shtyllës së parë, që kanë të bëjnë me administrimin, planifikimin, koordinimin, e skemave pensionale të financuara nga shteti si:

1. Pensionet Bazë,
2. Pensionet Kontributive,
3. Pensionet e personave me aftësi të kufizuara (PPAK),
4. Pensionet e ish Trupave Mbrojtëse të Kosovës (TMK),
5. Pensionet e Forcës së Sigurisë të Kosovës (FSK),
6. Pensionet e Parakohshme të minierave të Kompleksit “Trepça”
7. Pensionet për të verbër.<sup>8</sup>

<sup>7</sup> Raporti i Departamentit të Punës në MPMS për vitin 2014, faqe 18 dhe faqe 19.

<sup>8</sup> MPMS (Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale), DP (Departamenti i Pensioneve), raporti për vitin 2014/DP.



1. Pensionin bazë në shumën prej 75€ e marrin 125 883 persona (ky numër është marrë prej dhjetorit të vitit 2014, Raporti i Punës së DP-së), buxheti i siguruar nga shteti është 108 093 335€.
2. Nga skema e pensioneve kontributeve përfitojnë pensionet 38 651 persona në shumën 140 € dhe nga shteti është siguruar buxheti në shumën prej 61 895 592 €.
3. Nga skema e pensioneve të personave me aftësi të kufizuar, pensionet i përfitojnë 18 318 persona në shumën prej 75€ dhe shteti për realizimin e kësaj skeme ka siguruar buxhet në shumën prej 16 964 000 €.
4. Nga skema e pensioneve të TMK-së përfitojnë pensionet 844 persona dhe për realizimin e kësaj skeme është siguruar buxheti në shumën prej 2 219 734 €.
5. Përfitues i pensioneve nga skema e pjestarëve të FSK-së janë 134 persona dhe për realizimin e kësaj skeme është siguruar buxheti në shumën 631 200 €.
6. Nga skema e pensioneve për personat e verbër, pensionet i përfitojnë 3 144 persona në shumën prej 100 € +100 € për përcjellësin dhe për realizimin e kësaj skeme është siguruar buxheti prej 4 343 000 €.
7. Nga skema e pensioneve të parakohëshme në "Trepçë", "Golesh", "Strezofc" dhe "Karaçevë" përfitojnë pensionet 3 476 persona në shumën prej 70 € dhe për realizimin e kësaj skeme është siguruar buxheti në shumën prej 3 941 600 €.

Numri i përgjithshëm i përfituesve të pensioneve nga të gjitha skemat pensionale është 190 450 persona, shuma e buxhetit të siguruar për realizimin e gjitha skemave është 198 088 461€.

**Pensionet e posaçme për invalidët e luftës dhe familjet e dëshmorëve** kanë filluar nga viti 2007, fillimisht me 7.500 përfitues, numër ky që u rrit bashkë me vlerën e buxhetit për këtë kategori të përfituesve.

### 3.3. Bujqësia

Bujqësia nuk i plotëson nevojat e popullsisë, mirëpo ka shënuar së fundmi përparime të dukshme në sajë të ndihmës nga jashtë. Sipas vlerësimeve të vitit 2007, bujqësia kontribuon 7% të PVB. Prodhimet kryesore bujqësore janë misri, gruri dhe elbi, patatet, mollët, kumbullat dhe duhani. Njëherësh, shitja me shumicë e drurit ka ngjallur shqetësime rreth zhveshjes së pyjeve. Janë zgjeruar edhe hortikultura, kurse blegtorja ka bërë hapa përmirësimi. Ndërkaq, mbajtja e kafshëve për qumësht dhe mish, gjithashtu e shpezëve dhe bletëve, përbën rrafshin e blegtorisë.

Hapësira e mbjellë me drithëra është ngushtuar në krahasim me vitet '80. Gruri, drithi kryesor, mbillet në 70.000 hektarë tokë dhe ka mesatare të rendimentit prej 3.26 ton/ha. Rënie e madhe është shënuar në prodhimtari blegtorale si leshi dhe lëkura, mirëpo në vitet e fundit është rritur prodhimi i qumështit. Në Kosovë janë regjistruar 381.995 krerë gjedhesh, shumica lopë qumështore. Përkundër rritjes në bujqësi, Kosova mbetet shumë prapa vendeve evropiane dhe vazhdon të jetë importues madhor i prodhimeve ushqimore.

### 3.4. Energjia

Hartimi i politikave, organizimi, rregullimi dhe menaxhimi i sektorit të energjisë në Republikën e Kosovës bëhet nga MZHE nëpërmjet infrastrukturës ligjore, që përgjithësisht është në përputhje me aquis të Bashkimit Evropian (BE) për energjinë. Ndërsa, institucionet e sektorit përfshijnë institucionet qeveritare, rregullatore dhe ndërmarrjet energjetike.

Ndërmarrjet kryesore që operojnë në sektorin e energjisë në Kosovë janë:

- Korporata Energjetike e Kosovës (KEK sh.a.);
- Operator i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës (KOSTT sh.a.);
- Kompania Kosovare për Shpërndarje të Energjisë Elektrike (KEDS);
- Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike (KES/CO);
- Hidrocentralet (HC): Ujmani, Lumbardhi, Radaci, Dikanci dhe Burimi.

Prodhimi i energjisë elektrike në vend bëhet kryesisht nga Korporata Energjetike e Kosovës (KEK sh.a.), e cila përbëhet nga dy termocentrale (Kosova A dhe Kosova B) si dhe Minierat e Qymyrit (Mihja e re Sibovci Jug-Perëndim dhe Sitnica), dhe në një masë të vogël nga hidrocentralet (Ujmani, Lumbardhi, Radaci, Dikanci dhe Burimi). Kapacitetet e instaluar të termocentraleve janë 1478 MW, mirëpo për shkak të vjetërsisë së tyre, aktualisht kapaciteti operativ i tyre sillet rreth 915 MW. Kapacitetet e instaluar hidrike janë 45.84 MW.

Sistemi i transmisionit menaxhohet nga Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (KOSTT sh.a.). Sistemi i transmisionit të energjisë elektrike është i ndërlidhur me të gjitha sistemet fqinje në nivelin 400 kV, përveç me Shqipërinë, ku lidhja është vetëm në nivelin 220 kV. Aktivitetet e ndërtimit të linjës së re të tensionit prej 400 kV me Shqipërinë janë duke u zhvilluar dhe ndërtimi i kësaj linje ka filluar në fund të vitit 2014 dhe parashikohet të përfundojë brenda 24 muajve nga periudha e fillimit të zbatimit të projektit.

### 3.5. Integrimet ekonomike dhe tregtia me jashtë

Nga viti 2002, monedha Euro zëvendësoi markën gjermane si valutë zyrtare e Kosovës, ndonëse nuk ekziston ndonjë marrëveshje zyrtare për përdorimin e kësaj valute me institucionet evropiane. Valuta serbe “dinar” përdoret ilegalisht nëpër enklavat serbe. Megjithëse përdorimi i euros është parë si mundësi për kontrollimin e inflacionit, Kosova ishte vendi më i shtrenjtë në rajon në vitin 2008.

Më 29 qershor 2009, Republika e Kosovës u pranua zyrtarisht anëtare e Bankës Botërore dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar. Projektimet e FMN-së tani vlerësojnë se rritja ekonomike do të ngritet në 5% më 2010.

Më 2007, Kosova nënshkroi marrëveshjen e tregtisë së lirë, CEFTA, me vendet e rajonit. Megjithatë, mungesa e prodhimeve kosovare dhe pengesa nga Serbia kanë bërë që CEFTA të mos tregojë përparësi dhe lehtësira më të mëdha për Kosovën. Në partneritet tregtar me BE-në dhe vendet e rajonit, Kosova përballet me mungesë bilanci tregtar ashtu që eksporti në vitin 2007 arriti në 527 milion dollarë, ndërsa importi kalonte 2,6 miliardë dollarë.

Kosova eksporton kryesisht prodhime xeherore dhe metale të papërpunuara, mbeturina metalesh, lëkurë, makineri dhe pajisje transporti në vendet e BE-së, Serbi, Shqipëri, Maqedoni, Zvicër etj. Kurse importon ushqim, dru, karburante, kemikale, makineri dhe pajisje elektrike, kryesisht prej BE-së, Maqedonisë dhe Serbisë.

### 3.6. Transporti dhe komunikacioni

Në Kosovë janë 1.924 km rrugë, prej të cilave 630 km janë magjistrale dhe 1.294 km rajonale. Shumica e këtyre rrugëve janë të asfaltuara, gjithsej 1.666 km dhe 258 km të paasfaltuara. Gjithashtu janë edhe 430 km hekurudhë, prej të cilave 333 km shfrytëzohen për transport të udhëtarëve dhe 97 km për transport industrial. Linja kryesore shtrihet nga kurfiri verior i Kosovës, në veri të Mitrovicës e deri në Han të Elezit me gjatësi 141 km. Linjat tjera përfshijnë linjat Fushë - Kosovë- Pejë, Klinë-Prizren dhe Fushë- Kosovë-Prishtinë-Podujevë.

#### Transporti ajror

Kosova ka Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës, që gjendet në Sllatinë të Lipjanit. Transporti Ajror përfshinë tërësinë e trafikut të pasagjerëve dhe të mallrave të vendit dhe është i vetmi që zhvillon një aktivitet komercial. Aeroporti Ndërkombëtar Prishtinës operon në përputhshmëri me Anexet e ICAO - së (Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil ), dhe Ligjit mbi Aviacionin të Republikës së Kosovës. Në vitin 2007, u realizuan 4321 fluturime me gati 1 milion udhëtarë. Njëherësh, Kosova ka edhe nëntë aeroporte të tjera, pesë prej tyre me pista të shtruara.

### 3.7. Telekomunikimi

Sistemi i telekomunikimit në Kosovë funksionon në dy mënyra: rrjeti i telefonisë fikse dhe asaj mobile. Kosova ka dy operatorë të telefonisë mobile, Vala e operuar nga Post telekomi i Kosovës dhe IPKO, kompani private. Rrjeti i telefonisë fikse funksionon në kuadër të PTK-së. Rrjeti i telefonisë fikse kryesisht është i shtrirë në zonat urbane, kurse ajo mobile mbulon tërë territorin e Kosovës (pjesërisht në tri komunat veriore, ku operojnë operatorët ilegal).

## IV. DEMOGRAFIA

### 4.1. Statistikat

Shteti i Kosovës karakterizohet me strukturë të re të popullsisë, ku mosha mesatare është 30.8vjet (2014).

Pas vitit 1990 popullsia e Kosovës u përball me dukurinë e migracionit, i cili ndikoi si në strukture ashtu edhe në ritmet e rritjes së sajë.

Lëvizja e lirë dhe e pakontrolluar e popullsisë ka ndikuar në ndryshimin e raportit të popullsisë urbane me atë rurale.

Sipas regjistrimit të popullsisë të realizuar në prill të vitit 2011, 61% e popullsisë jeton në zonat rurale.

Regjistrimi i fundit i plotë i popullsisë është bërë në vitin 2011 dhe rezultoi se Kosova kishte 1 780 021 banorë, prej tyre 896 136 të gjinisë mashkullore dhe 883 885 të gjinisë femërore.

Popullsia e përgjithshme rezidente e Kosovës për vitin 2014 vlerësohet të jetë 1 804 944 banorë.

Përkundër një shtimi natyror prej 23 922 banorëve gjatë vitit 2014 popullsia e Kosovës u zvogëlua për 15 687 banorë kjo, për shkak të emigrimit ndërkombëtarë. Këta indikatorë demografik<sup>9</sup> janë të përmbledhura në tabelën nr. 8.

**Tabela 8. Indikatorët demografik për periudhën 2011-2014.**

Indikatorët demografik	Viti 2011	Viti 2012	Viti 2013	Viti 2014
Popullsia	1,798,645	1,815,606	1,820,631	1,804,944
Nataliteti	34,101	27,650	29,723	32,087
Mortaliteti	7,622	7,287	8,317	8,165
Shtimi natyror	26,479	20,363	21,406	23,922
Shkalla e natalitetit	19.0	15.2	16.3	17.8
Shkalla e mortalitetit	4.2	4.0	4.6	4.5
Imigrimi	4,614	5,298	3,864	5,724
Emigrimi	6,695	8,700	20,246	45,333
Net migrimi	-2,081	-3,402	-16,382	-39,609
Rritja absolute	24,398	16,961	5,024	-15,687
Rritja në %	1.4	0.9	0.3	-0.9
Urbane	38.3	38.6	38.9	39
Rurale	61.7	61.4	61.1	61
Mosha mesatare	30.2	30	30.6	30.8
Jetëgjatësia	76.7	76.7	76.8	76.8

Që nga fillim vitit 2011 deri në fund të vitit 2014 popullsia e Kosovës kishte një shtim natyror prej 92 170 personave, por emigrimi i shprehur ndikoi që popullsia rezidente në Kosovë brenda katër (4) viteve të rritej vetëm diç më shumë se 30 000 banorë.

<sup>9</sup> Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës- Statistikat e lindjeve, vdekjeve dhe vlerësimi i popullsisë.

Trendi i emigrimit në Kosovë gjatë viteve të fundit ka pasur një rritje të vazhdueshme derisa gjatë vitit 2014 kishte një emigrim shqetësues me një numër prej më shumë se 45 000 emigrante<sup>10</sup>.

Emigrimi për periudhën katërvjeçare 2011/2014 ishte rreth 90.000 banorë, imigrimi rreth 19.500 dhe migrimi me - 61,474 banorë.

Ky emigrim i shprehur do të ndikoj edhe në strukturën e popullsisë, në vitalitetin e që do të jetë evident në vitet vijuese pasi që vlerësohet se pjesa dërmuese e emigrimit kishte përfshirë meshkujt, si dhe grupmoshat e reja kryesisht 15-49 vjeç (mosha fertile).

Përqindja e popullsisë që jeton në zonat rurale për vitin 2011 ishte 61,7% ndërsa ajo në zonat urbane 38,3% dhe gjatë vitit 2014 supozohet të jetë 61% rurale dhe 39% urbane. Mosha mesatare e popullsisë së Kosovës supozohet të jetë 30.8 vjet (2014).

Jetëgjatësia mesatare në Kosovë për vitin 2011 është vlerësuar të jetë 76,7 vite derisa për vitin 2014 supozohet të jetë 76.8 vite.

Niveli i integritetit të pakicave jo serbe në shoqërinë kosovare është në përgjithësi i kënaqshëm, ndërkohë përkundër përpjekjeve të qeverisë dhe shoqërisë civile kosovare, integriteti i komunitetit serb po ecën ngadalë për shkak të pengesave të grupeve ekstremiste të sponsorizuara nga qeveria e Serbisë.

## 4.2. Arsimiti

Procesi edukativo-arsimor zhvillohet në objekte shkollore<sup>11</sup> të ndërtuara në tërë territorin dhe atë në disa nivele siç janë: niveli parashkollor, fillor, i mesëm i ulët, i mesëm i lartë dhe universitar, ndërsa të dhënat statistikore janë paraqitur në tabelat në vijim. Ndërsa shpërndarja e objekteve ( ndërtesave) shkollore.

**Tabela 9. Statistikat për arsimin për vitet 2005/2006 – 2013/2014.**

Niveli	Arsimi	2005-2006	2006-2007	2007/2008	2008/2009	2009/2010	2010/2011	2011/2012	2012/2013	2013/2014
0	Parashkollor	25,721	25,670	24,864	23,826	24,033	24,655	24,945	26,431	26,768
1+2	Fillor dhe i mesëm i ulët	322,864	322,381	325,544	319,154	306,299	302,253	294,419	286,677	280,823
3	I Mesëm i lartë	74,635	88,974	91,536	96,765	104,806	108,503	109,513	107,303	100,437
1+2	Fillor dhe i mesëm i ulët special	703	728	722	752	791	807	782	720	635
3	I Mesëm i lartë special	94	86	169	83	94	98	133	146	147
5+6	Universitar	28,707	27,274	25,840	29,051	37,839	45,725	49,844	65,305	52,159
<b>Gjithsej</b>		<b>452,724</b>	<b>465,113</b>	<b>468,675</b>	<b>469,631</b>	<b>473,862</b>	<b>482,041</b>	<b>479,636</b>	<b>486,582</b>	<b>460,969</b>

10 [http://ask.rks-gov.net/publikimet/popullsia/Vlerësim:Popullsia\\_e\\_Kosoves\\_2014](http://ask.rks-gov.net/publikimet/popullsia/Vlerësim:Popullsia_e_Kosoves_2014).

11 Shih në shtojcë, Harta nr 4. Shpërndarja e objekteve shkollore.


**Tabela 10. Numri i edukatorëve, mësime dhënë në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët, të mesëm të lartë dhe universitar në vitet 2005/2006-2013/2014.**

Niveli	Arsimi	2005-2006	2006-2007	2007/2008	2008/2009	2009/2010	2010/2011	2011/2012	2012/2013	2013/2014
0	Parashkollor	1,141	1,179	1,231	1,168	1,220	1,303	1,333	1,450	1,534
1+2	Fillor dhe i mesëm i ulët	16,705	16,433	17,236	17,231	17,227	17,856	17,822	17,663	17,851
3	I Mesëm i lartë	4,558	4,864	5,055	5,157	5,519	5,957	6,095	6,142	6,374
1+2	Fillor dhe i mesëm i ulët special	138	129	121	151	166	155	132	141	131
3	I Mesëm i lartë special	51	35	43	52	46	36	38	48	40
5+6	Universitar	980	1,059	1,051	1,065	1,015	1,023	1,132	2,929	1,314
<b>Gjithsej</b>		<b>23,573</b>	<b>23,699</b>	<b>24,737</b>	<b>24,824</b>	<b>25,193</b>	<b>26,330</b>	<b>26,552</b>	<b>28,373</b>	<b>27,244</b>

Përqindja e analfabetëve në popullsinë e moshës 10 vjeç e më shumë sipas regjistrimit të popullsisë 2011 ka qenë 3.85.

**Tabela 11. Arsimi parauniversitar.**


Parashkollor	F 2.580	M 2.790	5.370
Parafillor	F.10.136	M.10.739	20.875
Fillor/i mesëm i ulët	F.133.427	M.142.460	275.887
I mesëm i lartë	F.40.423	M.45.796	86.219
Gjithsejt:	F 186.566	M 201.785	388.351



Grafiku 1. Nxënësit sipas niveleve

**Tabela 12. Numri i nxënësve sipas përkatësisë etnike.**


Përkatësia etnike:	Nr. i nxënësve:
Shqiptarë	372.794
Boshnjakë	4.351
Romë	1.918
Egjiptianë	772
Ashkalinjë	4.177
Turq	2.850
Goranë	676
Kroatë	31
Serb	622
Të tjerë:	160




Grafiku 2. Nxënësit sipas përkatësisë etnike



**Grafiku 3. Organizimi i procesit mësimor sipas tipit të shkollave**



*Nxënës në gjimnaze dhe shkolla profesionale*



*Nxënësit sipas tipit të shkollave*

## V. VLERËSIMI I RREZIQEVE

### 5.1. Krijimi i profilit të rreziqeve

#### Vlerësimi i rreziqeve përcakton çështjet si:

- Çka mund të ndodh?
- Sa shpesh mund të ndodh?
- Dëmi që ka gjasa të shkaktohet?
- Sa ka gjasa të ndikojë në komunitet?
- Sa është i cenueshëm komuniteti ndaj rrezikut?

#### Pesë hapat e procesit të analizimit të rrezikut janë:

1. Identifiko rrezikun.
2. Profilizo secilin rrezik.
3. Ndërto profilin e komunitetit.
4. Përcakto cenueshmërinë.
5. Krijë dhe apliko skenarët

#### Format standarde për vlerësimin e rreziqeve

Flet-pune e Profilit të Rrezikut	
Rreziku	
<b>Madhësia e mundshme (Përqindja e komunitetit që mund të goditet):</b>	
Katastrofike: Më shumë se 50%	
Kritike: 25 deri 50%	
E kufizuar: 10 deri 25%	
E papërfillshme: Më pak se 10%	
<b>Frekuenca e ndodhjes:</b>	<b>Modeli Sezonal:</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <b>Shumë e mundshme:</b> Mundësia afër 100% në vitin e ardhshëm.</li> <li>▪ <b>E mundshme:</b> Mundësia midis 10 dhe 100% në vitin e ardhshëm, ose së paku një gjasë në 10 vitet e ardhshme.</li> <li>▪ <b>Ka gjasa:</b> Mundësia midis 1 dhe 10% në vitin e ardhshëm, ose së paku një shans në 100 vitet e ardhshme.</li> <li>▪ <b>I pa mundshëm:</b> Mundësia më e vogël se 1% në 100 vitet e ardhshme.</li> </ul>	
Zonat që mund të goditen më së shumti:	
Kohëzgjatja e mundshme:	
Shpejtësia e mundshme e mësymjes (shuma e mundshme e kohës së paralajmërimit):	
<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Paralajmërim minimal (apo fare).</li> <li>▪ Paralajmërim 6 deri 12 orë.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Paralajmërim 12 deri 24 orë.</li> <li>▪ Paralajmërim më shumë se 24 orë.</li> </ul>
Sistemet ekzistuese të paralajmërimit:	
A ekziston analiza e dobësive/cenueshmërisë?	
<input type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> Jo	

**Efekti goditës në komunitet (shkalla e ashpërsisë), karakteristikat**

Karakteristikat	Ashpërsia
<ul style="list-style-type: none"> <li>Vdekje të shumëllojshme.</li> <li>Ndërprerja e plotë e objekteve/shërbimeve për 30 ditë apo më shumë.</li> <li>Më shumë se 50% e të mirave materiale të dëmtuara rëndë.</li> </ul>	Katastrofike
<ul style="list-style-type: none"> <li>Vdekje, lëndime apo sëmundje që rezultojnë në paaftësi të përhershme.</li> <li>Ndërprerja e plotë e objekteve/shërbimeve për së paku 2 javë.</li> <li>Më shumë se 25% e të mirave materiale të dëmtuara rëndë.</li> </ul>	E ashpër (kritike)
<ul style="list-style-type: none"> <li>Lëndimet dhe/apo sëmundjet nuk rezultojnë në paaftësi të përhershme.</li> <li>Ndërprerja e plotë e objekteve/shërbimeve për së paku 10 ditë.</li> <li>Më shumë se 15% e të mirave materiale të dëmtuara rëndë.</li> </ul>	E mesme
<ul style="list-style-type: none"> <li>Lëndimet dhe/apo sëmundjet nuk rezultojnë në paaftësi të përhershme.</li> <li>Ndërprerja e plotë e objekteve/shërbimeve për së paku 1 javë.</li> <li>Më shumë se 10% e të mirave materiale të dëmtuara rëndë.</li> </ul>	E kufizuar
<ul style="list-style-type: none"> <li>Lëndimet dhe/apo sëmundjet e trajtuara me ndihmën e parë.</li> <li>Humbje e vogël e standardit të jetesës.</li> <li>Ndërprerja e objekteve/shërbimeve kritike për 24 orë e më pak.</li> <li>Më pak se 10% e të mirave materiale të dëmtuara rëndë.</li> </ul>	E ultë

**Tabela 14: Profili i komunitetit**

Faktorët kyç të komunitetit				
Gjeografik	Demografik	Të mirat materiale	Infrastruktura kritike	Objektet e rëndësishë së veçantë
Tiparet e mëdha gjeografike.	Madhësia e popullatës, shtrirja/shpërndarja, përqendrimi.	Numri. Lloji. Vjetërsia.	Sistemi i ujit të pijshëm.	Shkollat. Foshnjoret.
Modelet tipike meteorologjike.	Numri i njerëzve në zonat e cenueshme. Popullatat e veçanta. Kafshët.	Rregullat e ndërtimit. Rreziqet e mundshme dytësore.	Energjia. Depot ushqimore. Mullinjtë. Kanalizimet.	Spitalet. Ndërtesat qeveritare. Ndërtesat publike. Ndërtesat industriale. Pikat e karburanteve.

Faktorët kyç të komunitetit			
Komunikacioni dhe telekomunikacioni	Trashëgimia kulturore	Ambienti	Humbjet ekonomike
Rrugët.	Vendet arkeologjike.	Toka.	
Urat/Tunelet.	Muzetë.	Uji.	
Hekurudha.	Vlerat historike dhe kulturore.	Ajri.	
Aeroporti.			
Posta dhe telekomunikimi.			

## Nivelet e fatkeqësive

1	I ULTË	
2	I KUFIZUAR	
3	I MESËM	
4	I ASHPËR	
5	KATASTROFIK	

## VI. RREZIQET NATYRORE

### 6.1. Zjarret

Kosova ka hyrë në procesin e harmonizimit të legjislacionit dhe të standardeve me ato të Bashkimit Evropian, ku përmes tyre pritet që sektorë të ndryshëm që ndërtojnë ekonominë do të ristrukturohen dhe modernizohen. Në këtë kontekst, një prej segmenteve të rëndësishëm të programit qeveritar është zhvillimi i zonave rurale dhe zvogëlimi i varfërisë, çka do të thotë ofrimi i mundësive më të mëdha lidhur me rritjen e të ardhurave për familjet e zonave rurale, ndërmarrjet e vogla dhe stabilitetin e komunave. Në këtë kontekst funksionet ekonomike, sociale dhe ekologjike të pyjeve janë me rëndësi qenësore për zhvillimin e qëndrueshëm të Kosovës, si dhe për përmirësimin e cilësisë së jetës, posaçërisht në zonat rurale dhe ato malore. Duke u bazuar në këto funksione të dobishme të pyjeve, Kosova i vendos pyjet si pjesë e pasurisë/trashëgimisë kombëtare. Ligji për Pyje e vërteton këtë deklaram: “Pyjet e Kosovës janë resurse kombëtare. Ato duhet të menaxhohen në atë mënyrë që të ofrojnë një prodhimtari të qëndrueshme dhe në të njëjtën kohë të ruajnë larminë biologjike për të mirën e gjeneratave të tashme dhe atyre të ardhshme. Menaxhimi i pyjeve duhet të marrë parasysh edhe interesat tjera për publikun e gjerë”. Ligji gjithashtu afirmon masat parandaluese, konservimin e biodiversitetit, parimet e barazisë së gjeneratave si dhe nevojën për aplikimin e zhvillimit të qëndrueshëm ekologjik. Pas përfundimit të luftës në Kosovë, vendi hyri në një periudhë të vështirë të tranzicionit, ku sistemi ekonomik dhe ai politik u rindërtua për t’ju përshtatur një mjedisi plotësisht të ri. Kjo periudhë e tranzicionit u bë më e vështirë me gjendjen e ndërlikuar politike, sociale dhe ekonomike që prek funksionet e të gjithë sektorëve, ku nuk përjashtohet as pylltaria. Praktikata e pakontrolluara dhe të paqëndrueshme të menaxhimit të pyjeve kanë rezultuar në stagnimin dhe shkatërrimin e resurseve pyjore. Kosova është në proces të nënshkrimit të shumë marrëveshjeve, konventave ndërkombëtare për pyjet dhe mbrojtjen e mjedisit, çka do të ketë një ndikim të madh në sektorin e pylltarisë. Për momentin, të vetmet dokumente strategjike për sektorin e pylltarisë në Kosovë janë Ligji për Pyjet i vitit 2003, dhe dokumenti i Politikave dhe Strategjisë për Zhvillimin e Sektorit të Pylltarisë 2010 – 2020, që të dyja pa financime.

Në maj të vitit 2008, Qeveria e Kosovës ka filluar procesin e hartimit të Politikave dhe Strategjisë Nacionale për Pyje. Procesi është i bazuar në parimet e njohura të politikave zhvillimore, përmes kontributeve të ekspertëve vendor dhe atyre ndërkombëtar, si dhe të palëve të tjera të interesit. Politikata dhe strategjia e sugjeruar janë në përputhje me legjislacionin e pylltarisë dhe rregullojnë shtigjet për të gjitha vendimet e mëdha të cilat kanë të bëjnë me sektorin e pylltarisë.

#### Të dhënat statistikore për zjarret pyjore


Statistikat për zjarret pyjore rregullisht mbahen nga viti 1955. Ndryshimet klimatike kanë ndikuar edhe në Kosovë, ndërsa vitet më të theksuara janë evidentuar në vitet: 2000, 2004, 2007 dhe 2012, me që rast janë dëmtuar sipërfaqe të mëdha të pyjeve duke shkaktuar humbje të konsiderueshme<sup>12</sup>.

**Tabela: 13 Zjarret pyjore (verë 2007)**

Nr. r.	DK të APK	Periudha zjarreve	Sipërfaqja e djegur në ha	Vlera e dëmit në €
1.	Prishtinë	Mars - Tetor	1.954	792,167
2.	Mitrovicë	Mars - Tetor	825	446,956
3.	Pejë	Mars - Tetor	2.883	2,670,575
4.	Prizren	Mars - Tetor	3.795	737,702
5.	Gjilan	Mars - Tetor	162	-
6.	Ferizaj	Mars - Tetor	1.336	5.629
7.	DMKE	Mars - Tetor		
Gjithsej			10.955	4,653,028

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR) është institucioni përgjegjës për zbatimin e projektit "Rritja e ndërgjegjësimit publik për mbrojtjen e pyjeve dhe tokave pyjore" financuar zakonisht në të kaluarën nga buxheti i konsoliduar i Kosovës. Rezultatet nga inventarizimi i dytë i pyjeve tregojnë se, që nga viti 2003, sipërfaqja pyjore dhe vëllimi drunor mbetën të pandryshueshëm me sipërfaqe 481,000 hektarë.

Qëllimi i inventarizimit nacional i pyjeve të Kosovës është që të sigurojë informata për politikën nacionale, planifikim strategjik dhe raportim ndërkombëtar për burimet pyjore dhe ndryshimet klimatike.



Grafiku nr.4. Përqindja e sipërfaqeve të mbuluara me pyje, tokë bujqësore dhe kullosa.


**Pyjet gjethore** përfshijnë më shumë se 90% të sipërfaqeve pyjore. Llojet dominuese të gjethorëve janë qarri dhe ahu.

**Pyjet halore** përbëjnë 7% të sipërfaqes së përgjithshme pyjore, janë të dominuara nga bredhi (*Abies alba*), hormoqi (*Picea abies*) dhe pishat (*Pinus sp.*). Sipërfaqet pyjore janë klasifikuar edhe sipas origjinës së grumbullit faror dhe lartësisë mbidetare. Më shumë se 60% e sipërfaqeve me drunj me mbirje natyrore gjenden në lartësi mbidetare në mes të 600 – 1 000 metra.

Sipas Inventarizimit Nacional të Pyjeve (INP) 2012, është llogaritur se vëllimi i përgjithshëm në këmbë është 46.331 milion m<sup>3</sup>, nga i cili me diametër > 7 cm rreth 40.509 milion m<sup>3</sup> dhe diametër <7 cm 5.823 milion m<sup>3</sup>.



Inventarizimi Nacional i Pyjeve (INP), Planet Menaxhuese të Pyjeve (PMP) dhe Fis-Kos, në digjital gjeografi dhe databazë, në mes atributesh të shumëta, përmbajnë edhe klasat menaxhuese që kanë të bëjnë me rreziqet natyrore si: sipërfaqet e evidentuara me zjarret pyjore, rrëshqitjes së dheut dhe erozionit.



Grafiku nr. 5. Gjasat e përhapjes së zjarreve pyjore gjatë përgatitjes së tokës për mbjellje pranverore dhe vjeshtore, sipas Faktorit të Lang-ut, raporti reshje – temperaturë.

Profili i rrezikut	
<b>Rreziku:</b> Zjarret pyjore.	
<b>Madhësia e mundshme (Përqindja e komunitetit që mund të goditet):</b>	
<input type="checkbox"/> Kritike.	
<b>Frekuenca e ndodhjes:</b>	<b>Modeli Sezonal:</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>Shumë e mundshme.</li> </ul>	<b>Pranveror:</b> Maj – Qershor. <b>Veror:</b> Korrik- Shtator. <b>Vjeshtor:</b> Tetor.
<b>Zonat që mund të goditen më së shumti:</b> Pyjet.	
Kohëzgjatja e mundshme: Relativisht e shkurtër : 3 - 4 ditë.	
<b>Shpejtësia e mundshme e mësymjes (shuma e mundshme e kohës së paralajmërimit):</b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>Paralajmërim minimal (apo fare).</li> </ul>	
<b>Sistemet ekzistuese të paralajmërimit:</b> Rojet e pyjeve dhe stafi profesional teknik i pylltarisë, mbështetur me automjete të terrenit dhe sistem të komunikimit masiv, rojet e gjuetisë dhe qytetarët.	
<b>A ekziston analiza e dobësive/cenueshmërisë?</b>	
Po	<input type="checkbox"/>
Jo	<input checked="" type="checkbox"/>

**Cenueshmëria nga goditjet në faktorët kyç të komunitetit**

Profili	Pasojat e mundshme	Shkalla e goditjes
Banorët	Vdekje, lëndime apo sëmundje që rezultojnë në paaftësi të përhershme ( për shkak të goditjes së valës së flakës, tymit, ngulfatjes nga tymi dhe dukshmërisë).	E ashpër
Pasuria	Në shumë regjione të Kosovës zjarri kaplon shtëpitë me objektet përcjellëse, tbane (stane) dhe kafshët shtëpiake të komunitetit i cili ka shtrirje afër pyjeve, si dhe florën dhe faunën.	E ashpër
Infrastruktura Vitale	Shkatërrim/dëmtim i pyjeve, tokës bujqësore, livadheve dhe kullosave, si dhe rrjetit të largpërçuesve elektrik.	E ashpër
Objektet e Rëndësisë së Veçantë	Dëmtim i trashëgimisë kulturore (mullinjve, valavicave, urave, mureve, etj.), trashëgimisë natyrore –biodiversitetit.	E mesme
Shërbimet Emergjente	Dëmtime të pajisjeve të njëjësive reaguese, auto terreni, pompave për shuarjen e zjarreve, pajisjeve shtesë rrobave, etj.	E mesme
Ambienti	Dëmtimi i përgjithshëm i pyjeve, florës faunës dhe mjedisit rrethues, që mund të janë të ripërtëritshëm.	E mesme
Trashëgimia Kulturore	Shkatërrim dhe dëmtim i objekteve të trashëgimisë kulturore në hapësirat pyjore.	E mesme
Shërbimet shtetërore	Dëmtim i shërbimeve shtetërore dhe shërbimeve për qytetarë.	E mesme
Dëmet Ekonomike	Shkatërrim /dëmtim i madh i pyjeve, shtëpive dhe objekteve përcjellëse, pasurisë, infrastrukturës vitale, etj.	E mesme

**Skenari 1.**

Pas thatësisë disa mujore gjatë muajve të verës, zjarret pyjore fillimisht kishin përfshirë pyjet kryesisht halore në regjionin e Prizrenit, Mitrovicës dhe Pejës (Dragash, Prizren, Mitrovicë dhe Vushtri) me tendence të shtrirjes. Gjendja është alarmante sidomos në pyjet Nj. M. Pashtrik i të Prizrenit. Sipas vlerësimeve preliminare në këto dy regjione zjarri pyjor ka përfshirë një sipërfaqe prej 2.799 ha, me dëgjie të vëllimit në këmbë në kundërvlerë prej 1,239,120 €, të pyjeve të të gjitha kategorive. Me këto zjarre në Nj. M. “Koritnik II” Dragash, është humbur, një sipërfaqe e konsiderueshme e kulturës së rrobullit të moshës mbi 200 vjeçare.

**Skenari 2.**

Gjendja gjithnjë vie duke u rënduar, kur zjarri pyjor ndërkohë përfshinë dhe regjionin e Prishtinës dhe Gjilanit, me që rast, zjarri ka kapluar një sipërfaqe prej 3.290 ha me humbje të vëllimit në këmbë në kundërvlerë prej 797.796 €. Në regjionin e Pejës zjarri ka përfshirë kryesisht pyjet halore dhe me rrezik të përhapjes në drejtim të tbaneve të fshatrave të Rugovës.

**Skenari 3**

Gjendja është rënduar edhe më shumë kur zjarret pyjore përhapen me shpejtësi të madhe në drejtim të pesë fshatrave malore në Rugovë të Pejës, ku momentalisht janë të ngujuar 18 familje me 98 anëtarë dhe një numër të madh të bagëtive. Situatën e rëndon edhe më tepër era e cila fryn në drejtim të fshatrave me shpejtësi 7 m/s. Situata përkeqësohet edhe më shumë pas përhapjes së zjarrit në malet e Jezercit (Ferizaj) në drejtim të Budakovës (Suharekë), ku kanë mbetë të ngujuar 30 vizitor në restorantin Trofta (Jezerc).

## Konkludim

Zjarret pyjore janë dëmtuesit më të mëdhenjë të pyjeve si shkaktari kryesor i dëmeve në: ekonomi, ambient, biodiversitet, rekreacion, shëndet, etj.

Zjarret pyjore të vitit 2007, mund të themi se ishin një katastrofë natyrore për pyjet dhe ekonominë e Kosovës, sepse zjarri përfshiu dhe dogji një sipërfaqe prej 10.597 ha me vëllim në këmbë në kundërvlerë prej 4,653,029 €.

Kosova ka disa ujëmbledhës (liqej) të cilët do të mund të shfrytëzohen për furnizimin e fluturakeve me ujë, me ndihmën e të cilave do të mund të menaxhoheshin mjaft mirë zjarret pyjore.

## 6.2. Vërshimet

Kosova është e ndjeshme ndaj vërshimeve dhe ato ndodhin shpesh<sup>13</sup>. Vërshimet në Kosovë në nëntor të vitit 2007 kanë prekur më shumë se 3500 ekonomi familjare, duke shkaktuar edhe dëme të konsiderueshme materiale.

Pothuajse të gjitha komunat e Kosovës ku më shumë e ku më pak janë të prekura nga rreziku i vërshimeve (shih hartën nr.5.), të cilat manifestohen në formën e:


- Vërshimeve pas stuhive në zonat malore,
- Vërshimeve pas shirave të vazhdueshme në zonat fushore,
- Vërshimeve pas shkrirjes së borës të shoqëruara apo jo me mot të lig.

34

Vërshimet sipas pellgjeve lumore:

- Drini i Bardhë: 50 %
- Ibri: 24 %
- Lepenci: 20 %
- Morava e Binçës: 6 %

### Harta nr. 7 . Zonat e prekura nga vërshimet.



- Dëmet më të mëdha të shkaktuara nga vërshimet janë në pellgun e lumit “Drini i Bardhë” 50,7% (sipas Master planit 1983-2000).
- Dëmet e shkaktuara nga vërshimet vetëm nga lumi Drini i Bardhë kanë arritur vlerën 9,7%.

### Vërshimet e fundit në Kosovë

- Muaji Shkurt, 2006.
- Janar, 2010.
- Prill, 2014.

### Gjendja aktuale:

Faktorët që ndikojnë në intensitetin e rreziqeve nga erërat e fuqishme konsiderojmë se mund të jenë: distanca e konsiderueshme nga bregdeti, relievi me vargmale dhe pyje të mbuluara me vegjetacion të cilat mund të ndikojnë ndjeshëm në frenimin natyror, duke zvogëluar intensitetin e erërave, në veçanti në regjionet e fushës që e rrethojnë. Përkundër saj konsiderojmë se rreziqet e shkaktuara nga stuhitë nuk mund të nënvlerësohen dhe të përjashtohen. Sa i përket vërshimeve, ato ndodhin më së shpeshti në stinën e dimrit, pranverës dhe në vjeshtës.

Vërshimet në Kosovë zakonisht janë pasojë e reshjeve atmosferike ku prurjet e mëdha të ujit në rrjedhat e lumenjve që dalin nga shtrati dhe vërshojnë në zonat urbane dhe rurale shkaktojnë dëme të konsiderueshme në infrastrukturë, pronë private, bujqësore, etj. Si pasojë e reshjeve atmosferike dhe vërshimeve në zonat urbane për shkak të rrjetit të vjetruar, kapacitetit të pamjaftueshëm, si dhe mungesës së impianteve për trajtimin e ujërave të zeza, rrisin efektet e dëmeve edhe më shumë<sup>14</sup>.

Kohëzgjatja e çdo lloj vërshimi është relativisht e shkurtër (më së shumti 3 - 4 ditë).

### Shkaqet kryesore të vërshimeve në Kosovë:

- Reshjet,
- Ndërtimet e pakontrolluara në hapësirat buzë lumenjve,
- Hudhja e mbeturinave të ngurta në lumenj,
- Mungesa e mirëmbajtjes së shtretërve të lumenjve dhe argjinaturave.

### Faktorët e përkeqësimit:

- Rrjeti i dendur hidrografik,
- Pjerrtësia e lehtë e lumenjve,
- Intensiteti dhe kohëzgjatja e reshjeve,
- Thellësia e pamjaftueshme e shtretërve të lumenjve,
- Vegjetacioni,
- Prania e pengesave në qarkullimin e ujërave.

14 Shih në shtojcë, Harta nr.8. Rreziku nga vërshimet –popullsia në nivel komunash.

**Skenarët e mundshëm:**

- Vërshimet e shkaktuara nga përrockat vërshuese,
- Vërshimet e shkaktuara nga rritja progresive e ujërave.

**Pasojat:** Rreziqet nga vërshimet në Kosovë kanë shkaktuar vdekje, lëndime, pasoja traumatike në njerëz, dëme të konsiderueshme në të mirat materiale, infrastrukturë kritike, objekte të rëndësisë së veçantë, trashëgimi kulturore, mjedis si dhe në ekonomi.

**Periudhat e rrezikut nga vërshimet:** Në Kosovë janë dy periudha sezonale gjatë vitit që karakterizohen me vërshime:

- Sezona dimërore që manifestohet me reshje të shumta të borës, dhe
- Sezona pranverore dhe vjeshtore që manifestohet me sasi më të shumta të reshjeve-shiut.

**Reshjet:** Në bazë të dhënave historike gjatë dhjetë viteve të fundit nga statistikat e stacioneve meteorologjike rezulton se reshjet më të dendura të borës gjatë vitit është dimri në muajt Janar dhe Shkurt, kurse stinët me reshjet më të dendura të shiut janë Pranvera (Prill- Maj) dhe Vjeshta (Shtator-Tetor).

**Temperaturat:** Klima e Kosovës është kryesisht kontinentale me disa ndikime mesdhetare dhe alpine, verërat janë të nxehta dhe dimrat të ftohtë. Temperaturat ekstreme shkojnë deri në 39/40°C në verë dhe - 20°C në dimër. Relievi në Kosovë është i ndryshueshëm me variacione termike të mëdha në mes të zonave më të nxehta dhe atyre më të freskëta (ftohta). Temperaturat si faktor zakonisht pak ndikojnë në ndjeshmërinë e vërshimeve përveç ndoshta në dy situata krejt të veçanta.

**Era:** Kosova është një regjion në përgjithësi që nuk goditet me shpeshtësi të madhe të erërave të cilat kryesisht janë të intensitetit të mesëm dhe të ulët, ku drejtimi i erës kryesisht është nga veriu.

**Valët e të ftohtit, bora:** Temperaturat mesatare dimërore mund të arrijnë deri në - 10°C ku bora është më e shpeshtë në lugina.

**Thatësia:** Kosova është një vend me sipërfaqe të konsiderueshme rurale ku gjatë sezonës verore mund të ketë periudha më të gjata të vapës që kryesisht manifestohen me mungesa të mëdha të reshurave atmosferike të cilat mund të shkaktjnë thatësi, ku mungesa e ujit është e madhe.

Tabela 14 .Pellgu lumor Drini i Bardhë.

PELLGU LUMOR DRINI I BARDHË										
Komuna	Emri i lumit dhe që doli nga shtrati	Lleji i Evakulimit	Numri banorve	Objektet e Rrezikuar a/ tokë bujqësore	Numri	Fshatrat	Numri	Kërkesa emergjente	Burimi i raportimit	Viti
Klinë	Drini i Bardhë			Motel Drini						
	Larëbardhi i Pejës			Vila Park						
	Klinë			Natyrë Guri i Zi						
	Mirushë			Ujvara e Mirushës					Drejtoria e bujqësisë dhe drejtoria e emergjencave, KK Klinë	2010
Malishevë	Mirushë			Ura Toka bujqësore		Gjurgjevikë		Uji i pijshëm		
				Zona industriale						
Gjakovë	Krena			Toka bujqësore	> 10 ha			Uji i pijshëm	Person fizik	2010
				Toka bujqësore	90 ha					
Gjakovë	Krena			Disa shtëpi banorin				Uji i pijshëm	Drejtoria e emergjencave, KK Gjakovë	2010
PELLGU I LUMIT IBËR DHE MORAVA E BINÇËS										
Obiliq	Sitnoë (rjedha e meume)			Kultura bujqësore	> 10 ha			Uji i pijshëm	Drejtoria e emergjencave, KK Obiliq	2010
Fushë Kosovë	Sitnoë (rjedha e meume)			Livadheve dhe tokave bujqësore	> 10 ha	Hencit		Uji i pijshëm	Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës, K.K Fushë Kosovë	2010
Drenas	Drenica			Livadhe dhe toka bujqësore	> 10 ha			Uji i pijshëm	Person fizik	2010
Viti	Morava e Binçës			Kultura bujqësore		Budrikë		Uji i pijshëm	Person fizik	2010



Tabela 15. Pellgu lumor Ibri dhe Morava e Binçës.

PELLGU LUMOR IBRI DHE MORAVA E BINÇËS																					
Komuna	Emri i lumit dhe që doli nga shtrati	Lloji i Evakuimit	Numri banorve	Objektet e Rrezikuara/tokë bujqësore	Numri	Fshatrat	Numri	Kërkesa emergjente	Burimi i raportimit	Viti											
Mitrovica	Ibri			Shtëpi Banimi	19	Këçiq		Ujë të pijshëm	Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim KK Mitrovica	2014											
	Sitnicë (rrejdha e poshtme)			Kompani private	4	Lisicë															
	Lushtë			Motele	2																
	Sitnicë (rrejdha e mesme)	Dy Familje	rreth 10	Shtëpi Banimi	9	Preluzhë															
Vushtri	Llap ( rrejdha e poshtme)					Stanovë	2	Ujë të pijshëm	Shtabi i Gatishmërisë Emergjente	2014											
						Pestovë	6														
						Nadakovc	1														
Prishtinë	Prishtevka	Intervenime publike dhe private	64 nate	Dëmtimi i urës		Blokimi i rrjedhjes së ujit nga mbeturinat në shtratin e lumit	Lukar		Ujë të pijshëm	KK Prishtinës	2014										
							Besi														
							Makofc														
							Mramor														
							Kuçekoll														
							Bërmicë														
							Prugovc														
							Hajvali														
							Lagja Veternik														
							Emishir														
Obiliq	Sitnicë (rrejdha e mesme)	Intervenime publike dhe private	64 nate	Dëmtimi i urës		Blokimi i rrjedhjes së ujit nga mbeturinat në shtratin e lumit	Spiritit		Ujë të pijshëm	Sektorin e Emergjencës të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, dhe drejtori i Shëndetësisë KK Obiliq	2014										
							Fusha e Pajtit														
Podujevë	Llap ( rrejdha e mesme)			Ura		Dëmtimi i rrugës kryesore	Repe	2	Ujë të pijshëm	Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit e Komunës së Podujevës	2014										
							Dumnicë														
							Shtëpi Banimi														
							Shtëpi Banimi														
							Metehi														
							Dobërdol														
							Bajçinë														
							Gllanik														
							Sibovc														
							Llugë														
							Lupë														
							Dumnicë														
							Halabak														
							Temavë														
							Bellopojë														
							Balovcë														
							Surkish														
Svepë																					
Shtedim																					
Viti	Morava e Binçës			Kultura Bujqësore		Dëmtimi i rrugës kryesore	Skiflerg		Ujë të pijshëm	Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës, Komuna e Vitisë	2014										
							Dudrik														
							Remnik														
Gjilan	Morava e Binçës			Kultura Bujqësore		Dëmtimi i rrugës kryesore	Nasale		Ujë të pijshëm	Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim, KK Gjilan	2014										
							Degët Nasalë														
							Velekincë														
							Uglarë														
							Lladovë														
							Zhogër														
							Hashaj														
							Demiraj														
							Shurdhan														
							Kamenica	Morava e Binçës						Kultura Bujqësore		Dëmtimi i rrugës kryesore	Krilevë		Ujë të pijshëm	Drejtoria për Shërbime Publike, KK Kamenicë	2014
																	Degët Hogoelit				
																	Mishinë				
																	Strezovc				
																	Topanicë				
																	Muqivërë				
																	Desivojëc				
																	Rrogan				
Fushë Kosovë	Prishtevka			Kultura bujqësore		Dëmtimi i rrugës kryesore			Vagoli		Ujë të pijshëm						Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës, K.K. Fushë Kosovë	2014			
									Miradi e Poshtëme												
							Miradi e Epërme														

Profili i rrezikut	
<b>Rreziku:</b> Vërshimet.	
<b>Madhësia e mundshme (Përqindja e komunitetit që mund të goditet):</b>	
<b>Kritike.</b>	
<b>Frekuenca e ndodhjes:</b>	<b>Modeli sezonal:</b>
<b>Shumë e mundshme.</b>	<b>Pranveror</b> – Mars dhe Prill. <b>Vjeshtor</b> – Tetor dhe Nëntor. <b>Dimëror</b> – Janar dhe Shkurt.
<b>Zonat që mund të goditen më së shumti:</b> Një pjesë e madhe e territorit të Kosovës.	
<b>Kohëzgjatja e mundshme:</b> 3 - 4 ditë.	
<b>Shpejtësia e mundshme e mësymjes (shuma e mundshme e kohës së paralajmërimit):</b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Paralajmërim minimal (apo fare).</li> <li>▪ Paralajmërim 6 deri 12 orë</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Paralajmërim 12 deri 24 orë.</li> <li>▪ Paralajmërim më shumë se 24 orë.</li> </ul>
<b>Sistemet ekzistuese të paralajmërimit:</b> Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës.	
<b>A ekziston analiza e dobësive/cenueshmërisë?</b>	
Po	<input checked="" type="checkbox"/>
Jo	<input type="checkbox"/>

### Cënueshmëria nga goditjet në faktorët kyç të komunitetit.

Profili	Pasojat e mundshme	Shkalla e goditjes
Banorët	Vdekje, lëndime apo sëmundje që rezultojnë në paaftësi të përhershme. (Për shkak të goditjes së valës së ujit, rrënimeve, dhe prurjeve të materive të ngurta).	E ashpër
Pasuria	Në shumë regjione të Kosovës uji depërton në oborret dhe shtëpitë e qytetarëve, duke shkatërruar pasurinë, dhe të mirat materiale të qytetarëve.	E ashpër
Infrastruktura vitale	Shkatërrim/dëmtim i rrjetit të ujësjellësit, kanalizimit dhe energjisë, tokave bujqësore, teknologjisë informative.	E ashpër
Objektet e rëndësisë së veçantë	Shkatërrim/dëmtim i objekteve shkollore, objekteve qeveritare, rrugëve, urave etj.	E ashpër
Shërbimet emergjente	Dëmtime të pajisjeve të njësive reaguese.	E mesme
Ambienti	Dëmtim /degradim i mjedisit ( për shkak të prurjeve të mëdha të ndryshme, lymit dhe kontaminimit ).	E ashpër
Trashëgimia kulturore	Shkatërrim / dëmtim i objekteve të trashëgimisë kulturore.	E ashpër
Shërbimet shtetërore	Dëmtim i shërbimeve shtetërore dhe shërbimeve për qytetarë.	E mesme
Dëmet ekonomike	Shkatërrim/ dëmtim i madh i shtëpive, pasurisë, infrastrukturës vitale, etj.	E ashpër

**Skenari 1.**

Pas shirave disa ditësh të vjeshtës, regjioni i Prizrenit, Pejës, Mitrovicës dhe Prishtinës (Pejë, Skenderaj, Vushtrri, Podujevë, Therandë), janë goditur nga vërshimet. Situata është e rëndë, ka shumë të lënduar (supozohet se ka mbi 20 të lënduar), në mesin e tyre pleq dhe fëmijë, njerëz të mbetur në kulme, si dhe mbi 100 banorë që duhet të evakuhohen, pastaj ka shtëpi të përmbytura, bagëti të mbytura, rrugët janë të mbuluara me lym, dëmtime të konsideruara të ujësjellësit dhe kanalizimeve, kontaminim të ujërave dhe tokës, si dhe dëmtim të sistemit energjetik.

**Skenari 2.**

Bora me trashësi mbi 80 cm që kishte rënë disa ditë me radhë në territorin e Republikës së Kosovës, ka filluar të shkrihet si pasojë e temperaturave të larta ndikuar nga pasojat e ngrohjes globale. Kjo shkrirje e shpejtë ka bërë që vërshimet të mbulojnë tërë territorin e Kosovës, duke shkaktuar, viktime (6 të vdekur, mbi 27 të lënduar), shkatërrime në pasuri, në rrugë, ujësjellës, kanalizime, rrjetin elektrik, paralizimin e shërbimeve emergjente dhe shërbimeve tjera për qytetarë. Numri i personave që duhet evakuuar për një kohë 3 deri 7 ditë është mbi 1550 në tërë territorin e Republikës.

**Konkludim:**

Fatkeqësitë natyrore e në veçanti vërshimet nuk paraqiten në nivel të përshkallëzuar apo katastrofik falë relievit dhe klimës së favorshme. Llojet e vërshimeve në Kosovë janë të çastit (të rrëkeshme) dhe kohëzgjatja e tyre është afatshkurtër (3-4 ditë). Kosova është vendburim i ujit. Vendi ynë disponon me institutin hidro meteorologjik, i cili bën parashikimin e motit dhe ofron të dhëna meteorologjike por mungon sistemi i paralajmërimit të hershëm.

**6.3. Tërmetet**

Në zonimin sizmik mbarë botëror, Kosova zë vënd në brezin sizmik Alpin-Mesdhetar. Ky brez sizmik përfshin një zonë të gjërë kontakti midis pllakave litosferike të Afrikës dhe Euroazisë, që nga ishujt Azore deri në kufirin lindor të basenit Mesdhetar. Koncepti i tektonikës së pllakave është veçanërisht i komplikuar në këtë zonë për shkak të pranisë së një numri të madh blloqesh, si dhe mënyrës së çlirimit të energjisë së akumuluar gjatë procesit të deformimit plastik në pjesën më të madhe të saj.

Nga pikëpamja sizmologjike territori i Kosovës paraqet një rajon me aktivitet sizmik relativisht të lartë, i cili është goditur në të kaluarën dhe mund të goditet edhe në të ardhmen nga tërmetet autoktone shumë të forta, të cilët i kanë vatrat e cekta, që gjenerohen në koren e tokës, maksimum 15 - 20 km thellë në nëntokë.

**Historiku dhe situata e tanishme**

Studimet e sizmicitetit varen shumë nga informacioni që disponohet, nga plotësia dhe besueshmëria e të dhënave mbi tërmetet që paraqiten në katalogun e tërmeteve. Për një vlerësim sa më të bazuar të rrezikut sizmik, janë shfrytëzuar të gjitha burimet e informacionit për tërmetet dëmtuese në rajon, siç janë katalogët e tërmeteve të Shqipërisë, Malit të Zi, Kroacisë, Serbisë, Maqedonisë, Greqisë (Selanikut), buletinet e Qendrës Ndërkombëtare të tërmeteve (ISC), Katalogu i tërmeteve për Europën Jugore dhe Juglindore 342 BC - 1990 AD, EU Commission (342 BC - 1990 AD), Katalogu i Ballkanit (600 BC - 1970 AD), NEIC - Qendra Kombëtare Sizmologjike USGS (1973 - 2008), si dhe ANSS - Sistemi Sizmik Kombëtar i Avancuar (USGS).

Territori i Kosovës gjatë periudhës 1456-2014 është goditur me 152 tërmete me magnitudë 3.5-6.3 shkallë të Rihterit. Nga 89 tërmete me intensitet 5 ballë, nga 37 tërmete me intensitet 6 ballë, nga 13 tërmete me intensitet 7 ballë, nga 10 tërmete me intensitet 8 ballë (1 tërmet i përket periudhës para vitit 1900) dhe nga 3 tërmete me intensitet 9 ballë (2 tërmete i përkasin periudhës para vitit 1900), tabela 16.

**Tabela 16. Intenziteti dhe numri i tërmeteve.**

Intensiteti i tërmeteve në Shkallë të Merkalit MSK-64 scale	V	VI	VII	VIII	IX
Numri i tërmeteve	89	37	13	10	3

Harta e epiqendrave të tërmeteve<sup>15</sup> është e përpiluar duke u mbështetur në katalogun e tërmeteve dhe Rrjetit Sizmologjik të Kosovës për territorin e Kosovës, që përfshin edhe të dhënat për tërmetet e intensitetit të ulët, duke filluar prej atyre me magnitudë 3.8 e më lartë, respektivisht me intensitet V ballë e lartë. Këto janë rezultatet më të rëndësishme dhe faktorë të pazëvendësueshëm, të cilët tregojnë se pjesa më e madhe e territorit të Kosovës, pikërisht pjesa më e madhe e qyteteve dhe vendbanimeve tjera, janë të vendosura mbi vatrat e tërmeteve autoktone, të gjeneruar nga nëntoka, në thellësi të caktuara të korës së tokës.

### Tërmetet më të fuqishme që kanë goditur Kosovën

Si rezultat i burimeve nga shërbimet sizmologjike të lartëshenuara nga rajoni dhe Rrjetit Sizmologjik të Kosovës të dhënat më të plota për tërmetet që kanë prekur territorin e Kosovës, ekzistojnë gjatë periudhës 1900 - 2014. Të dhënat e mëhershme janë të pakta. Ndër tërmetet më të fuqishëm që kanë goditur Kosovën mund të përmendim:

1. Tërmeti i Prizrenit, 16 qershor 1456 (MS=6.0; 42.200°N, 20.700°E) me intensitet në epiqendër 8 ballë (Sulstarova, 2005),
2. Tërmeti i Pejës, 11 nëntor 1662 (MW=6.0; 42.700°N; 20.300°E) me intensitet në epiqendër 8 ballë (Sulstarova, 2005; Papazachos et al. 2000),
3. Tërmeti i Ferizajt, 26 shkurt 1755 (M=6.1; 42.500°N; 21.900°E) me intensitet në epiqendër 9 ballë (Elezaj, 2002),
4. Tërmeti i Ferizaj-Vitisë, 10 gusht 1921 (ML=6.1; 42.300°N; 21.300°E) me intensitet në epiqendër 9 ballë (Elezaj, 2002),
5. Tërmeti i Vitisë, 15 gusht Maj 1921 (MW=5.4; 42.020' N, 21.020' E) me intensitet në epiqendër 8 ballë (SO Skopje, D. Hadzievski),
6. Tërmeti i Gjilanit, 02 shtator 1921 (MW = 5.0; 42.024' N, 21.030' E) me intensitet në epiqendër 8 ballë (SO Skopje, D. Hadzievski),
7. Tërmeti Kaçanik-Viti 03 tetor 1921 (MW = 5.6; 42.020'N, 21.020'E) me intensitet në epiqendër 8 ballë (SO Skopje, D. Hadzievski),
8. Tërmeti i Gjakovës, 03 shtator 1922 (MW = 5.3; 42.025'N, 21.025'E) me intensitet në epiqendër 7 | 2 ballë (SO Skopje, D. Hadzievski),

9. Tërmeti i Prizrenit, 26 shtator 1945 (MW = 5.0; 42.015'N, 21.045'E) me intensitet në epiqendër 7 ballë (SO Skopje, D. Hadzievski),
10. Tërmeti i Klinës, 05 shkurt 1947 (MW = 5.2; 42.030'N, 21.045'E) me intensitet në epiqendër 8 ballë (SO Skopje, D. Hadzievski),
11. Tërmeti i Kopaonikut, 18 maj 1980 (MW=5.7; 43.307°N; 20.867°E) me intensitet në epiqendër 8 ballë (Harvard University, SO Skopje, D. Hadzievski),
13. Tërmeti i Gjilanit, 24 prill 2002 (MW=5.7; 42.440 °N, 21.590° E), me intensitet në epiqendër 8 ballë (ISC 2002, Elezaj 2002),
14. Tërmeti i Istogut, 10 mars 2010 (MW = 5.2; 42.763440N, 20.628110E) me intensitet në epiqendër 7 ballë (SIK Sh.Mustafa, 2010),
15. Tërmeti i Vushtrrisë, 18 nëntor 2013 (MW =4,8; 42.9 N; 21.014 E) me intensitet në epiqendër 6 | 2 ballë (SHGJK Sh. Mustafa, 2013).

### Zonat e burimeve sizmike në Kosovë

Harta e burimeve sizmike në Kosovë është përpiluar duke u bazuar në hartën epiqendrore, duke i rrethuar disa zona epiqendrore me kufij, në të cilat në aspektin hapësinor tregohen burimet sizmogjene. Për këtë arsye kjo hartë përfaqëson gjendjen e ndodhur faktike dhe mbështetet kryesisht në periudhën 1900-2009, duke marrë në konsideratë edhe tërmetet e fuqishme historike. Kjo hartë përcakton pozitën, orientimin dhe madhësinë e burimeve sizmogjene.

42

Me ndihmën e kësaj harte kemi caktuar pozitën, madhësinë dhe orientimin e burimeve sizmike prej nga gjenerojnë tërmetet në territorin e Kosovës. Kjo hartë siç do të shihet më vonë, do të gjejë aplikim konkret në vlerësimin e rrezikut sizmik të Kosovës.

Siç shihet prej kësaj harte, rajoni Ferizaj-Viti-Gjilan përfaqëson një ndër burimet sizmike më të fuqishme, në të cilin ka ndodhur tërmeti më i fortë autokton, ai i vitit 1921 me magnitudë 6.2 dhe intensitet epiqendror IX ballë MSK-64. Rajoni Pejë-Gjakovë-Prizren-Dragash përfaqëson burimin sizmik tjetër në Kosovë ku është regjistruar tërmeti i vitit 1456 me magnitudë 6.6 të shkallës Rihter (Sulstarova et al., 2001). Edhe rajoni Kopaonik është një ndër zonat e fuqishme të burimeve sizmike, kjo është dëshmuar nga tërmeti i vitit 1980 me magnitudë 6.0.

Këto zona të burimeve sizmike në Kosovë kanë gjeneruar në të kaluarën dhe mund të gjenerojnë edhe në të ardhmen tërmete të forta.

### Harta e Rrezikut Sizmik 2009

Përpilimi i hartës së rrezikut sizmik mbështetet tërësisht në metodologjitë probabilitare të cilat konsistojnë në vlerësimin sasior të lëkundjes së truallit në një shesh të dhënë si rezultat i ndonjë tërmeti që ka gjasa të ndodhë brenda një intervali kohor të përcaktuar. Në terma më konkretë, rreziku sizmik në një vend të caktuar përcaktohet si vlerë e pritshme e ndonjë parametri të lëkundjes së truallit (nxitimi, shpejtësia, ordinatat spektrale, intensiteti makrosizmik, etj.), që me një probabilitet të dhënë nuk tejkalohet brenda një periudhe të caktuar kohe. Zakonisht, programet e vlerësimit të rrezikut sizmik pranojnë nivelin 10% si probabilitet tejkalimi të pragut të dhënë të ndonjë parametri të lëkundjes së truallit, brenda një periudhe 50 vjeçare. Kjo i korrespondon përsëritjes së dukurisë përkatëse një herë në 475 vite.

Rezultatet janë paraqitur në termat e nxitimit maksimal të truallit (PGA) dhe të nxitimeve spektrale (SA) me shuarje 5%, për periodat e përsëritjes 95, 475, 975, 2475, 5000 dhe 10000 vjet, që u korrespondojnë përkatësisht probabiliteteve të tejkalimit 10% në 10 vjet, 10%, 5%, 2% e 1% në 50 vjet, dhe 1% në 100 vjet. Vlerësimi është kryer për kushte trualli-shkëmb, me shpejtësi mesatare të valëve tërthore në 30 metrat e para të tokës  $VS=800$  m/sek, që i korrespondon kategorisë A të truallit sipas klasifikimit të Eurokodit 8. Kështu që rezultatet e vlerësimit janë në pajtueshmëri të plotë me standardin e Eurokodit 8 për zonimin sizmik dhe kodet e ndërtimit. Mbi bazën e rezultateve të marra nga llogaritjet, u ndërtuan hartat e rrezikut sizmik që karakterizojnë ndryshueshmërinë hapësinore të PGA dhe të SA-ve për indeks shuarje 5%, për periodat 0.1 sek, 0.2 sek, 0.3 sek, 0.5 sek, 1.0 sek dhe 2.0 sek, me probabilitete tejkalimi 10% në 10 vjet dhe 10%, 5%, 2%, e 1% në 50 vjet, si dhe 1% në 100 vjet.

Këto të dhëna mbështen në kërkime intensive të 10-vjetëve të fundit dhe në një bazë të përditësuar të dhënash. Baza e të dhënave të tërmeteve, si për periudhën historike ashtu edhe për atë instrumentale, është përmirësuar gjerësisht dhe është konvertuar në një shkallë uniforme, në magnitudën.

Rajoni i Prishtinës, paraqitet me rrezik sizmik mesatar, rreth 0.11 g për periudhë përsëritje 475 vjet. Vlerat më të vogla të nxitimit maksimal vihen re në pjesën lindore të vendit, në lindje të Prishtinës deri në kufirin me Serbinë, ku me probabilitet 10% në 50 vjet, PGA nuk e kalon vlerën 0.10-0.12g.

Hartat e rrezikut sizmik<sup>16</sup> tregojnë se pjesa më e madhe e territorit të Kosovës mund të konsiderohet si zonë me rrezik sizmik mesatar ( $0.08g < PGA < 0.22g$ ). Nxitimi horizontal maksimal i truallit (PGA), me 10% probabilitet tejkalimi në 50 vjet (periudhë përsëritje 475), varijon nga 0.10g në pjesën verilindore të vendit deri në 0.20-0.22g në veri dhe në jug të Kosovës. Zona me rrezik të lartë mund të konsiderohet zona e Kopaonikut në veri të Kosovës ( $PGA=0.17-0.20g$ ), zona Prizren-Pejë, veçanërisht në lindje dhe juglindje të Prizrenit, pranë kufirit me Shqipërinë, ku PGA, me probabilitet tejkalimi 10% në 50 vjet e kalon nivelin 0.22g, si dhe zona Ferizaj-Viti Gjilan, veçanërisht në drejtim të Shkupit, ku PGA varijon nga 0.15 - 0.18 g.

Bazuar në Hartën e Rrezikut Sizmik, territori i Kosovës veçanërisht rajoni perëndimor i saj karakterizohet me aktivitet sizmik relativisht të lartë, ku në të kaluarën kanë ndodhur tërmete të forta, vatrat e të cilave në përgjithësi evidentohen të cekta, 15-20 km. Zonat kryesore burimore sizmike në Kosovë janë si më poshtë: (SHGJK, Divizioni Sizmik<sup>17</sup>).

1. Zona sizmogjene Prizren-Pejë,
2. Zona sizmogjene Ferizaj-Viti-Gjilan,
3. Zona sizmogjene e Kopaonikut.

Në bazë të Hartës së Rrezikut Sizmik shihet se perioda e përsëritjes për tërmetet me magnitudë  $MW=5.0, 5.5, 6.0$  dhe  $6.5$  janë përkatësisht 3.1, 14.2, 69.8 dhe 502.4 vjet, ndërsa një tërmet me  $MW=6.7$  përsëritet mesatarisht çdo 2446 vjet. Nga pikëpamja probabilitare, çdo vit në Kosovë mund të pritet një tërmet me magnitudë deri në 5.0 me probabilitet 27.8%, çdo 50 vjet pritet një tërmet me  $MW=6.0$  me probabilitet 51.2%, dhe çdo shekull, një tërmet me magnitudë deri në 6.0 me probabilitet 76.2%.

16 Shih në shtojcë, Harta nr.9. Zonat e rrezikut sizmik në Kosovë

17 Rrjeti Sizmologjik i Republikës së Kosovës është krijuar në vitin 2008 me ç'rast ka filluar edhe puna studimore për tërmetet.



Në periudhën 2002-2013, territori i Kosovës u godit tri herë me Mag. 4.8-5.7 shkallë të Rihterit.

1. Tërmeti i Gjilanit 24.04.2002, Mag.5.7, intensiteti VIII1/2.
2. Tërmeti i Istogut 10.03.2010, Mag.5.2, intensiteti VII.
3. Tërmeti i Vushtrrisë 18.11.2013, Mag.4.8, intensiteti VII\2.

Rreziku sizmik dhe hartat probabilitare aktuale janë llogaritur për kondita trualli-shkëmb. Megjithatë, kushtet lokale të truallit brenda disa qindra metrave mund të shkaktojnë variacione të tilla në rrezikun sizmik, që janë më të mëdha se variacionet në rang vendi. Shumica e rajoneve urbane janë vendosur përgjatë luginave të lumenjve, mbi depozitime të shkrufta. Lëkundja e truallit në depozitime të tilla, përgjithësisht është shumë më e madhe se në zhveshjet shkëmbore, për shkak të efekteve lokale mbi amplitudën e sinjalit dhe përmbajtjen frekuenciale të tij, si dhe mbi kohëzgjatjen e lëkundjes së truallit.

Hartat e rrezikut sizmik përditësohen me qëllim përfshirjen në to të arritjeve më të fundit të shkencës së sizmologjisë në nivel vendor, rajonal dhe botëror.

### **Faktorët e përkeqësimit**

Reshjet atmosferike, erërat dhe ndryshimi i temperaturave janë faktor përkeqësues, si në mundësinë e dridhjeve të mëvonshme, po ashtu edhe në përkeqësimin dhe krijimin e kushteve të vështirësuar për reagim dhe përkujdesje për banorët goditur.

44

Ndërtimi pa kritere dhe cilësia jo adekuate e strukturave ndërtimore në Kosovë i bënë të ndjeshme vendbanimet e saj.

### **Flukset e rreziqeve:**

- Shembja e objekteve të larta banesore dhe atyre publike,
- Dëmet në infrastrukturë dhe transport,
- Çrregullimet në ambient (rrjedha e ujit, rrëshqitja e terrenit),
- Efektet sekondare (zjarret, shembjet, rrjedhja e kanalizimeve dhe e prodhimeve toksike etj).

Profili i rrezikut	
<b>Rreziku:</b> Tërmetet.	
<b>Madhësia e mundshme (Përqindja e komunitetit që mund të goditet):</b> Kritike.	
<b>Frekuenca e ndodhjes:</b> <b>Ka gjasa.</b>	<p><b>Modeli sezonal:</b></p> <p>Gjasat e përsëritjes së tërmeteve me magnitudë MW=5.0, 5.5, 6.0 dhe 6.5 janë përkatësisht 3.1, 14.2, 69.8 dhe 502.4 vite; një tërmet me MW=6.7 përsëritet mesatarisht çdo 2446 vite.</p> <p>Nga pikëpamja probabilitare, çdo vit në Kosovë mund të pritet një tërmet me magnitudë deri në 5.0 me probabilitet 27.8%; çdo 50 vite pritet një tërmet me MW=6.0 me probabilitet 51.2%; çdo shekull, me probabilitet 76.2% pritet një tërmet me magnitudë 6.0.</p>
<b>Zonat që mund të goditen më së shumti:</b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Zona sizmoghene Prizren-Pejë,</li> <li>- Zona sizmoghene Ferizaj-Viti-Gjilan,</li> <li>- Zona sizmoghene e Kopaonikut.</li> </ul>	
<b>Kohëzgjatja e mundshme:</b> E çastit (2-10 Sek.).	
<b>Shpejtësia e mundshme e mësymjes (shuma e mundshme e kohës së paralajmërimit):</b>	
Pa paralajmërim.	
<b>Sistemet ekzistuese të paralajmërimit:</b> Nuk ka.	
<b>A ekziston analiza e dobësive/cenueshmërisë?</b>	
<input type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> Jo	

### Cënueshmëria nga goditjet në faktorët kyç të komunitetit

Profili	Pasojat e mundshme	Shkalla e goditjes
Banorët	Dhjetëra vdekje, qindra lëndime të rënda dhe trauma.	E ashpër
Pasuria	Shkatërrim / dëmtim i pasurisë publike dhe private.	E ashpër
Infrastruktura vitale	Shkatërrim / dëmtim i rrjetit: rrugor, të ujësjellësit dhe kanalizimit, energjetik, telekomunikacionit, etj.	E ashpër
Objektet e rëndësisë së veçantë	Shkatërrim / dëmtim i ndërtesave të administratës, bankat, zyrat, objektet shkollore, objektet qeveritare, dyqanet, qendrat tregtare, restorantet, etj.	E ashpër
Dëmet ekonomike	Shkatërrim / dëmtim i pasurisë publike dhe private .	E ashpër
Ambienti	Dëmtim / degradim i mjedisit për shkak të derdhjeve të ndryshme, gazrave dhe tymit, kontaminim i ajrit, ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, tokës pjellore, ushqimit dhe kafshëve.	E ashpër
Trashëgimia kulturore		E ultë
Shërbimet shtetërore	Dëmtim i shërbimeve shtetërore dhe shërbimeve për qytetarë.	E mesme
Shërbimet emergjente	Dëmtime të mjeteve dhe pajisjeve të shërbimeve reaguese emergjente.	E mesme

**Skenari 1.**

Një tërmet i magnitudës 5.5 të shkallës së Richterit ka goditur një pjesë të madhe të rajonit të Mitrovicës, Veriun e Kosovës (Kopaonikut), për dy ditë rresht, 3 dhe 4 dhjetor dhe ka goditur në mënyrë të ashpër banorët, qytetet, fshatrat, rrugët dhe fabrikat duke shkaktuar këto pasoja: mbi 20 të vdekur, qindra të lënduar, qindra të ngujuar dhe të zhdukur, dëmet tjera janë: Shembja e ndërtesave të banimit dhe të atyre publike, dëmet në infrastrukturë dhe transport, çrregullimet në ambient (rrjedha e ujit, rrëshqitja e terrenit).

Efektet sekondare të kësaj fatkeqësie janë (zjarret, shembjet, rrjedhja e kanalizimeve dhe e prodhimeve toksike etj). Dysohet se ka qarje në pendën e Ujmanit (Gazivodës), e cila nëse shpërthen do të rrezikojë tërë regjionin e Mitrovicës me një katastrofë shkatërrimtare.

**Skenari 2.**

Tërmeti i magnitudës 6.5 të shkallës së Richterit me 5 dhe 6 dhjetor ka goditur Kosovën lindore, veriore, perëndimore dhe jugore. Tërmeti ka shkaktuar qindra viktima, mijëra të lënduar, të zhdukur dhe të ngujuar si dhe ka shkatërruar ndërtesa, shtëpi banimi, infrastrukturën kritike, akset rrugore dhe ka paralizuar tërë jetën dhe shërbimet në Republikën e Kosovës.

**Konkludim**

Në tërë territorin e Republikës së Kosovës ekziston rreziku i tërmeteve. Duke pasur parasysh se zonat më të rrezikuara janë Zona sizmogjene Prizren-Pejë, Zona sizmogjene Ferizaj-Viti-Gjilan, Zona sizmogjene e Kopaonikut, ku jeton gati gjysma e popullsisë së Kosovës. Kjo sipërfaqe dhe ky numër i popullsisë, gjatë tërmeteve mund të ketë pasoja kritike si: vdekje dhe lëndime, evakuime, shkatërrime të mëdha të ndërtesave, ndërprerje komunikacioni, bllokim rrugësh. Gjithashtu, numri i të rrezikuarve do të shtohet si pasojë e rreziqeve sekondare si: eksplozimet, zjarret, vërshimet dhe epidemitë.

Vlerësimi i rrezikut sizmik në Kosovë, krijon bazat për një politikë moderne në zbutjen e pasojave nga tërmetet, ndërsa rezultatet e fituara mund të përdoren nga autoritetet kombëtare dhe lokale, si dhe nga organizatat dhe individët që interesohen për planifikimin dhe administrimin e territorit, projektimin e strukturave rezistence ndaj tërmeteve, etj, duke mundësuar integrimin e shkallës së shtesë të njohjes dhe reagimin ndaj nevojave në ndryshim të komunitetit të përdoruesve.

**Rekomandim**

Me qëllim të përmirësimit të rezultateve mbi rrezikun sizmik rekomandojmë:

- Rivlerësimin e magnitudës së tërmeteve historike që kanë goditur territorin e Kosovës.
- Një vlerësim më të bazuar të parametrave të sizmicitetit, duke përmirësuar bazën e të dhënave të tërmeteve që kanë goditur Kosovën dhe rajonet fqinje.
- Një model sizmotektonik rajonal, që lidh sizmicitetin e vrojtuar me thyerjet tektonike aktive, mekanizmin e tyre të prishjes, etj.
- Modele më të sakta për prognozimin e parametrave të lëkundjes së truallit, të bazuar në regjistrimet rajonale të lëkundjeve të forta, në Kosovë dhe në rajonet fqinje.
- Hartimi i një programi studimor disa-vjeçar për rishikim dhe saktësim të mëtejshëm të hipoqendrave të tërmeteve të Kosovës.

Masat para- tërmetit që duhet të ndërmerren në rajonet me aktivitet sizmik:

- Përpunimi i hartës së rrezikut sizmik të vendit në bazë të dhënave sizmike për nivele të ndryshme të rrezikut sizmik të pranueshme për planifikimin, projektimin dhe ndërtimin.
- Përpunimin e hartave të mikrozonimit sizmik<sup>18</sup> për zonat urbane të rëndësishme.
- Përpunimi i një harte të Riskut Sizmik.
- Përpunimi i ligjeve dhe rregulloreve për masat kundër tërmeteve me shkallë të madhe.
- Zgjerimi dhe modernizimi i rrjetit me sizmografa dhe akcelografa.

#### 6.4. Rrëshqitjet

Duke u mbështetur në ndërtimin litologjik, tektonik, morfologjik, klimatik, hidrologjik etj., mund të konkludohet se shumë pjesë të territorit të Kosovës janë të përfshira nga një numër i proceseve ekzodinamike, kryesisht të përfaqësuara nga rrëshqitjet dhe shembjet të terrenit.

Në kompleksin e dukurive shpatore një vend të rëndësishëm në modelimin e relievit të Kosovës luajnë edhe rrëshqitjet në përmasa të ndryshme, të cilat në disa raste kalojnë në shembje të fuqishme, veçanërisht gjatë rrëpirave tektonike. Rrëshqitjet gjatë kontakteve tektonike të shkëmbinjve magmatik me ata terrigjen janë mjaft të zhvilluara, pra gjatë brezit të shkatërrimit duke përfshirë kryesisht materialet copëzore koluvo-proluviale dhe ato deluviale të kores së tjetërsimit. Këto materiale të grumbulluara rrëzë rrëpirave të shkëputjeve dhe atyre komplekse gjatë evolucionit morfotektonik dhe morfoklimatik të tyre, karakterizohen nga një gjendje e paqëndrueshme, e nxitur edhe nga rrjedhjet ujore të shumta falë shkallës së papërshkueshmërisë së tyre.

Dukuritë e jo stabilitetit të terrenit, të cilat kryesisht paraqiten në format e rrëshqitjeve dhe shembjeve, më të shprehura janë në: Shpatet e Kopaonikut, Rogoznes, Bjeshkëve të Nemura, Malit Sharr, maleve qendrore dhe atyre lindore të Kosovës. Dukuritë e rrëshqitjeve<sup>19</sup> i hasim edhe në pjesë të ulëta të terrenit në zonat e baseneve të neogjenit (Dukagjinit, Kosovës, Llapit, Drenicës, Moravës së Binçes) dhe pjesë tjera.

#### Konkludim:

Në bazë të kërkimeve të deritanishme gjeologo-inxhinierike të terrenit mund të konkludohet se pjesa më e madhe e zonave jo stabile janë të lidhura me ndërtimin gjeomorfologjik të terrenit mbi bazën e të cilave është ndërtuar harta me zona me potencial gjeo-rreziku.

18 Mikrozonimi është metoda e preferuar për të vlerësuar amplifikimin lokal të truallit në funksion të frekuencës. Niveli më i lartë i studimeve për të kuptuar efektet lokale, janë modelet 3- përmasorë gjeologjike e gjeofizikë, dhe modelimi numerik i amplifikimit të lëkundjes së truallit.

19 Shih në shtojcë, Harta nr 10. Zonat me rrëshqitje.

Profili i rrezikut	
<b>Reziku:</b> Rrëshqitjet.	
<b>Madhësia e mundshme (Përqindja e komunitetit që mund të goditet):</b> Kritike.	
<b>Frekuenca e ndodhjes:</b> ▪ E mundshme.	<b>Modeli sezonal:</b> <b>Pranveror</b> – Mars dhe Prill. <b>Vjeshtor</b> – Tetor, Nëntor dhe Dhjetor. <b>Dimëror</b> – Janar dhe Shkurt.
<b>Zonat që mund të goditen më së shumti:</b> Zonat jo stabile të lidhura me ndërtimin gjeomorfologjik të terrenit, rënia e theksuar e shtresave të shkëmbinjve që e ndërtojnë lokacionin, vegjetacioni, ujërat sezonal edhe ata të përhershëm.	
<b>Kohëzgjatja e mundshme:</b> Relativisht e shkurt 3 - 4 ditë; Relativisht e gjatë- disa muaj; E gjatë disa dhjetra vite me disa pauza të lëvizjeve të masave shkëmbore;	
<b>Shpejtësia e mundshme e mësymjes (E mundshme e kohës së paralajmërimit):</b>  <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Paralajmërim minimal (apo fare).</li> <li>▪ Paralajmërim 6 deri 12 orë.</li> <li>▪ Paralajmërim 12 deri 24 orë.</li> <li>▪ Paralajmërim më shumë se 24 orë.</li> </ul>	
<b>Sistemet ekzistuese të paralajmërimit:</b> Numri Integruar 112.	
<b>A ekziston analiza e dobësive/cenueshmërisë?</b> Po <input checked="" type="checkbox"/> X Jo <input type="checkbox"/>	

### Cënueshmëria nga goditjet në faktorët kyç të komunitetit.

Profili	Pasojat e mundshme	Shkalla e goditjes
Banorët	Vdekje, lëndime apo sëmundje që rezultojnë në paaftësi të përhershme.	E ashpër
Pasuria	Shkatërrime/ dëmtime të objekteve të banimit, rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit, etj.	E ashpër
Infrastruktura vitale	Shkatërrim / dëmtim i infrastrukturës rrugore, rrjetit elektrik dhe telekomunikimit, etj.	E ashpër
Objektet e rëndësisë së veçantë	Shkatërrim/ dëmtim i objekteve shkollore, QMF, objekteve qeveritare, etj.	E ashpër
Shërbimet emergjente	Dëmtime të pajisjeve të njësisve reaguese.	E mesme
Ambienti	Degradim i mjedisit.	E ashpër
Trashëgimia kulturore	Shkatërrim/ dëmtim i objekteve të kultit.	E ashpër
Shërbimet shtetërore	Dëmtim i shërbimeve shtetërore dhe shërbimeve për qytetarë.	E mesme
Dëmet ekonomike	Shkatërrim/ dëmtim i madh i shtëpive, pasurisë, infrastrukturës vitale, etj.	E ashpër

**Skenari 1.**

Niveli i lartë i të reshurave gjatë stinëve: vjeshtë- dimër dhe pranverë të vitit 2013, fshati Crmjan/Gjakovë është përfshirë në disa vende me rrëshqitje. Me këtë rast janë shkaktuar dëme të konsiderueshme në tokat bujqësore, rrugë dhe rrjetit të ujësjellësit. Në rast të vazhdimit me të reshura në periudha më të gjata, mundësitë e riaktivizimit të rrëshqitjeve janë të larta duke rrezikuar edhe shkatërrimin e shtëpive. Nuk përjashtohen edhe humbjet e jetëve në njerëz, blegtori dhe shpezëtari.

**Skenari 2.**

Rrëshqitja në fshatin Brod KK Shtërpçë, e riaktivizuar në pranverën e vitit 2007 duke shkatërruar në tërësi 70 % të shtëpive të këtij fshati, objektet përcjellëse si stallat, garazhet, rrjetin elektrik, shkollën, ambulanten. Rreth 36 familje të përfshira nga rrëshqitja dhe të rrezikuara.

**Skenari 3.**

Aksi rrugor Kaçanik – Hani i Elezit i ndikuar nga fenomenet e rrëshqitjeve dhe rrokullisjeve të masave shkëmbore rrezikojnë komunikacionin mjaft të ngarkuar me mjete motorike të peshave të ndryshme. Mundësitë e atakimit direkt për të shkaktuar dëme në njerëz të cilët e shfrytëzojnë këtë aks për të udhëtuar me autobus apo tren janë reale, sepse në periudhat me të reshura rrëshqitjet e përmasave të mëdha shkëmbore mund të ndodhin befasishtëm. Dëmet përveç në njerëz do të jenë edhe në ekonominë e shtetit sepse në situata të tilla bllokohet për periudha të gjata transporti i mallrave nga Maqedonia.

**Konkludime:**

Numri i familjeve që janë shumë të rrezikuara është i madh.

Duke u bazuar në faktin se rrëshqitjet e dheut janë aktive, gjendja mund të jetë alarmante.

Nëse vazhdojnë të reshurat më gjatë situata do të keqësohet edhe më shumë.

**Rekomandime:**

Për shkak të rrëshqitjeve të mundshme të dheut dhe rrezikut permanent që kanoset rekomandohet:

- Të bëhet studimi gjeologo- gjeomekanik i tokave ndërtimore.
- Të autorizohen institucionet në bashkëpunim me K. Komunale për hartimin, implementimin dhe menaxhimin planeve për parandalimin dhe menaxhimin e situatave të tilla.
- Të sigurohen hartat ( Orto-foto dhe sipërfaqet kadastrale për fsh. Brod) nga Agjensioni Kadastral i Kosovës, si dhe të bëhet incizimi gjeodezik i terrenit në fjalë.
- Të ndahen mjete buxhetore nga buxheti i konsoliduar i Kosovës për ndërmarrjen e masave për sanimin e dëmeve dhe aplikimin e metodave adekuate për rehabilitimin e terrenit.
- Implementimin dhe menaxhimin e Strategjisë për Dislokim/Rilokim të banorëve.



## 6.5. Rrokullisjet e masave shkëmbore në territorin e Kosovës

Këto janë karakteristike për shkëmbinjtë e fortë dhe relativisht të fortë. Ato karakterizohen nga rënie copash dhe blloqesh me rrokullisje në rrëzë të shpatit duke formuar një konus produktesh. Ato lindin kryesisht si rezultat i procesit të tjetërsimit në shpate me pjerrtësi të madhe ose nën ndikimin e shpërthimeve të ndryshme sidomos në shkëmbinjtë me çarje.

Si faktor kryesor që çojnë në humbjen e lidhjes së brendshme të masivit janë çarjet e tjetërsimit, zhvillimi i rrënjëve të bimëve në çarje, ndryshimet e shpejta të temperaturës që të çojnë në ngrirjen dhe shkrirjen e ujit në çarje të ndryshme të shkëmbinjve etj. Madhësia e copave varet kryesisht nga lloji i shkëmbit dhe koeficienti i çashmërisë së tij. Kjo dukuri shpesh paraqet rrezik permanent për njeriun dhe të mirat materiale, si dhe rrezikon komunikacionin.

Rrokullisjet e masave shkëmbore:

- përgjatë aksit rrugor Prishtinë Shkup ( Kaçanik Hani i Elezit);
- në Regjionin i Pejës (Gryka e Rugovës);
- në territorin e bjeshkëve të Nemura;
- përgjatë luginës së Lumit Ibër (Pjesa Veriore e Kosovës);
- Rajoni i Shalës së Bajgorës, dhe
- në Zonën e Grebnikut, Periferia e fshatit Çupevë e Epërme.

Në bazë të studimeve të bëra deri më tani është arritur të krijohet harta e cila paraqet zonat me potencial të shfaqjes së dukurisë së rrokullisjeve të masave shkëmbore.<sup>20</sup>

### Minierat sipërfaqësore të braktisura

Zhvillimi i hovshëm i industrisë ndërtimore dhe infrastrukturës rrugore ka paraqitur nevojën e madhe të hapjes së shumë minierave (karierave) sipërfaqësore të shfrytëzimit të materialeve ndërtimore si shkëmbinjë të fortë, rërë dhe zhavor etj.

Një numër i tyre për shkaqe të ndryshme kanë përfunduar shfrytëzimin e këtyre materialeve duke lënë prapa degradim të natyrës dhe ambientit në hapësirat e veprimit të tyre. Deri më tani në këto lokacione<sup>21</sup> nuk kemi pas rast të rehabilitimit dhe rikultivimit të natyrës së shkatërruar. Ky fakt ka shtyrë institucionet vendore që të marrin hapa të nevojshëm që në një formë apo tjetër t'i obligojnë përfituesit legjitim të këtyre minerare t'i kthejnë në gjendjen e mëparshme, duke shmangur edhe mundësitë e rrezikimit të komunitetit që jeton në atë lokacion. Infrastruktura ligjore obligon shfrytëzuesit e këtyre pasurive natyrore që pas përfundimit të aktivitetit eksploatues të ndërmarrin masat e rikultivimit.

20 Shih në shtojcë, Harta nr 11. Zonat me rrokullisje.

21 Shih në shtojcë, Harta nr 12. Lokacionet e minierave sipërfaqësore.

Profili i rrezikut	
<b>Rreziku:</b> Minierat e braktisura sipërfaqësore dhe nëntokësore.	
<b>Madhësia e mundshme (Përqindja e komunitetit që mund të goditet):</b> KRITIKE.	
<b>Frekuenca e ndodhjes:</b> E MUNDSHME	<b>Modeli sezonal:</b> Gjatë gjithë vitit.
<b>Zonat që mund të goditen më së shumti:</b> Qytetet dhe fshatrat ku ndodhen minierat.	
<b>Kohëzgjatja e mundshme:</b> Deri në rehabilitimin e tyre.	
<b>Shpejtësia e mundshme e mësymjes (E mundshme e kohës së paralajmërimit):</b>	
▪ Paralajmërim minimal (apo fare).	▪ Paralajmërim 12 deri 24 orë.
▪ Paralajmërim 6 deri 12 orë.	▪ Paralajmërim më shumë se 24 orë.
<b>Sistemet ekzistuese të paralajmërimit:</b> Numri i integruar 112.	
<b>A ekziston analiza e dobësive/cenueshmërisë?</b>	
Po	<input checked="" type="checkbox"/>
Jo	<input type="checkbox"/>

### Cënueshmëria nga goditjet në faktorët kyç të komunitetit.

Profili	Pasojat e mundshme	Shkalla e goditjes
Banorët	Vdekje, lëndime që rezultojnë në paaftësi të përhershme.	E ashpër
Pasuria	Humbje e pasurisë (mjete dhe pajisje).	E ashpër
Infrastruktura vitale	Shkatërrim/dëmtim i rrejtit: rrugor, elektrik, ujësjellësit, kanalizimit, etj.	E ashpër
Objektet e rëndësishme të veçantë		
Shërbimet emergjente	Dëmtime të mjeteve dhe pajisjeve të shërbimeve emergjente reaguese.	E mesme
Ambienti	Degradim i mjedisit.	E ashpër
Trashëgimia kulturore		
Shërbimet shtetërore		
Dëmet ekonomike	Shkatërrim/dëmtim i mjeteve dhe pajisjeve (publike dhe private).	E ashpër

#### Skenari 1.

Pas përfundimit të shfrytëzimit të xehes nëpër miniera sipërfaqësore dhe nëntokësore, nuk janë ndërmarrë masat e sanimit. Si pasojë e gjendjes së këtyre objekteve minerare shpesh kanë ndodhur dëme në njerëz dhe pasuri të ndryshme të komunitetit që jeton në këto ambiente.

#### Skenari 2.

Punimet minerare horizontale dhe vertikale me dimensione të mëdha dhe thellësi të theksuar që ndodhen ende të hapura, pa mbrojtje kanë ndikuar që të bien në to njerëzit. Në Dubovc në thellësi me dhjetëra metra ka rënë një i ri i cili pas një qëndrimit tre ditë brenda, ka pësuar lëndime të rënda trupore dhe pasoja mentale, i cili brenda një kohe të shkurtër edhe ka vdekur.

Po e njëjta minierë është rehabilituar me një kosto jo të madhe duke lënë mundësinë e rihapjes në çfarëdo kohe.

Karrierat sipërfaqësore nuk janë rrethuar, andaj gropa e madhe e krijuar gjatë shfrytëzimit nuk është mbuluar dhe ramja e kalimtareve është shumë e mundshme.

**Konkludim:**

Me që nga ana e MZHE ( Ministria e Zhvillimit Ekonomik ) është kryer studimi i evidentimit të këtyre objekteve, e cila edhe ka bërë rehabilitimin dhe rikultivimin e njëres nga këto miniera (Dubovc), rekomandoj që një praktikë e tillë të vazhdojë edhe për pjesët tjera të Kosovës.

**6.6. Rreziqet tjera natyrore**

Për nga natyra, fatkeqësitë natyrore si fenomene meteorologjike janë të ndikuara nga efektet sizmike dhe vështirë të përcaktohet lokacioni i goditjes. Ato mund të prekin një ose disa pjesë(rajone) të vendit madje edhe tërësinë e tij.

**Shtrëngatat**

Shtrëngatat janë fenomene natyrore që manifestohen me erëra të furishme dhe të fuqishme, me reshje të shumta atmosferike që fillojnë befas dhe nuk zgjasin shumë. Kryesisht paraqiten në stinët e pranverës dhe vjeshtës si rezultat i ndryshimeve të shumta atmosferike(shtypja atmosferike, temperatura, lagështia dhe dendësia e ajrit).

**Stuhitë**

Stuhitë janë fenomene natyrore që manifestohen me erëra të fuqishme të cilat kanë shtrirje prej disa qindra metra deri në dhjetra kilometra dhe kohëzgjatje prej disa minutave e deri në disa orë. Paraqiten si rezultat i jostabilitetit të kushteve atmosferike.

Viteve të fundit ky fenomen është duke e përfshirë Kosovën shpesh, e sidomos në periudhat qershor-shtator e cila korrespondon me ngritjen e temperaturave.

Vendet më të goditura janë qyteti i Shtimes dhe Istogut.

**Efektet e këtyre fatkeqësive natyrore janë të shumta, siç janë:**

- Dëmtim i shtëpive dhe pullazeve,
- Dëmtimi dhe shkatërrimi i pjesshëm i rrjetit elektrik dhe atij telefonik,
- Zhvendosja/hedhja e objekteve të ndryshme (kontejnerë, serra, shkullja e drunjëve, etj),
- Çrregullimi i transportit (rrugor, hekurudhor dhe ajror),
- Vërshime dhe ndotje e ujërave sipërfaqësore si dhe nëntokësore.

**Pasojat**

- Vdekje dhe lëndime nga goditjet,(objektet e ndryshme, kabllot dhe shtyllat elektrike, rënia e objekteve nga lartësitë),
- Aksidente të komunikacionit,
- Zvogëlim dhe ndërprerje e aktiviteteve socio-ekonomike,
- Përmbytje,
- Dëmtim dhe shkatërrimi i kulturave bujqësore, drunjëve dekorativ, etj.

**Ngricat dhe shirat me ngrica**

Ngrica është fenomen natyror që manifestohet nga rrymimet e ajrit me temperatura të ulëta, e cila paraqitet si shtresë e hollë e akullit (që mbulon tokën), si pasojë e ngrirjes së ujit, lagështisë dhe mjegullës.

**Llojet e ngricave:**

- **Ngricat nga reshjet:** Parashikohen më lehtë, ato shfaqen kur bie shi dhe temperaturat ulen nën minus 0 C ose temperaturat zbresin shpejtë, deri sa rrugët janë ende të lagura. Këto ngrica janë fenomene të shpeshta që mund të shfaqen në tërë vendin tonë.
- **Ngricat e kondensimit:** Në këtë rastë fenomeni është më kompleks dhe shumë më i limituar (në zonat e hijeve, nën drunj...). Dijmë se ajri nuk mund të mbaj më shumë përveçse një sasi të caktuar të avullit të ujit. Prandaj sa më e ultë të jetë temperatura, ajri mund të mbajë më pak avull.
- **Shirat me ngrica** shfaqen deri sa reshjet arrijnë në tokë në formë të pikave të ujit dhe ngrijnë kur bien në kontakt me sipërfaqen e ngrirë. Parashikimi i shirave të tilla me ngrica është jashtëzakonisht i vështirë.
- **Pasojat** e ngricave dhe të shirave me ngrica janë kryesisht çrregullime ose aksidente të komunikacionit.

**Thatësitrat**

Ky fenomen ndodh kur reshjet e dimrit janë jashtëzakonisht të dobëta, kur burimet nëntokësore të ujit janë të pakta, rezervarët sipërfaqësore (liqejtë) janë po ashtu nën nivelin e tyre minimal të mbushjes. Furnizimi i popullatës me ujë bëhet nga rezervat e liqejve akumulues të cilët varen nga reshjet atmosferike. Kosova është burim i ujërave por në një masë mjaft të kufizuar bënë akumulimin (përbush nevojat e veta me rezerva të ujit). Gjatë zezonës verore temperaturat e larta mund të ndodh që të çrregullojë në masë të madhe komoditetin e jetës normale në Kosovë, e në veçanti vendet urbane.

Ky çrregullim ndikon ndjeshëm kryesisht në shëndetin e personave të moshuar, fëmijëve, të sëmurëve kronik, nënave shtatzëna dhe shtresave tjera të prekura. Si pasojë e thatësirave shkaktohet: ndotja e ajrit, rënia e cilësisë së ujit të pijshëm, shfaqja e epidemive, si dhe mund të ndodh dëmtimi i ekosistemit.

**Valët e të ftohtit dhe bora:**

Vala e të ftohtit është një fenomen natyror i cili manifestohet me temperatura të ulëta që arrijnë vlerën nga -10 °C e më poshtë ose që kalojnë shumë vrullshëm vlerat negative më të ulta se -5 °C. Ky fenomen është sezonal i cili manifestohet në muajt e zezonës dimërore (dhjetor-shkurt) dhe përfshinë territorin e Republikës së Kosovës.

**Bora** si njëra nga të reshurat atmosferike përbush rezervat nëntokësore dhe mbitokësore të ujit, por edhe shkakton vështirësi dhe dëme. Të reshurat e mëdha dhe shtresimi i borës, zvogëlon dukshmërinë, vështirëson lëvizjen e automjeteve dhe qytetarëve, rëndon rrjetet e telekomunikacionit, transportit, të distribuimit të rrymës, krijon orteqe dhe shpesh ndodh që si pasojë e shkrirjes së shpejtë në sezonën pranverore (mars-prill) shkakton vështime ose përmbajtje.

**Konkludim:**

Të gjitha këto fenomene natyrore dhe të reshura që shfaqen në Kosovë paraqesin rreziqe të cilat mund të rezultojnë me viktima dhe dëme të mëdha materiale.

Është nevojë dhe domosdoshmëri që institucionet gjegjëse shtetërore të ndajnë një pjesë të konsiderueshme të mjeteve në ndërmarrjen e masave parandaluese dhe fuqizimin e kapaciteteve reaguese, të cilat do të mundësonin zvogëlimin e rreziqeve dhe sanimin e pasojave.

## VII. RREZIQET NGA FATKEQËSITË TJERA

### 7.1. Deponitë nga industria minerare

Kosova dhe hapësira përreth saj është ballafaquar me rreziqe të mëdha dhe të vazhdueshme të ndotjes së ambientit nga zhvillimi ekspansiv i industrisë. Nga ana tjetër, ambientalistët nga dita në ditë, me konventa ndërkombëtare dhe standarde rigoroze për ambientin, detyrojnë industrinë në përgjithësi, ndërsa minierat në veçanti, t'i minimizojnë mbetjet dhe rrjedhat e materieve të rrezikshme, me qëllim të mbrojtjes së shtuar dhe efektive për të arritur një ambient të pastër dhe të shëndetshëm për të gjithë. Kosova ka trashëguar një numër të madh problemesh mjedisore, të akumuluar me dekada si pasojë e shfrytëzimit të pakontrolluar të resurseve natyrore dhe minerare, prodhimit industrial, shoqëruar me një shkallë të lartë të ndotjes, gjë që paraqet rrezik në vijimësi për komunitetin përreth, si dhe Kosovën në përgjithësi. Veprimtaria e eksploatimit të resurseve minerale nëntokësore dhe sipërfaqësore, hapësirën e gjerë e lë të kontaminuar me ujëra acidike dhe me metale të rënda, posaçërisht me Pb, Zn, Cd, As, Hg etj.

Pas një hulumtimi në terren në tërë territorin e Kosovës janë evidentuar një numër i konsiderueshëm i deponive të ndryshme<sup>22</sup>, si mbetje nga industria minerare që sot paraqesin rrezik permanent për Kosovën. Lokacionet e këtyre deponive gjenden në komunat: Mitrovicë, Zveçan, Graçanic, Artanë, Obiliq, Lipjan, Gjakovë, Stantërg dhe Leposaviq.

Të dhënat në vijim paraqesin pasqyrën e vendndodhjes së deponive.

Deponitë në veri të Kosovës:

- Zveçan,
- Deponia në afërsi të lumit Ibër – afër Shkritores së Pb në Zveçan,
- Deponia e mbeturinave dhe mbetjeve nga industria në Zveçan, Gornje Pole,
- Deponia e mbeturinave dhe mbetjeve nga industria në Zveçan, depozit hiri,
- Impianti nga mbetjet e shkrirjes në Zveçan.

**Tabela 17. Koordinatat e të gjitha deponive minerare në Kosovë.**

Nr	Emri	Lokacioni-Vendi	Sip. Ha	Y	X	Z
1	Deponi minerare	Kishnicë	10.23	7518598.4	4718421	691
2	Deponi minerare	Badoc	2.85	7517935.1	4719737.3	640
3	Deponi minerare	Artanë	2.38	7535205.7	4721688.5	652
4	Deponi minerare	Artanë	3.94	7535852.7	4722397.2	639
7	Deponi minerare	Kelmend Zveqan	23.78	7489951.5	4752104.5	x
8	Deponi minerare	Zveqan	62.28	7488590.6	4751966.7	x
9	Depo me lëndë Radioaktive	Tuneli i Parë	0.03	7491808.3	4753530.8	x
10	Meterie Radioaktive	Laboratori PIM	0.04	7490512.5	4749434.8	x
18	Deponi minerare	Magure, Lipjan	15.13	7500349.7	4710986.7	602
20	Deponia e hirit	KEK Obiliq	181.97	7508167.4	4724828.8	x
21	Deponi e hirit	Obiliq KEK	192.94	7504208.9	4728383.7	x
23	Deponi e mineraleve të feronikelit	Çikatovë, Drenas	71.37	7492822	4722203.6	x
24	Deponi minerare	Devë, Gjakovë	5.23	7447479.2	4691442.8	x
27	Deponi minerare	Leposaviq	20.31	7482544.3	4774120.7	x
28	Parku Industrial i Trepçës	Mitrovicë	115.1	7490238.1	4749306.2	x

Profili i rrezikut	
<b>Rreziku:</b> Deponitë minerare dhe deponitë nga Industria minerare.	
<b>Madhësia e mundshme (Përqindja e komunitetit që mund të goditet):</b> Kritike.	
<b>Frekuenca e ndodhjes:</b> ▪ E mundshme.	<b>Modeli sezonal:</b> Gjatë gjithë vitit.
Zonat që mund të goditen më së shumti: Qytetet dhe vendbanimet ku janë të vendosura deponitë.	
<b>Kohëzgjatja e mundshme:</b> Deri në rehabilitimin e tyre.	
<b>Shpejtësia e mundshme e mësymjes (E mundshme e kohës së paralajmërimit):</b> ▪ Paralajmërim minimal (apo fare). ▪ Paralajmërim 6 deri 12 orë.	
▪ Paralajmërim 12 deri 24 orë. ▪ Paralajmërim më shumë se 24 orë.	
<b>Sistemet ekzistuese të paralajmërimit:</b> Numri i Integruar 112.	
<b>A ekziston analiza e dobësive/cenueshmërisë?</b> Po <input checked="" type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/>	

**Cënueshmëria nga goditjet në faktorët kyç të komunitetit**

Profili	Pasojat e mundshme	Shkalla e goditjes
Banorët	Vdekje dhe lëndime, si dhe pasoja tjera shëndetësore.	E ashpër
Pasuria	Shkatërrim dhe dëmtim i tokave bujqësore.	E ashpër
Infrastruktura vitale	Shkatërrim dhe dëmtim i infrastrukturës rrugore, rrjetit elektrik dhe telekomunikimit, objekteve shkollore, QMF, etj.	E ashpër
Objektet e rëndësisë së veçantë		
Shërbimet emergjente	Dëmtime të pajisjeve dhe mjeteve të shërbimeve emergjente reaguese.	E mesme
Ambienti	Degradim i mjedisit.	E ashpër
Trashëgimi kulturor	Dëmtim i objekteve të trashëgimisë kulturore.	E mesme
Shërbimet shtetërore	Dëmtim i shërbimeve shtetërore dhe shërbimeve për qytetarë.	E mesme
Dëmet ekonomike	Shkatërrim dhe dëmtim i madh i florës dhe faunës.	E ashpër

**Skenari 1.**

Hapësira e zënë me mbetje nga minierat dhe industria minerare shumë e madhe deri në qindra hektarë. Përbërja mineralogjike dhe kimike ndikojnë direkt në florën dhe faunën për rreth, shëndetin e banorëve që jetojnë brenda rrezes së ndikimit të deponisë. Shkarkimet në ujërat e lumenjëve më të afërt. Aciditeti i krijuar si rezultat i mos menaxhimit të duhur të materialit të deponuar. Në periudhat me thatësira dhe erëra të forta materiet e ngurta barten në distanca më të largëta duke ndotur ambient më të gjerë.

**Skenari 2.**

Ndërtimi gjeologjik i zonës ku eksploatohet, përbërja mineralogjike e xehes së eksploatuar, në kontakt me ujërat nëntokësor dhe atmosferik krijon aciditet të lartë ku gjatë transportit deri në deponi shkatërrojnë teknologjinë, florën dhe faunën në dhe për rreth zonës ku është vendosur mbetja. Shkatërrim total i gjitha gjallesave në ujërat që janë nën ndikimin e mbetjeve të deponive. PSh: Deponitë në Marec kanë shkatërruar në tërësi florën dhe faunën me disa dhjetëra km në lumin Marec.

**Rekomandime:**

1. Të bëhet studimi gjeologo-ekonomik i të gjitha mbetjeve minerare.
2. Të intervenohet urgjent në rehabilitimin e tyre.
3. Të shikohet mundësia e ripasurimit me teknologji bashkëkohore.
4. Të bëhet trajtimi i ujërave atmosferike dhe atyre që i përshkojnë deponitë me qëllim të prurjes në kufij normal e pH.



## 7.2. Zonat e spostimeve dhe ngritjeve (Gjeo-rreziqet në minierat aktive dhe ato të braktisura)

Shfrytëzimi i mineraleve në Kosovë është një traditë shumëvjeçare. Për shumë vite ka zënë vendin më të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik. Vendburimet në territorin e Kosovës janë të shpërndara përgjatë gjithë territorit të Kosovës. Vendburimet më të rëndësishme të plumbit dhe zinkut ndodhen në rajonin metalogjenik të Kopaonikut (Albaniku), respektivisht në fushën xeherore të Trepçës, e cila shtrihet në pjesën verilindore të Kosovës, duke filluar nga Kopaoniku (Albaniku) deri në Gllamë. Paraqitjet dhe vendburimet e hekur - nikelit në Kosovë, të cilat shtrihen nga Ivaja afër Kaçanikut në jug dhe vazhdojnë gjerë në Vërbovc në veri. Vendburimet më të rëndësishme të Fe-Ni ku kjo xehe paraqitet janë: masivi i Goleshit, Dobroshevcit si dhe JL e Kopaonikut. Regjioni boksit-bartës bën pjesë në masivin e shkëmbinjve ultrabazik të Rahovecit. Vendburimi dhe paraqitjet e boksitit shtrihen në Malin e Gremnikut, 5 deri në 10 km në juglindje të Klinës.

Vendburimet e kromit ndodhen në këto lokalitete në Kosovë: në masivin ultrabazik të Gjakovës, Rahovecit, Lubotenit, Brezovicës, Goleshit, Dobroshevcit etj. Kjo pasqyrë e shkurtër historike e punimeve hulumtuese dhe shfrytëzuese nëpër periudha të gjata, ka shkaktuar një mori ndryshimesh në reliefin ku ato janë zhvilluar. Ato ende janë evidente dhe paraqesin rrezik permanent për komunitetin përreth tyre<sup>23</sup>. Nga ana tjetër disa prej tyre për shkak të shuarjes së aktivitetit minerar janë shkatërruar, shembur, kurse punimet minerare vertikale janë nëpër zonat e lartcekura shpeshherë janë edhe shkaktarë të dëmeve si në njerëz ashtu edhe në pasuritë e tyre.

Nga aktiviteti i shfrytëzimit të xehes me metoda të ndryshme duke filluar prej atyre më primitive e deri tek ato me teknologji më të përsosura, zona të caktuara në tërë territorin e Kosovës mbajnë në vete edhe spostime të cilat për shkak të vegjetacionit të zhvilluar nuk vërehen. Duke marrë parasysh krejt këto fakte ekspertët e lëmive të ndryshme minerare, përpos materialeve ekzistuese, kanë bërë edhe vizita pothuajse në të gjitha këto zona, duke bërë një përshkrim të gjendjes së tyre si në vijim:

- Vendndodhja,
- Përshkrimi i shkurtër i ndërtimit gjeologjik të zonës së ngushtë,
- Punimet minerare,
- Metodatat e shfrytëzimit.

Prerjet vertikale, ku pastaj kemi një pasqyrë të qartë për shtrirjen e tyre.

### Zona e Shalës së Bajgorës-Punimet minerare në Gumnishtë

Zona e interesit "GUMNISHTË" shtrihet në territorin e komunave Mitrovicë e Vushtrri në lartësitë mbidetare në mes të 600- 1300m dhe përfshinë një sipërfaqe prej 29.172 km<sup>2</sup>. Puset vertikale dhe horizontale në këtë hapësirë janë dëshmia më e mirë për shfrytëzimin e xehes në këto hapësira, të cilat njëkohësisht paraqesin një rrezik shumë të madh për banorët që jetojnë brenda zonës në fjalë.



*Punimet minerare- vertikale shumë të vjetra dhe të pa mbuluara në Gumnishtë*



*Punimet minerare në Picel-Bajgorë*

### **Punimet minerare në Karaçë, Vushtrri**

Zona e hulumtuar ndodhet afër fshatit Karaçë, i cili ndodhet në veri të Vushtrrisë në një distancë prej 6 km dhe JL me Stan Tergun në distancë prej 10 km.

Zona Karaçë, është e lokalizuar në gëlqeroret e kristalizuara, të cilat lajmërohen si një horizont më i madh në rreshpet e serisë së Veleshit. Punimet minerare në këtë hapësirë të banuar, shpeshherë kanë paraqitur rrezik si për jetën ashtu edhe për bagëtinë e tyre (sipas tregimeve nga ana e banorëve vendor-Karaçë).

- Minierat në fushën xeherore të Artanës,
- Fusha xeherore Badovc-Hajvali-Kishnicë,
- Mihja sipërfaqësore e Kishnicës,
- Zona e malit Zhegovc/ Gjilan,
- Punimet minerare në Visoqë,
- Miniera nëntokësore e qymyrit në Babush të Muhaxherëve.

### **7.3. Shpërthimet e pendave**

Këto rreziqe mund të jenë kërcënim, sipas llojit, madhësisë, koncentrimit të materieve të rrezikshme, si dhe largësisë së objekteve qoftë ku prodhohen, barten apo janë të deponuara materiet e rrezikshme. Duke pas parasysh se Republika e Kosovës ka një koncentrim të madh të pikave të karburanteve, zhvillimin e hovshëm ekonomik që do të vie si shtet i ri, si dhe dendësinë e madhe të banorëve për km<sup>2</sup>, është e mundshme një katastrofë.

**Penda** është një konstruksion në të shumtën e rasteve artificial, që marrë në përgjithësi e transformon një luginë në një rezervuar të ujit. Pendat shërbejnë kryesisht për rregullimin e rrjedhave të ujit, furnizimin me ujë të qyteteve, ujitjen e kulturave bujqësore dhe prodhimin e energjisë elektrike. Rreziku i shpërthimit të vrullshëm dhe të paparaparë është sot jashtëzakonisht i ultë. Situata e shpërthimit do të mund të vijë nga evoluimi pak apo shumë i shpejtë i dëmtimit të konstruksionit. Në rast të shpërthimit të pjesshëm ose të tërësishtëm të pendes do të bëhej një valë e përmbytjeve shumë shkatërrues në këtë zonë dhe në veçanti në zonën e “një çerek ore” ( zonë në të cilën vala do të bënte me pak se një çerek ore për te arritur vala goditëse e përmbytjes).

## Historiku

Dimri i vitit 2004-2005. Ngrirja e sipërfaqes së Liqenit të Batllavës, ngrirje e cila i ka bërë presion kullës së liqenit për mos pranimin e ujit, akulli i ka bërë presion kullës dhe në këtë mënyrë është rrezikuar ndërprerja e plotë e furnizimit me ujë të pijshëm për qytetin e Prishtinës.

Vendet ku mund të ndodh ky lloj rreziku janë: Badovci me 2,57 km<sup>2</sup>, Batllava me 3,27 km<sup>2</sup>, Ujmani me 9,10 km<sup>2</sup>, Radoniqi me 5,96 km<sup>2</sup> dhe Përlepnica me 1.8 km<sup>2</sup>.

## Shpërthimi i pendave /Faktorët përkeqësues

Ngritja e hovshme e nivelit të ujit nga të reshurat.

Tërmetet e fuqishme.

Mirëmbajtja jo adekuate dhe faktori njeri.

## Fluksi i rrezikut

Dallojmë 3 flukse të rrezikut kryesor:

- Shpërthimin i plotë ose i pjesshëm i trupit të pendës,
- Dalje nga shtrati për arsye të akumulimit të një sasive të madhe të ujit,
- Zbrazje e qëllimshme e ujit në rast të mbingarkesës.

## Pasojat

Në rast të shpërthimit të pendës pasojat mund të jenë katastrofike për të tri kategoritë: njerëzit, të mirat materiale dhe mjedisin.

Profili i rrezikut	
<b>Rreziku:</b> Shpërthim i pendës.	
<b>Madhësia e mundshme (Përqindja e komunitetit që mund të goditet):</b> Kritike.	
<b>Frekuenca e ndodhjes:</b> E mundshme.	<b>Modeli sezonal:</b> Gjatë tërë vitit.
<b>Zonat që mund të goditen më së shumti:</b> Prishtina, Mitrovica, Podujeva, Gjakova dhe Gjilani.	
<b>Kohëzgjatja e Mundshme:</b> Orë/Ditë.	
<b>Shpejtësia e mundshme e mësymjes (shuma e mundshme e kohës së paralajmërimit):</b>	
Pa paralajmërim ose paralajmërim minimal.	
<b>Sistemet ekzistuese të paralajmërimit:</b> Nuk ka.	
<b>A ekziston analiza e dobësive/cenueshmërisë?</b>	
Po <input type="checkbox"/>	
Jo <input checked="" type="checkbox"/>	

**Cënueshmëria nga goditjet në faktorët kyç të komunitetit**

Profili	Pasojat e mundshme	Shkalla e goditjes
Banorët	Vdekje/ lëndime të rënda, përmytje masive.	E ashpër
Pasuria	Shkatërrim /dëmtim i pasurisë private dhe publike.	E ashpër
Infrastruktura vitale	Shkatërrim/dëmtim irrjetit energjetik dhe telekomunikimit ujësjellësit dhe kanalizimit, infrastruktura rrugore , etj.	E ashpër
Objektet e rëndësishme	Shkatërrim/ dëmtim i objekteve të: shkollave, spitaleve, depove ushqimore, trafostacioneve, etj.	E ashpër
Dëmet ekonomike	Shkatërrim / dëmtim i përgjithshëm i zonës së goditur.	E ashpër
Ambienti	Shkatërrim / dëmtim i mjedisit.	E ashpër
Trashëgimia kulturore	Shkatërrim/ dëmtim i trashëgimisë kulturore, në objekte dhe arkeologji.	E ashpër
Shërbimet shtetërore	Dëmtim /paralizim i infrastrukturës shtetërore.	E ashpër
Shërbimet emergjente	Shkatërrim/ dëmtim i pajisjeve të shërbimeve reaguese emergjente.	E ashpër

**Skenarët e mundshëm**

Është e mundur të simulohet shpërthimi i një pende dhe të bëhet modeli i valëve goditëse me qëllim të përcaktimit të nivelit të lumit në grykën e pendës. Kjo mundëson lokalizimin e vendbanimeve që do të ishin të përmytura, lajmërimin dhe alarmimin.

Një skenar i tillë duhet të ushtrohet, të studiohet dhe të testohet me qëllim të parashikimit të pasojave për:

- Popullatën,
- Objektet e banimit,
- Objektet publike ( administrata, shkollat, shërbimet reaguese emergjente, etj),
- Rrjetin e transportit dhe i furnizimeve vitale,
- Ekonominë,
- Ambientin,
- Trashëgiminë kulturore.

## VIII. RREZIQET NË INFRASTRUKTURËN KRITIKE

Kjo infrastrukturë ngërthen në vete kapacitetet energjetike, përpunimin e naftës dhe derivateve të saj, transportin dhe shpërndarjen, komunikimin dhe teknologjinë informative (telekomunikimin, mediet elektronike, softuerët, harduerët dhe rrjetin, sidomos internetin), financat, (bankat, sigurimet dhe investimet), objektet shëndetësore (spitalet, entet për transfuzionin e gjakut, laboratorët dhe farmacitë, hulumtimin dhe zhvillimin, shërbimet emergjente). Ushqimin ( prodhimin, shpërndarjen dhe industrinë ushqimore), ujin: (pendët, basenet, përpunimin dhe rrjetin). Portet ajrore, transportin rrugor dhe hekurudhor, prodhimin, deponimin dhe transportin e materieve të rrezikshme, (kimike, biologjike, radiologjike dhe nukleare) qeverisjen administrata, shërbimet kritike, objektet, rrjetet informative, lokacionet, dhe resurset kombëtare qenësore, si dhe objektet).

Infrastruktura kritike është pronë e shtetit, njësive lokale dhe regjionale, personave juridik të cilët janë themelues të njësive lokale apo regjionale të qeverisjes, si dhe pronë private.

Mbrojtja e Infrastrukturës Kritike që nënkupton emrin e përbashkët për rrjetin dhe sistemet vendimtare për funksionimin e jetës së popullsisë, në raste të dëmtimit apo shkatërrimit, mund të ketë pasoja në lëkundje dhe kriza, mund të ketë pasoja për tërë Republikën e Kosovës ose për lokalitetet apo regjionet e caktuara. Në mes kësaj Infrastrukture të larmishme ekziston një lidhje dhe ndërvarësi e ndërsjellë, kështu që problemet në një segment të caktuar në një pjesë të kësaj infrastrukture ose në rrjet, shumë lehtë mund të përhapen në sistemet dhe rrjetet tjera duke sjellë deri te ndërprerja e veprimtarive ose probleme, kështu në mënyrë të kombinuar do të shkaktojnë humbjen e jetërave dhe pasoja afatgjata në sistemin e qeverisjes, ekonomi, shëndetin publik, sigurinë Kombëtare, besimin e publikut, si dhe pasoja tjera për shoqërinë në tërësi ose të pjeshme.

Për këtë arsye është i domosdoshëm vlerësimi i rrezikut të Infrastrukturës kritike në të gjitha fushat, nga personat juridik, qeveritë lokale, deri në nivel kombëtar, për të vlerësuar lëndueshmërinë e Republikës së Kosovës, për arsye të varshmërisë së infrastrukturës kritike ballkanike dhe Evropiane, si dhe vendeve tjera.

Në këtë rast vlerësohet shkalla e rrezikshmërisë dhe e lëndueshmërisë të infrastrukturës së veçantë, nga të gjitha rreziqet e mundshme, si dhe rreziqet për sigurimin e shërbimeve, që ofron kjo infrastrukturë.

Rrjetet dhe sistemet të cilat përbëjnë infrastrukturën kritike, janë të lidhura me vendin ku janë të vendosura, kështu që i nënshtrohen rreziqeve të njejt që kërcënojnë atë vend, gjegjësisht lokalitetin e qytetit, komunës, ose regjionit ose sipërfaqen e Republikës së Kosovës në përgjithësi.

Për këtë arsye, gjatë vlerësimit të rrezikut nga ndonjë kërcënim në një vend të caktuar, duhet të kihet parasysh rrezikshmëria për infrastrukturën kritike, në mënyrë që të vlerësohet mundësia dhe aftësia e sigurimit të gjërave të nevojshme dhe shërbimet për sanimin e pasojave, mbrojtjen dhe shpëtimin e banorëve, si dhe normalizimin dhe funksionimin e vendbanimit të goditur.

Ndodh që këto rreziqe për infrastrukturën kritike nga një herë janë të pa vërejtshme, sepse janë ta varura nga sistemet tjera ndërmjetësuese dhe të padukshme, sidoqoftë në procesin e vlerësimit, duhet vërtetuar dhe paraparë masat për zvogëlimin e tyre deri në rreziqet e pranuar.

Për arsye të ndërlikueshmërisë së vlerësimit të rreziqeve për Infrastrukturën kritike, duhet të obligohen institucionet që secila veç e veç për llojin e infrastrukturës dhe rreziqeve sipas

përgjegjësi të tyre emergjente, të bëjë vlerësimin e rreziqeve në këtë infrastrukturë. Në këtë vlerësim duhet planifikuar aktivitetet e preventivës, evitimin ose zvogëlimin e rreziqeve të cilat mund të cenojnë infrastrukturën kritike ose ndërprejnë veprimtarinë dhe shërbimet e kësaj infrastrukture.

## 8.1 Teknologjia Informative

Pas luftës së fundit në Kosovë, më shumë është investuar në telefoninë mobile, kurse në atë fikse është investuar shumë pak. Në telefoninë fikse janë riparuar vetëm dëmet e shkaktuara nga lufta në ndërtesën e PTT-së në Prishtinë. Sot ekzistojnë rreth 120 000 para pagese të telefonisë fikse. Kosova zë vendin e parafundit në Ballkan, për sa i përket numrit të para pagesve të telefonisë fikse në 100 banorë. Në pjesët rurale të Kosovës, me përjashtim të një numri të vogël të vendbanimeve rurale, nuk ka rrjet të telefonisë fikse. Për dallim nga kjo, gjendja është më e mirë në telefoninë mobile. Në Ballkan vetëm Kroacia ka më shumë shfrytëzues të telefonisë mobile në 100 banorë. Zhvillimi i rrjetit të internetit është ende në fazën fillestare edhe pse me përparim të dukshëm.

### ➤ Telekomunikimi

Sistemi i komunikues i teknologjisë informative është i shtrirë në të gjitha institucionet qendrore qeveritare, të gjitha agjencitë dhe të gjitha institucionet lokale. Nga ky sistem përfitojnë të gjitha institucionet qeveritare qendrore, lokale, bizneset dhe qytetarët e Republikës së Kosovës.

Në infrastrukturën e rrjetit qeveritar janë të kyçura më shumë se 350 institucione të ndryshme, Infrastruktura teknologjike e rrjetit qeveritar përbëhet nga rrjeti mikrovalor dhe rrjeti optik. Të gjitha institucionet qeveritare janë të kyçura në rrjetin qeveritar qoftë përmes rrjetit mikrovalor apo qoftë përmes rrjetit optik, në disa raste një institucion posedon dy lidhje në të njëjtën kohë, lidhja përmes fijeve optike shërben si lidhje primare ndërsa lidhja mikrovalore shërben si lidhje sekondare. Sistemi i rrjetit qeveritar optik dhe mikrovalor posedon mbi 1000 pajisje aktive siç janë Router-a, Switch-a dhe Antena të ndryshme të shpërndara në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

Infrastruktura e rrjetit qeveritar mundëson funksionimin e shumë aplikacioneve të ndryshme të cilat i shërbejnë Institucioneve Qendrore, Institucioneve Lokale dhe Qytetarëve të Republikës së Kosovës. Disa nga aplikacionet (shërbimet) më të rëndësishme të cilat funksionojnë përmes infrastrukturës së rrjetit qeveritar janë: Sistemi i Gjendjes Civile, Sistemi i Pasaportave, Sistemi i Letërnjoftimeve, Sistemi i Patentë Shoferëve, Sistemi i Tatimit në Pronë, Sistemi i pagesave Free Balanc, Sistemi i Intranetit dhe arkës në të gjitha Komunat e Kosovës, Sistemi i e-mailit qeveritar, Sistemi telefonik VoIP, Interneti, Sistemi i Regjistrimit të Bizneseve, Sistemi i Kadastrit, Sistemi e-pasuria, Sistemi i Arkivës Elektronike, Sistemi i Vijueshmërisë në Punë, Sistemi Informativ i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore etj.

### ➤ Rrjeti Mikrovalor

Rrjeti qeveritar mikrovalor është i shtrirë në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës përmes së cilit janë të kyçura të gjitha Komunat e Kosovës. Ky rrjet është i ndërtuar në bazë të standardeve duke përdorur pikat strategjike të larta për të mbuluar tërë territorin e Republikës së Kosovës. Me qëllim të mbulimit të tërë territorit të Republikës së Kosovës,



rrjeti qeveritar mikrovalor ka në shfrytëzim 17 pika transmetuese strategjike siç janë: Berishë, Zym, Cernushë, Zatriq, Qycavicë, Cvilen, Maja e Gjelbër, Bratilloç, Gajre, Bukiq, Gërmi etj. Në këto pika strategjike janë në shfrytëzim edhe shumë pyrgje, (kulla) së bashku me infrastrukturën përcjellëse të cilat mundësojnë funksionimin e rrjetit mikrovalor. Rrjeti qeveritar mikrovalor përbëhet në më shumë se 130 linçe mikrovalore (260 antena) të cilat shërbejnë për kycjen e institucioneve të ndryshme qendrore dhe lokale në rrjetin qeveritar<sup>24</sup>. Administrimi dhe mirëmbajtja e rrjetit qeveritar mikrovalor bëhet nga Agjencia për Shoqërinë e Informacionit respektivisht Drejtoria e Rrjetave dhe Telekomunikimeve.

### ➤ Rrjeti Optik

Rrjeti qeveritar përmes fijeve optike është i shtrirë në tërë territorin e Republikës së Kosovës dhe shërben si lidhje primare për institucionet qeveritare të cilat janë të kyçura në rrjet përmes fijeve optike. Deri më tani në rrjet qeveritar përmes fijeve optike janë të kyçura të gjitha institucionet qendrore (ministritë dhe agjencitë e ndryshme), si dhe shumica e komunave të Kosovës. Edhe rrjeti qeveritar optik administrohet dhe mirëmbahet nga Agjencia për Shoqërinë e Informacionit respektivisht Drejtoria e Rrjetave dhe Telekomunikimeve<sup>25</sup>.

### ➤ Sistemi Telefonik në Institucionet e Republikës së Kosovës

Sistemi i telefonisë fikse në institucionet e Republikës së Kosovës është i zhvilluar dhe funksional në çdo institucion qoftë të nivelit qendror apo edhe të nivelit lokal.

Funksionalizimi dhe mënyra e komunikimit përmes sistemit telefonik duke filluar nga Presidenca, Kryeministria, ministritë etj, është i mundur në formën e shërbimit të sistemit telefonik Qeveritar (centrex) shërbim i cili nuk ka implikime buxhetore. Ofrimin e ngritjes së komunikimit ndërmjet shërbyesve civil në të gjitha institucionet Qeveritare e funksionalizon Agjencia e Shoqërisë së Informacionit konkretisht Drejtorati i Rrjetave dhe Telekomunikimeve.

Sistemi telefonik analog në institucionet të cilin e kemi filluar se funksionalizuar që nga paslufta në formën e centrexit, është i shtrirë afër 60% në sistem analog përmes PTK-së.

Andaj, ASHI-ja si përgjegjëse për funksionalizimin e telefonisë fikse në të gjitha institucionet, në kuadër të ngritjes së kapaciteteve komunikuese ndërmjet shërbyesve civil, ka planifikuar implementimin e projektit të Sistemit Telefonik Qeveritarë VoIP. Sistemi telefonik digjital, ka filluar së funksionalizuar përveç institucioneve qendrore edhe në institucionet e niveleve lokale. Kur flasim për sistemin telefonik VoIP, duhet theksuar se një sistem i tillë telefonik VoIP mundësohet zhvillimi përmes rrjetit qeveritar të Internetit, pa pasur nevojë një rrjet i veçantë i telefonisë. Sistemi funksionon përmes rrjetit LAN duke përdorur IP për komunikim që mundësohet edhe trafik të mjaftueshëm dhe të lehtë ndërmjet klientëve.

Me funksionalizimin e një sistemi të tillë telefonik digjital (VoIP), është ofruar komunikimi prej zyrave në zonat malore (Zyrat e Gjendjes Civile) e deri të kontinentet më të larta (Ambasadat e RK-së) dhe të gjithë këtë me shpenzime ZERO.

Brenda mundësive buxhetore, të cilat i kemi në si ASHI- për një periudhë të shkurtër kemi arritur të funksionalizojmë me mbi 90% të institucioneve lokale, si dhe 25 % institucioneve qendrore, me shërbimin e sistemit telefonik digjital VoIP.

24 Shih në shtojcë, Harta nr 15. Rrjeti mikrovalor.

25 Shih në shtojcë, Harta nr 16. Rrjeti optic.



## Burimi i rrezikut për TI

1. Në rast të ndonjë tërmeti apo vërshimi mund të vij deri te dëmtimi i rrjetit optik por jo edhe atij mikrovalor, dihet se rrjeti mikrovalor qeveritar shtrihet përmes pikave strategjike me lartësi të konsiderueshme mbidetare, kjo varet nga shkalla dhe shtrirja e tërmetit.
2. Në rast zjarri si pasojë e temperaturave të larta apo rrymës, mund të vij deri tek djegia apo dëmtimi i pikave strategjike transmetuese të rrjetit mikrovalor siç janë: Zymi, Germia, Berisha, Maja e Gjellbër, Cernusha, Zatriqi, Qyqavica, Cvileni etj. Por jo edhe të rrjetit optik.
3. Faktori njeri, aktet terroriste.

## Qendra Nacionale e të Dhënave

Qendra Nacionale e të Dhënave, në tërësi ka një sipërfaqe prej rreth 300 m<sup>2</sup> dhe përfshin disa ambiente për infrastrukturën teknike, monitorimin dhe sigurimin e shërbimeve elektronike të Institucioneve Qeveritare të Republikës së Kosovës.

Aktualisht në këtë qendër të dhënash janë në funksionim numër i madh i shërbimeve të përqendruara qeveritare, të ofruara për institucione të administratës publike që përfshijnë të gjitha ministritë dhe institucionet e tyre të linjës. Kjo qendër mundëson që të gjitha shërbimet online qeveritare të jenë të centralizuara e të integruara.

Në kuadër të kësaj infrastrukture ka një numër të madh të serverëve fizik, serverëve virtual, storage-ve, switch-ve, firewall-ve, rack-ve, si dhe pajisje tjera të infrastrukturës fizike siç janë sistemi për ftohje, sistemi i monitorimit të kamerave, sistemi i qasjes, sistemi i shuarjes së zjarrit, sistemi i detektimit të ujit- lagështisë etj.

Disa nga fatkeqësitë që mund të ndodhin janë: zjarri, përmytjet nga uji, tërmetet, incidente të ndryshme të sigurisë, dështimi i pajisjeve të ndryshme, problemet me rrymë, zjarrvënien e qëllimshme, sabotimi, grevat dhe ndalimi i punës, trazirat civile, terrorizmi, lufta etj. Fatkeqësitë nga lista paraprahe kanë potencial të shkaktojnë dëme në ndërtesa, pajisje, dhe sisteme të IT që janë jetike për funksionimin e institucioneve të shtetit të Kosovës.

Këto efekte mund t'i dëmtojnë institucionet duke u shkakuar ndërprerje të punës me orë, ditë, ose më gjatë. Këtu përfshihen shërbime të ndryshme të e-qeverisjes, sistemi i emailit, interneti, si dhe me dhjetëra sisteme e shërbime tjera.

Nga perspektiva e rimëkëmbjes nga fatkeqësitë, kemi organizata që kanë plane për rimëkëmbje nga fatkeqësitë dhe ato që nuk kanë plane. Ne si ASHI nuk posedojmë plane të tilla të rimëkëmbjes dhe do të ishte mirë që sa më parë të hartohen ato plane.

Edhe po që se do kishim një plan të tillë, pra plan të rimëkëmbjes nga fatkeqësitë prapëseprapë mund të përballemi me vështirësi nëse godet ndonjë fatkeqësi apo dëmtim tjetër çfarëdo qoftë. Duhet përpjekje e konsiderueshme për të rikthyer funksionet kritike në kohë të caktuar për ta evituar ndonjë kaos të mundshëm.

Edhe pse një plan i plotë i rimëkëmbjes nga fatkeqësitë merr ditë, muaj apo edhe vite për të përfunduar, prapë se prapë ne si ASHI do të ishte mirë ta kishim një plan të përkohshëm të rimëkëmbjes nga fatkeqësitë, i cili mund të bëhet për një kohë më të shkurtër.

Plani i përkohshëm është një zëvendësim i dobët i një plani të plotë të rimëkëmbjes nga fatkeqësitë, por mund të sigurojë aftësi afatshkurtër për rimëkëmbje. Plani i përkohshëm nuk është një plan i plotë i rimëkëmbjes nga fatkeqësitë dhe nuk mund të ofrojë sigurinë e një plani të vërtetë.

## IX. RREZIQET NË OBJEKTET KOLEKTIVE

### 9.1. Profili i rrezikut

Kosova është e ndjeshme ndaj rreziqeve në ndërtesat kolektive sidomos tani në periudhën e pasluftës e cila mund të jetë si pasojë e ndërtimeve të shumta pa leje dhe pa kriterë.

#### Gjendja aktuale

Kosova gjendet në procesin e regjistrimit dhe legalizimit të objekteve kolektive.

#### Definimi i objekteve kolektive

Objektet kolektive janë ndërtesa (godina) për banim me familje ose ndërtesat e ngritura që për destinim kanë afarizmin, por mund të përdoren edhe si zyra.

Një ndërtesë e lartësisë së madhe është një godinë ku në pjesën e poshtme të saj (përdhesë) gjendet hapësira që mund t'i hyjë në shërbim ekipeve reaguese për luftë kundër zjarrit në lartësi, përveç saj mund të shfrytëzohet edhe platoja para objektit (nëse ekziston), për objektet e larta:

- më shumë se 50 metra për ndërtesat e banimit,
- më shumë se 28 metra për ndërtesat tjera.

Ndërtesat që pranojnë publik të grupit të parë përmbledhin të gjitha objektet e kategorisë së parë, të dytë, të tretë dhe të katërt. Ky klasifikim bëhet varësisht nga numri i paraparë për publikun që mund të pranohet në ndërtesën përkatëse.

#### *Të dhënat në vijim përcaktojnë:*

Kategorinë e parë: numër më i madh se 1500 persona.

Kategorinë e dytë: nga 701 deri në 1500 persona.

Kategorinë e tretë: nga 301 deri në 700 persona.

Kategorinë e katërt: deri në 300 persona, përveç objekteve që përfshihen në kategorinë e pestë.

Kategorinë e pestë: përfshihen të gjitha ndërtesat në të cilat numri i publikut nuk arrin njëzëri nga shifrat e caktuara për llojin e ndërtesës.

Objektet që pranojnë publik klasifikohen po ashtu edhe për nga lloji i shfrytëzimit të ndërtesës që paraqitet përmes një shkronje që tregon përdorimin për të cilin është ndërtuar.

L: Salla për audicion, konferenca, mbledhje, spektakle, për përdorim të shumëllojshëm.

M: Dyqane, qendra tregtare.

N: Restorante dhe shitje e pijeve. O: Hotele dhe pansione për familje.

P: Salla të vallëzimit dhe salla të lojërave.

R: Objekte për mësim-shkolla.

Rr: Objekte për pushime.

S: Biblioteka, qendra të dokumentacionit dhe të konsultimit të arkivave.

T : Salla të ekspozitave (për qëllime komerciale).  
U : Objekte mjekësore.  
V : Objekte të kultit.  
Ë : Administratat, bankat, zyrat.  
X : Objektet sportive të mbuluara.  
Y : Muzetë.  
PA:Objektet në qiell të hapur.  
CTS: Tenda cirku, tenda dhe struktura udhëtuese.  
SG: Struktura fryrëse.  
PS : Vende të parkimit të mbuluar.  
GA : Stacione në të cilat ka qasje publiku.  
EF : Objekte lëvizëse.  
REF: Strehim në male.  
OA: Hotele, restorante në lartësi të madhe mbidetare.

**Shkaqet e rrezikut** në ndërtesat kolektive janë:

- Zjarret,
- Tërmetet,
- Eksplozimet,
- Rrënimet,
- Vërshimet, etj.

**Faktorët e përkeqësimit:**

Zonat që paraqesin një dendësi shumë të madhe të popullatës mund të jenë faktor kyq në rast të ndodhjes së një fatkeqësie eventuale (si lagjet e populluara të qyteteve të Prishtinës, Pejës, Mitrovicës, Prizrenit, Gjilanit, Ferizajit dhe Gjakovës).

**Skenarët:**

- Zjarre në objekte banesore,
- Shembja e një ndërtese të lartë,
- Lëvizjet e turmave,
- Eksplozimet,
- Tërmeti.

**Pasojat**

Pasojat e këtyre fatkeqësive manifestohen me vdekje, rrënimet ndërtesash, avari, zjarre, shkatërrime të infrastrukturës vitale dhe infrastrukturës teknike, dëmtimin e ambientit si dhe trashëgimisë kulturore.

---

Profili i rrezikut	
<b>Rreziku:</b> Objektet kolektive.	
<b>Madhësia e mundshme (Përqindja e komunitetit që mund të goditet):</b> KRITIKE.	
<b>Frekuenca e ndodhjes:</b> Shumë e mundshme.	<b>Modeli sezonal:</b> Gjatë tërë vitit.
<b>Zonat që mund të goditen më së shumti:</b> Objektet kolektive.	
<b>Kohëzgjatja e mundshme:</b> Zjarret dhe rreziqet tjera që i kërcënojnë këto objekte mund të zgjasin vetëm disa orë apo më së shumti një ditë, ndërsa rreziku nga vërshimet mund të zgjasë 3 - 4 ditë.	
<b>Shpejtësia e mundshme e mësymjes (shuma e mundshme e kohës së paralajmërimit):</b> Paralajmërim 6 deri 12 orë ( për vërshime), kurse për zjarre dhe tërmete pa paralajmërim.	
<b>Sistemet ekzistuese të paralajmërimit:</b> Numri i integruar 112.	
<b>A ekziston analiza e dobësive / cenueshmërisë?</b> Po <input type="checkbox"/> Jo <input checked="" type="checkbox"/>	

### Cënueshmëria nga goditjet në faktorët kyç të komunitetit

Profili	Pasojat e mundshme	Shkalla e goditjes
Banorët	Vdekje/lëndime që rezultojnë në paaftësi të përhershme.	E ashpër
Pasuria	Shkatërrim /dëmtim i ndërtesave dhe pasurisë së tyre.	E ashpër
Infrastruktura vitale	Shkatërrim /dëmtim i rrjetit të: ujësjellësit, kanalizimit, energjisë dhe telekomunikacionit, etj.	E ashpër
Objektet e rëndësishme së veçantë	Shkatërrim /dëmtim i ndërtesave të Administratës, bankave, zyrave, objekteve shkollore, objekteve qeveritare.	E ashpër
Dëmet ekonomike	Shkatërrim /dëmtim i ndërtesave, pasurisë, infrastrukturës vitale, etj.	E ashpër
Ambienti	Kontaminimi i ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore.	E mesme
Trashëgimia kulturore	Shkatërrim /dëmtim i bibliotekave, arkivave, sallave të ekspozitave, objekteve të kultit, muzetë, etj.	E ashpër
Shërbimet shtetërore	Dëmtim i shërbimeve shtetërore dhe shërbimeve për qytetarë.	E mesme
Shërbimet emergjente	Dëmtime të pajisjeve dhe mjeteve të shërbimeve reaguese emergjente.	E mesme

### Skenarët:

- Zjarr në objekte banesore (Prishtinë).
- Shembja e një ndërtese të lartë (Pejë).
- Lëvizjet e pakontrolluara të turmave ( lëvizje nga paniku në objektet e rëndësishme në Gjilan).
- Eksplodim (Prizren).

### Konkludim

Kosova në përgjithësi i nënshtrohet një rreziku kritik të ndërtesave kolektive, sepse ato janë të shtrira në një territor të gjerë të vendit nëpër qendra të mëdha regjionale. Kryeqyteti i vendit, Prishtina ka shumë ndërtesa të banimit kolektiv, objekte të administratës shtetërore, komunale dhe të pranisë ndërkombëtare, për të cilat ndërtimi i egër i pasluftës e vështirëson intervenimin e shërbimeve reaguese emergjente.

## X. RREZIQET NË NDËRTESAT TEKNIKE TË NDJESHME - INFRASTRUKTURA TEKNIKE

### 10.1. Profili i rrezikut

**Përkufizimi:** Ndërtesa teknike të ndjeshme i konsiderojmë të gjitha ndërtesat/objektet publike ose private, në rast të fatkeqësive natyrore dhe tekniko- teknologjike, me ç' rast shkatërrimi ose dëmtimi i të cilave do të kishte pasoja kritike për sigurinë, shëndetin publik ose reperkusione të rënda sociale, ekonomike dhe financiare për vendin.

Në këtë kategori të ndërtesave përfshihen:

- Stacionet hekurudhore, aeroportet,
- Objektet ushtarake,
- Selitë administrative të kompanive të mëdha,
- Centralet telefonike,
- Instalimet e ndërlidhjes,
- Selitë e medieve të shkruara, televizive apo radiove,
- Ndërtesat administrative, qeveri, ministri, ambasada, konsullatave,
- Kuvendet komunale të qyteteve me më shumë se 10 000 banorë,
- Spitalet,
- Qendrat për ndihma,
- Pallatet e drejtësisë apo kuartet e drejtësisë,
- Qendrat e paraburgimit dhe burgje, etj.

Personat që shkelin ligjin edhe pse e kanë të kufizuar lirinë e lëvizjes, në rast të fatkeqësive të ndryshme ata cenohen sikurse edhe qytetarët e tjerë, ku për sigurinë e tyre përgatiten plane për evakuim dhe strehim.

Personat të cilët i takojnë kësaj kategorie janë të vendosur në këto qendra: Qendra Korrektuese në Dubravë, Lipjan dhe Smrekonicë, qendrat e paraburgimit në Prishtinë, Prizren, Pejë, Gjilan, Mitrovicë dhe Lipjan si dhe Burgu i Sigurisë së Lartë.

### Gjendja aktuale

Edhe pse në Kosovë kohëve të fundit janë evidentuar të dhëna bazuar në Desinventar sa i përket ndërtesave të infrastrukturës teknike, si dhe karakteristikave të tyre, ende mungojnë të dhëna të rëndësishme, të cilat mbeten si synim për t'u plotësuar në një të ardhme të afërt.

## Shkaktarët e rreziqeve

Shkaktarët që ndikojnë në paraqitjen e rreziqeve në ndërtesat teknike dhe të ndjeshme, janë të shumtë, të natyrave të ndryshme, si në vijim:

- Zjarret,
- Vërshimet,
- Tërmetet,
- Orteqet , shtrëngatat dhe erërat e fuqishme,
- Eksplozimet,
- Rrëshqitjet e dheut dhe erozionet,
- Ndërtimi i objekteve dhe ndërtesave teknike pa kriteret,
- Dëmtimi dhe shkatërrimi i objekteve nga trazirat sociale ( grevat, protestat, etj ) dhe aktet e ndryshme terroriste.

## Faktorët e përkeqësimit

Mungesa e vlerësimit të rreziqeve dhe mosaplikimi i standardeve, kriterëve dhe rregullave të ndërtimit, si dhe mungesa e hartës së infrastrukturës vitale.

## Pasojat

Pasojat e këtyre fatkeqësive manifestohen duke shkaktuar vdekje, rrënime ndërtesash, avari, zjarre, shkatërrime të infrastrukturës teknike, dëmtim i ambientit, si dhe trashëgimisë kulturore.

Profili i rrezikut	
<b>Rreziku:</b> Ndërtesat teknike të ndjeshme – infrastruktura teknike.	
<b>Madhësia e mundshme (Përqindja e komunitetit që mund të goditet):</b> Kritike.	
<b>Frekuenca e ndodhjes:</b> SHUMË E MUNDSHME.	<b>Modeli sezonal:</b> Gjatë tërë vitit.
<b>Zonat që mund të goditen më së shumti:</b> Zonat urbane.	
<b>Kohëzgjatja e mundshme:</b> Zjarret dhe rreziqet tjera që i kërcënojnë këto objekte mund të zgjasin vetëm disa orë apo më së shumti një ditë, ndërsa rreziku nga vërshimet mund të zgjasë 3 - 4 ditë.	
<b>Shpejtësia e mundshme e mësymjes (shuma e mundshme e kohës së paralajmërimit):</b>	
Për vërshime:	3 deri 6 orë.
Për zjarre.	10 deri 30 minuta.
Për tërmete.	Pa paralajmërim.
Trazirat civile.	Me paralajmërim.
<b>Sistemet ekzistuese të paralajmërimit:</b> Numri i integruar 112.	
<b>A ekziston analiza e dobësive / cenueshmërisë?</b>	
Po	<input checked="" type="checkbox"/>
Jo	<input type="checkbox"/>

### Cënueshmëria nga goditjet në faktorët kyç të komunitetit

Profili	Pasojat e mundshme	Shkalla e goditjes
Banorët	Vdekje /lëndime që rezultojnë në paaftësi të përhershme.	E ashpër
Pasuria	Shkatërrim/dëmtim i ndërtesave teknike të ndjeshme.	E ashpër
Infrastruktura vitale	Shkatërrim/dëmtim i rrjetit të: ujësjellësit, kanalizimit, energjisë, telekomunikacionit, infrastrukturës rrugore, etj.	E ashpër
Objektet e rëndësisë së veçantë	Shkatërrim/dëmtim i objekteve: shkollore, qeveritare, spitaleve, qendrave tregtare, etj.	E ashpër
Dëmet Ekonomike	Shkatërrim/dëmtim i ndërtesave teknike të ndjeshme shkaktojnë humbje materiale, infrastrukturore vitale, etj.	E ashpër
Ambienti	Kontaminim i mjedisit.	E ashpër
Trashëgimia kulturore	Shkatërrim/dëmtim i trashëgimisë kulturore, në objekte dhe arkeologji.	E ashpër
Shërbimet shtetërore	Dëmtim i shërbimeve shtetërore dhe shërbimeve për qytetarë.	E mesme
Shërbimet emergjente	Dëmtime të mjeteve dhe pajisjeve të shërbimeve reaguese emergjente.	E mesme

#### Profili i rrezikut

**Rreziku:** Zjarr në burgun e Dubravës.

**Madhësia e mundshme (Përqindja e komunitetit që mund të goditet):**

Kritike.

**Frekuenca e ndodhjes:**

SHUMË E MUNDSHME.

**Modeli sezonal:**

Gjatë tërë vitit.

**Zonat që mund të goditen më së shumti:** Pavionet e burgut .

**Kohëzgjatja e mundshme:** Disa orë.

**Shpejtësia e mundshme e mësymjes (shuma e mundshme e kohës së paralajmërimit):**

10 deri 30 minuta.

**Sistemet ekzistuese të paralajmërimit:** Radio – komunikimet.

**A ekziston analiza e dobësive / cënueshmërisë?**

Po

Jo



**Cënueshmëria nga goditjet në faktorët kyç të komunitetit**

Profili	Pasojat e mundshme	Shkalla e goditjes
Personeli dhe të burgosurit	Vdekje/lëndime që rezultojnë në paaftësi të përhershme.	E ashpër
Pasuria	Shkatërrim/dëmtim i hapësirave të qendrës së burgut.	E ashpër
Infrastruktura vitale	Shkatërrim/dëmtim i rrjetit të: ujësjellësit, kanalizimit, energjisë, telekomunikacionit, etj.	E ashpër
Objektet e rëndësisë së veçantë	Shkatërrim/dëmtim i hapësirave për mjekim, edukim, trajnim, etj.	E ashpër
Dëmet ekonomike	Shkatërrim/dëmtim i inventarit brenda objektit (duke shkaktuar humbje materiale, infrastrukture vitale, etj).	E ashpër
Ambienti	Kontaminim i mjedisit.	E ashpër
Shërbimet emergjente	Dëmtime të mjeteve dhe pajisjeve të shërbimeve reaguese emergjente.	E mesme

**Skenarët:**

1. Shkatërrimi i dokumenteve, mjeteve dhe pajisjeve vitale (librat amzë, protokollat zyrtare, regjistrat, arkivat, planet, etj) nga zjarri apo eksplozimi.
2. Uzurpimi i objekteve dhe ndërtesave teknike vitale.
3. **Zjarr në Burgun e Dubravës.** Në pavionin X në Burgun e Dubravës në dhomën Y ka shpërthyer një zjarr me ç'rast janë bllokuar 6 të burgosur, ndërsa tymi dhe gazrat janë përhapur në korridor dhe në dhomat tjera duke rrezikuar jetën e të burgosurve tjerë, si dhe personelit mbikëqyrës të burgut. Në këtë pavion gjenden 50 të burgosur.

## XI. RREZIQUET GJATË TRANSPORTIT

### 11.1. Transporti rrugor

**Rrjeti kryesor dhe rajonal rrugor** - rrjeti rrugor në Kosovë është i kategorizuar në rrugë magjistrale (nacionale) dhe rrugë rajonale, që janë nën administrimin e Ministrisë së Infrastrukturës<sup>26</sup> (MI) si dhe rrugë lokale, përfshirë edhe rrugët urbane dhe rurale nën administrimin e komunave. Rrjeti përfshinë gjatësinë e përafërt të rrugëve (shih Tabelën 16).

**Tabela 18 Rrjeti aktual i rrugëve në Kosovë (km).**

Tipi	Të asfaltuara	Përqindja	Të paasfaltuara	Përqindja	Totali në km
MI	1841	94.7%	103	5.3%	1944
Autostradë	79				79
Nacionale	585	99.5%	3	0.5%	588
Regjionale	1196	92.3%	100	7.7%	1296
Komunale					4761*
Lokale					4308*
Urbane					453*
Totali					6705

Rrjeti qëndror përfshinë:

- Rruga M2, që shtrihet nga kufiri verior me Serbinë, përmes Prishtinës e deri te kufiri jugor me Republikën e Maqedonisë. Kjo rrugë korrespondon me Rrugën 6 të Rrjetit qëndror rrugor të SEETO-së. Pjesa e saj jugore lidh Prishtinën me korridoret VII dhe X me rrugët ndërkombëtare (Evropa Jug-Lindore)<sup>27</sup>.
- Rruga M25, përfshin aksin Nish drejt kufirit verilindor Kosovë - Serbi, që kalon përmes Prishtinës dhe Prizrenit dhe lidhet me kufirin jugor Kosovë - Shqipëri. Kjo rrugë korrespondon me Rrugën 6 të Rrjetit qëndror rrugor të SEETO-s, duke u bërë një rrugë shumë e rëndësishme në pjesën e saj jugore pasi që lidh Ballkanin Qendror me atë Jugor.
- Rruga M9, nga kufiri lindor me Serbinë, përmes Prishtinës në Pejë dhe në kufirin perëndimor me Malin e Zi. Kjo rrugë ka momentalisht rëndësinë më të madhe kombëtare pasi që lidh dy qytetet e mëdha të Kosovës. Pjesa në drejtim të kufirit me Malin e Zi është momentalisht duke u rindërtuar dhe kjo do të ndikojë në përmirësimin e linjës me Malin e Zi.
- Rrugë kryesore shtesë janë: M9.1, M22.3, M25.2 dhe M25.3, që përbëjnë degë të këtyre lidhjeve kryesore.

Prishtina si qendër e infrastrukturës rrugore ka lidhje të mira me të gjitha qytetet.

26 Mungon vlerësimi i rreziqeve për autostradën "Ibrahim Rugova" R7.  
27 Shih në shtojcë, Harta nr 17. Rrjeti i Infrastrukturës rrugore.

Rrjeti rajonal përfshinë dy lloje të lidhjeve:

- Rrugë rajonale, që kanë rolin e plotësimit të hartës së rrjetit dhe përbëjnë lidhje mes boshtit kryesor dhe rajoneve ose lidhin vendbanime të rëndësishme në baza rajonale.
- Pjesët tjera të rrugëve rajonale lidhin vendbanimet ndërrurbane me rrjetin qendror<sup>28</sup>. Një pjesë e këtij rrjeti nuk është ndërtuar plotësisht dhe në përgjithësi janë të paasfaltuara.

**Rrjeti lokal rrugor** - Kosova i ka 38 komuna. Këto komuna janë përgjegjëse për mirëmbajtjen, operimin dhe zhvillimin e rrjetit rrugor të tyre. Po ashtu, komunat janë përgjegjëse për organizimin e rrjetit rrugor, për personelin e nevojshëm dhe për gjendjen e rrugëve lokale.

Është e ditur se kushtet e rrugëve lokale nuk mund të krahasohen me kushtet e rrugëve kryesore dhe rajonale, që në përgjithësi janë në kushte të pranueshme, për kundër mungesës së mirëmbajtjes. Rrugët rajonale janë të dizajnuara sipas një standardi, me një gjërësi të shtresës prej 6 m. Dizajni i rrugëve lokale përcjellë shpesh standardin e rrugëve rajonale, pasi që nuk ekziston ndonjë standard specifik, por mund të jetë më i ulët me një gjërësi të shtresës prej 3 m, ose më pak (kryesisht për rrugë të paasfaltuara).

Ministria e Infrastrukturës (MI) ka një program për rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve në bashkëpunim me komunat, i cili është realizuar në masë të konsiderueshme që nga viti 2008 e këndej. Kjo ministri ka realizuar mjaft investime në rrjetin rrugor rajonal dhe lokal, duke bërë riklasifikimin e rrjetit rrugor me ç'rast janë përfshirë më shumë rrugë nën përgjegjësi dhe fonde kombëtare.

### Transporti i udhëtarëve

Numri i automjeteve në Kosovë, sipas Ministrisë së Punëve të Brendshme, në vitin 2010, ishte 267,821, prej të cilëve:

- 82% vetura të udhëtarëve,
- 1% autobusë,
- 2% motoçikleta, dhe
- 14% kamionë.

Me rritjen e numrit të veturave private, ky numër sa vjen e shtohet.

Në Kosovë janë reth 400 ndërmarrje shërbyese të regjistruara për transportin e udhëtarëve me autobusë, të cilët i shfrytëzojnë 22 stacione kryesore dhe disa stacione tjera lokale në rrugë.<sup>29</sup>

## 11.2. Transporti hekurudhor

Rrjeti hekurudhor i Kosovës shtrihet në një gjatësi prej 333 km dhe përfshin linja të paelektrifikuara standarde njëdrejtimëshe.

Linja kryesore shtrihet nga kurfiri verior i Kosovës (në veri të Mitrovicës), kalon përmes Fushë- Kosovës (afër Prishtinës) deri në kufi me Maqedoninë (Hani Elezit). Kjo linjë e gjatë 141 km është pjesë e rrjetit hekurudhor qendror të SEETO-s, Rruga 10 dhe lidh Shkupin (IRJM) me korridoret VIII dhe X të SEETO-s.

28 Shih në shtojcë, Harta nr 18. Rrjeti i rrugëve kryesore dhe rajonale të Kosovës (Burimi: Ministria e Infrastrukturës).  
29 Shih në shtojcë Harta nr 19. Qarkullimi ditor i veturave; dhe Harta me nr 20. Qarkullimi ditor i autobusëve.

Linjat tjera hekurudhore<sup>30</sup> lidhin akset: Fushë Kosovë - Pejë, Klinë - Prizren (Klina gjindet në linjën mes Fushë Kosovës dhe Pejës) dhe Fushë Kosovë-Prishtinë-Podujevë. Disa nga këto linja nuk janë në funksion, sidomos ato në drejtim të kufirit me Serbinë, ndër to edhe lidhja hekurudhore me Podujevën, pastaj lidhja hekurudhore me Prizrenin, ndonëse kanë rëndësi për qytetarët e këtyre rajoneve.

TRAINKOS është kompani publike dhe është operatori i vetëm legal në Kosovë që ofron shërbime të transportit hekurudhor të udhëtarëve dhe mallrave.

Profili i rrezikut	
<b>Rreziku:</b> Transporti kolektiv tokësor.	
<b>Madhësia e mundshme (Përqindja e komunitetit që mund të goditet):</b> <b>Kritike:</b> 25 deri 50%.	
<b>Frekuenca e ndodhjes:</b> Shumë e mundshme: Mundësia afër 100% në vitin e ardhshëm.	<b>Modeli sezonal:</b> Gjatë tërë vitit.
<b>Zonat që mund të goditen më së shumti:</b> Tërë territori.	
<b>Kohëzgjatja e mundshme:</b> 3 deri në 6 orë.	
<b>Shpejtësia e mundshme e mësymjes (shuma e mundshme e kohës së paralajmërimit):</b> Pa paralajmërim.	
<b>Sistemet ekzistuese të paralajmërimit:</b> Numri i integruar 112.	
<b>A ekziston analiza e dobësive/cenueshmërisë?</b>	
Po	<input type="checkbox"/>
Jo	<input type="checkbox"/>

### Cënueshmëria nga goditjet në faktorët kyç të komunitetit

Profili	Pasojat e mundshme	Shkalla e goditjes
Banorët	Vdekje/lëndime që rezultojnë në paaftësi të përhershme (për shkak të ndeshjeve, rrokullisjeve dhe zjarreve).	E ashpër
Pasuria	Shkatërrim/ dëmtim i automjeteve dhe pronës private/publike.	E ashpër
Infrastruktura vitale	Shkatërrim / dëmtim i rrjetit të: ujësjellësit, energjisë, infrastrukturës tokësore,telekomunikacionit, kanalizimit, etj.	E ashpër
Objektet e rëndësisë së veçantë	Shkatërrim/ dëmtim i infrastrukturës: ndërtesave të administratës, bankat, zyrat, objektet shkollore, objektet qeveritare, dyqanet, qendrat tregtare, restorantet, etj.	E ashpër
Dëmet ekonomike	Shkatërrim / dëmtim i infrastrukturës rrugore, hekurudhore, mjeteve motorike , etj.	E ashpër
Ambienti	Shkatërrim/degradim i mjedisit (për shkak të derdhjeve të karburanteve të ndryshme nga ndeshjet, tymrat nga zjarret, kontaminimi i ujerave sipërfaqësore dhe nëntokësore, dhe kontaminimi me materie të rrezikshme).	E ashpër
Trashëgimia kulturore	Shkatërrim/ dëmtim i objekteve të trashëgimisë kulturore.	E ashpër
Shërbimet shtetërore	Dëmtim i shërbimeve shtetërore dhe shërbimeve për qytetarë.	E mesme
Shërbimet emergjente	Dëmtim i mjeteve dhe pajisjeve të njësive reaguese emergjente.	E mesme

## Skenari 1

### Përfshirja e autobusit në aksident zinxhirore

Në këtë rast, hipoteza më e madhe është aksidenti gjatë qarkullimit në transportin tokësor ku janë të përfshirë 20 automjete dhe një autobus, me më se 40 viktima të mundshme. Mundësia është relativisht e madhe.

Duke marrë parasysh trafikun rrugor relativisht të madh dhe kushtet meteorologjike nga njëherë të vështira në Kosovë, mundësia e një aksidenti të tillë është mesatare. Rreziku është mesatar.

## Skenari 2

### Aksident autobus / tren (kryqëzimi rrugë - hekurudhë)

Në këtë skenar, rasti kryesor është ndeshja ndërmjet autobusit dhe trenit në kryqëzimin rrugë- hekurudhë që të dy bashkë transportojnë 200 veta.

Një fatkeqësi e tillë do të shkaktonte 100 viktima potenciale. Rëndësia është katastrofike.

Duke pasur parasysh gjendjen e lënë mbas dore të infrastrukturës rrugore, hekurudhore sidomos sinjalistike në kryqëzimet rrugë-hekurudhë në Kosovë dhe mungesën e investimeve për të garantuar një nivel minimal të sigurisë, shpeshësia e ndodhjes është e madhe.

## Konkludim

Në dy skenarët, rastet e mëdha dhe të rënda sa i përket sigurisë kanë një mundësi të vogël që ato të ndodhin, rreziqet e transportit tokësor në Kosovë mund të jenë mesatare ose kritike duke marrë parasysh potencialin e madh të pasojave nga këto aksidente dhe mungesën e standardeve minimale të sigurisë në rrugë dhe rjetit hekurudhor, sidomos pajisja me sinjalizim horizontal dhe vertikal adekuat. Për më tepër, popullata e Kosovës preferon të udhëtojë me vetura në vend se të udhëtojnë me autobusë apo tren.

## 11.3 Transporti rrugor me materie të rrezikshme

Materiet e rrezikshme janë substanca që për nga përbërja fizike - kimike ose për nga natyra e reaksioneve mund të paraqesin rrezik për njeriun, të mirat materiale ose ambientin. Ato mund të jetë materie që digjen, toksike, eksplozive, gërryese (korrozive) ose radioaktive.

Aksidentet e mjeteve dhe automjeteve që transportojnë materie të rrezikshme kanë si efekt primar të menjëhershëm dhe që vërehet lehtë (zjarrin, eksplozimin, derdhjen) dhe efektet sekondare (përhapjen ajrore të avujve toksik ndotjen e ujërave dhe të tokës).

Vlerësimi në vazhdim ka të bëjë me aksidente ose incidente të transportit rrugor të materieve të rrezikshme.

Dallojmë dy lloje të aksidenteve të transportit rrugor me materie të rrezikshme:

- Aksidente të llojit "C" - janë aksidentet gjatë të cilave materiet e rrezikshme mbesin neutrale,
- Aksidente të llojit "M" - janë aksidente që karakterizohen qoftë me ndryshime të riparueshme të materies së rrezikshme qoftë me plehërimin e materies ose të humbjes së ngarkesës ose në fund qoftë edhe me eksplozimin ose djegjen e materies së rrezikshme.

Vaji Disulfurik dimetril disulfuri ( Incident i vitit 2008)-karakteristikat e tij.

Sipas udhëzuesit për intervenim kimik të CEDRE, dimetril disulfuri është një lëng i verdhë kundërmimi i të cilit është i fortë dhe ka erë të qelbur, ky është një përbërës avullues, që digjet lehtë në 5 gradë C i dëmshëm për njeriun dhe i rrezikshëm për ambientin), dimetril disulfuri përdoret në rafineri të naftës si agjent sulfuri, në petrokimi për procedurat e "decoking", në metalurgji për veçoritë anti korrozive dhe në sektorin agro-ushqimor përdoret si aromatizues.

Efikasiteti i tij i madh si "fungicid", (preparat që mbyth këpurdhat parazite), insekticid dhe nematicid, bën që dimetril disulfuri të jetë një zëvendësues potencial i bromurit të metilit në bujqësi. Ai përdoret gjithashtu si një ndërmjetës kimik për prodhimin e pesticideve.

Transportimi i materieve të rrezikshme në vendin tonë kryesisht zhvillohet nëpër rrugët magjistrale që lidhen me vendet fqinjë.

### Gjendja aktuale

Sipas Ministrisë së Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor në vendin tonë ekzistojnë afërsisht 800 pika të karburanteve ose 1 pikë karburanti për 800 vetura.

### Burimi i rrezikut

Burimet kryesore të rrezikut janë: kamionët cisternë dhe kamionët e rrafshët, si dhe të gjithë kontejnerët transportues.

76

### Faktorët e përkeqësimit:

Toksiciteti (mund të shkaktohet nga një goditje me prodhimin e shkëndijave (sidomos në cisternat e gazit që digjet), përmes nxehjes të një fuqie për prodhimin e avullit ( të komprimuar), si dhe përzierjes së disa produkteve si rezultat i ndezjes së papritur të shkëndijave ose të municioneve.

Zjarri - mund të shkaktohet nga ngrohja jo normale e një pjesë të automjetit, goditjet fizike (me prodhim të shkëndijave), ndezje aksidentale e materies së rrezikshme që rrjedh, eksplodim në afërsi të automjetit, madje edhe sabotim. 60 % e aksidenteve të transportit me mjete të rrezikshme kanë të bëjnë me materie të lëngshme ( që ndizen).

- Eksplodimi - Mund të jetë si shkak e një rrjedhe të produktit toksik ose si rezultat i djegies (po ashtu të një produkti toksik). Ai mund të përhapet në një distancë nga vendi i aksidentit).
- Ndotja e ujit dhe e tokës - ka të njëjtat shkaqe si të resë toksike (rrjedhja a materies së transportuar, zjarri...). Uji është jashtëzakonisht i ndjeshëm dhe ai e përshpejton përhapjen e ndotjes në distanca të mëdha.

### Shkaqet / Faktorët e përkeqësimit

- Menaxhim jo i duhur me materie të rrezikshme,
- Deponimi jo adekuat i materieve të rrezikshme,
- Mungesë e mbikëqyrjes dhe kontrollit,
- Përdorimi i papërgjegjshëm i substancave të rrezikshme.

## Pasojat

- Në njerëz ( vdekje , lëndime, djegie, helmime, etj) ,
- Të mirat materiale,
- Infrastrukturën vitale,
- Në ndotjen e ambientit ( tokës , ujit , ajrit ),
- Florës dhe faunës.

Profili i rrezikut	
<b>Rreziku:</b> Transporti i materieve të rrezikshme.	
<b>Madhësia e mundshme (Përqindja e komunitetit që mund të goditet):</b> Kritike.	
<b>Shpeshtësia e ndodhjes:</b> ▪ Shumë e mundshme.	<b>Modeli sezonal:</b> Gjatë transportit në stinët me të reshura, zjarreve urbane, tërmete, trazirave civile, demonstratave, etj.
<b>Zonat që mund të goditen më së shumti:</b> Rrjeti transportues dhe vendbanimet në afërsi.	
<b>Kohëzgjatja e mundshme:</b> 3-6 orë.	
<b>Shpejtësia e mundshme e mësymjes (afatet e mundshme të kohës së paralajmërimit):</b> Paralajmërim minimal (apo fare).	
<b>Sistemet ekzistuese të paralajmërimit:</b> Numri i integruar 112.	
<b>A ekziston analiza e dobësive/cenueshmërisë?</b> Po <input checked="" type="checkbox"/> x Jo <input type="checkbox"/>	

## Cënueshmëria nga goditjet në faktorët kyç të komunitetit

Profili	Pasojat e mundshme	Shkalla e goditjes
Banorët	Vdekje/lëndime( djegie, helmime, për shkak të ndeshjeve, rrokullisjeve, kontaminimit dhe zjarreve) që rezultojnë në paaftësi.	E ashpër
Pasuria	Shkatërrim/dëmtim i pasurisë publike dhe private.	E ashpër
Infrastruktura vitale	Shkatërrim/dëmtim i rrjetit: rrugor , ujësjellësit, kanalizimit energjisë telekomunikacionit, etj.	E ashpër
Objektet e rëndësishme të veçantë	Shkatërrim/dëmtim i ndërtesave të administratës, objekteve shkollore, qeveritare, qendrave tregtare, etj.	E ashpër
Dëmet ekonomike	Shkatërrim/dëmtim i mjeteve të transportit (trenave, automjeteve, autoboteve), hekurudhës, rrugëve, etj.	E ashpër
Ambienti	Shkatërrim/degradim i mjedisit ( për shkak të derdhjeve të karburanteve të ndryshme, tymit nga zjarret, kontaminimit të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore me materie të rrezikshme).	E ashpër
Trashëgimia kulturore	Dëmtim i vogël i objekteve të trashëgimisë kulturore.	E ultë
Shërbimet shtetërore	Dëmtim i shërbimeve shtetërore dhe shërbimeve për qytetarë.	E mesme
Shërbimet emergjente	Dëmtime të mjeteve dhe pajisjeve të shërbimeve reaguese emergjente.	E mesme



## Konkludim

Kosova i nënshtrohet një rreziku kritik të transportit rrugor me materie të rrezikshme, i cili mund të jetë më i madh në akset rrugore ku zhvillohet transporti i tyre nga kamionët me peshë të rëndë.

**Skenari 1.** Incidenti i një cisterne me materie të lëngshme që digjet,

**Skenari 2.** Rrjedhja e materieve të lëngshme që rrezikon ambientin,

**Skenari 3.** Rrjedhje e gazrave toksike që rrezikon popullatën,

**Skenari 4.** Kontaminimi radioaktiv.

SKENARI: Rrjedhja e acidit sulfurik nga parku industrial në Mitrovicë.

Acidi sulfurik gjendet në parkun industrial në Mitrovicë dhe në rast të mos menaxhimit të mirë mund të vie deri të rrjedhja e tij në tokë dhe si pasojë një sasi e tillë do të shkojë edhe të derdhet në lumin Ibër, ku do të vie deri ndotja e lumit dhe me ç'rast do të ballafaqohemi me rrezik si për njeriun po ashtu edhe për mjedisin. Po ashtu, pasojat nga rrjedhja e acidit sulfurik nga parku industrial në Mitrovicë do të kishte edhe efekte ndërkuftare.

## 11.4 Transporti ajror

78

### Autoriteti Civil i Aviacionit

Autoriteti Civil i Aviacionit të Republikës së Kosovës rregullon veprimtarinë e aviacionit civil në Republikën e Kosovës dhe është ofrues i shërbimeve të navigacionit ajror, sikur është përcaktuar me ligj.

### Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës "Adem Jashari", Limak Kosovo International J.S.C

Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës "Adem Jashari" u themelua në vitin 1965 për nevoja ushtarake të kohës dhe vetëm për fluturime të brendshme, ashtu që në vitin 1985 fillon edhe operimi civil sipas standardeve të ICAO-s.

Nga 15 tetori i vitit 1999 riaktivizohet nën mbikëqyrjen dhe kontrollin e forcave paqëruajtëse ndërkombëtare, fillimisht me operime ajrore humanitare dhe për nevoja civilo- ushtarake.

Për ngritjen e kapaciteteve, infrastrukture dhe rritjen e kualitetit dhe nivelin e sigurisë duke u certifikuar për përmbushjen e standardeve të sigurisë nga Autoriteti Islandez i Aviacionit Civil.

Me qëllim të avansimit të kapaciteteve tekniko-teknologjike dhe përmbushjes së nevojave dhe interesave kombëtare, bazuar në Ligjin për investime me partneritetin publiko-privat, Qeveria e Kosovës ofron aeroportin, „Adem Jashari” për menaxhim dhe operim konsorciumit turko-francez “Limak dhe Aeroports de Lyon”.

Konsorciumi turko-francez ka ofruar planin e biznesit dhe të investimeve kapitale për 20 vitet e ardhshme me mbi 100 milion Euro investime për ndërtimin e terminalit të ri, si dhe ngritjen dhe zgjerimin e kapaciteteve operuese.

Aeroporti i Prishtinës<sup>31</sup> përfshinë tërësinë e aktiviteteve komerciale ajrore të vendit dhe gjendet afër 15 kilometra në jug- perëndim të Prishtinës në një lartësi mbidetare prej 545 metrash. Sipërfaqja e aeroportit është rreth 195 hektarë.

#### Identifikimi i rrezikut:

Identifikimi i rrezikut	Transporti ajror
Niveli i rrezikut	Kritik
Vendi	Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës

#### Burimet e rrezikut/rreziqet

Rreziku potencial për paraqitjen e fatkeqësive natyrore, tekniko- teknologjike apo nga dora e njeriut, ka gjasë reale të ndodhë sidomos në zonat të aeroportit (ZA) dhe zonat fqinje të aeroportit (ZFA).

Rreziqet të cilat mund të kanosin transportin ajror mund të jenë: aksident dhe incident ajror, sabotim i kombinuar me kërcnim, rrëmbim aeroplani, aksident ajror të aeroplanëve transportues me materie të rrezikshme, zjarret në ndërtesat teknike të ndjeshme në aeroport, si dhe fatkeqësitë natyrore.

#### Faktorët e përkeqësimit:

- Kushtet klimatike ( mjegulla, shiu, bora, ngricat, shtrëngatat, temperaturat e larta, erërat e forta ,etj),
- Distanca e madhe e spitaleve dhe shërbimeve tjera emergjente reaguese,
- Mungesa e mjeteve dhe pajisjeve adekuate për reagim dhe kërkim –shpëtim,
- Trajnimet e pamjaftueshme profesionale për reagim në rast të fatkeqësive ajrore,
- Mungesa e helikopterëve dhe aeroplanëve të vegjël për kërkim shpëtim nga ajri.

#### Flukset e rrezikut:

- Numri i pasagjerëve: 1404775 Civil - 24965 ushtarak (referenca 2014)
- Numri i lëvizjeve vjetore: 13480 (referenca 2014)
- Lëvizjet ditore: 30
- Pika më e lartë mujore: 141212
- Numri i pistave: 1
- Gjatësia e pistës: 2501 m
- Gjerësia e pistes: 45 m
- Orari i operimeve i publikuar: 24 h x 7 ditë.

31 Shih në shtojcë, Harta nr 22. Aeroporti Ndërkombëtar.

**Pasojat:**

Gjatë ndodhjes së këtyre fatkeqësive pasojat të cilat paraqiten më së shpeshti janë:

- Vdekje, lëndime dhe trauma në njerëz ( pasagjerë dhe pjestarë të ekipeve reaguese ),
- Dëmtim dhe shkatërrim i infrastrukturës teknike,
- Dëmtim dhe shkatërrim i ambientit,
- Dëme të konsiderueshme materiale,
- Dëmtim dhe shkatërrim i mjeteve dhe pajisjeve të shërbimeve emergjente reagues.

**Masat parandaluese në aeroport:**

- Rritja nivelit të gatishmërisë për shërbimet emergjente reaguese ( NJIZSH të kategorisë së 8, të aeroportit ) 24 x 7,
- Furnizimi me mjete dhe pajisje të sofistikuar për reagim,
- Sofistikimi i sistemit të navigimit dhe aplikimi i masave të sigurisë,
- Sofistikimi i shërbimeve në trafikun ajror,
- Mbikëqyrja dhe kontrolli i mjeteve dhe pajisjeve të transportit ajror,
- Përforcimi i masave të kontrollit nga fatkeqësitë për aeroport dhe objekteve ndihmëse,
- Hartimi i planeve për reagim si dhe testimi i tyre.

Profili i Rrezikut	
<b>Rreziku:</b> Transporti ajror.	
<b>Madhësia e mundshme (Përqindja e komunitetit që mund të goditet):</b> Kritike.	
<b>Frekuenca e ndodhjes:</b> Shumë e mundshme.	<b>Modeli Sezonal:</b> Gjatë tërë vitit.
<b>ZONAT QË MUND TË GODITEN MË SË SHUMTI:</b> Aeroporti Ndërkombëtar Prishtina, zona rreth aeroportit dhe korridoret e fluturimit.	
<b>Kohëzgjatja e mundshme:</b> 3-5 orë.	
<b>Shpejtësia e mundshme e mësymjes (shuma e mundshme e kohës së paralajmërimit):</b> Pa Paralajmërim Me Paralajmërim	
<b>Sistemet ekzistuese të paralajmërimit:</b> Kulla e vrojtimit, numër i integruar emergjent (112).	
<b>A ekziston analiza e dobësive/cenueshmërisë?</b> <input type="checkbox"/> Po.	

**Cënueshmëria nga goditjet në faktorët kyç të komunitetit**

Profili i komunitetit	Pasojat e mundshme	Shkalla e goditjes
Pasagjerët: Banorët:	Vdekje/lëndime të rënda, trauma.	E ashpër
Pasuria	Shkatërrim/dëmtim i pasurisë publike dhe private.	E ashpër
Infrastruktura vitale	Shkatërrim/dëmtim i infrastrukturës së aeroportit, rrjetit të ujësjellësit, kanalizimit, energjetik, etj.	E ashpër
Objektet e rëndësisë së veçantë	Shkatërrim/dëmtim të: kullës së kontrollit të trafikut ajror, radarit, terminalëve, bazës së derivateve për aeroplanë, ndërtesave të administratës së aeroportit, bankave, zyrave, infrastrukturës vitale, etj.	E ashpër
Dëmet ekonomike	Shkatërrim/dëmtim i fluturakeve, objekteve në aeroport dhe jashtë tij,	E ashpër
Ambienti	Shkatërrim/degradim i mjedisit (kontaminim i ujërave sipërfaqësore, nëntokësore, dhe me materie të rrezikshme, si dhe ndotje e ajrit).	E ashpër
Trashëgimia kulturore	Dëmtimi i objekteve të trashëgimisë kulturore.	E ultë
Shërbimet shtetërore	Dëmtim i shërbimeve publike dhe shërbimeve për qytetarët.	E mesme
Shërbimet emergjente	Dëmtim i mjeteve dhe pajisjeve të njësisë reaguese emergjente.	E mesme

**Skenarët:**

- Rrëzimi i një aeroplani gjatë ngritjes ose aterimit, në afërsi të aeroportit,
- Rrëzimi i një aeroplan pa e ditur vendin e aksidentit (humbje nga radari),
- Përplasje ndërmjet dy aeroplanëve në pistat e aeroportit.

**Skenari 1**

Një aeroplan charter me 200 veta (pasagjerët dhe pjesëtarët e ekuipazhit) është rrëzuar në afërsi të aeroportit. Si pasojë e rrëzimit kanë vdekur 120 pasagjerë dhe pjesarë të ekuipazhit, ndërsa janë të lënduar (rëndë dhe lehtë) 80. Dëmet materiale janë të konsiderueshme, pasi që rrëzimi i aeroplanit është përcjellur edhe me një shpërthim të madh, me ç'rast janë dëmtuar disa shtëpi banimi, si dhe restorani AVIANO.

**Skenari 2**

Një aeroplan charter me 170 veta (pasagjerët dhe pjesëtarët e ekuipazhit) është rrëzuar diku në malet e Çyçavicës si pasojë e kushteve të rënda klimatike dhe defektit të shfaqur në sistemin e drejtimit të aeroplanit. Lokacioni i saktë i rrëzimit të aeroplanit nuk dihet por dyshohet për pasoja fatale në njerëz.

**Skenari 3**

Dy aeroplanë të linjës charter me nga 200 pasagjerë janë përplasur ndërmjet vete në pistën e aeroportit. Gjatë përplasjes është shkaktuar zjarr i madh, viktimat të shumta në njerëz, si dhe ndotje e mjedisit si pasojë e shpërthimit në ajër dhe rënies së mbetjeve të aeroplanëve në zonën përreth.

**Konkludim**

Mund të konkludojmë se rreziku i paraqitjes së fatkeqësive gjatë transportit ajror në Kosovë, është i nivelit kritik, marrë parasysh zhvillimin e hovshëm të tij.

## XII. RREZIQET INDUSTRIALE

### 12.1 Energjia

Korporata Energjetike e Kosovës sh.a. (KEK sh.a.) ka qenë ndërmarrja e vetme energjetike në Republikën e Kosovës, e integruar vertikalisht dhe e korporatizuar në fund të vitit 2005.

Fillimi i procesit të reformimit të sektorit të energjisë daton nga viti 2004 me themelimin e ZRRE-së. Procesi ka vazhduar me shthurjen e kompanisë vertikalisht të integruar KEK, dhe krijimin e Operatorit të sistemit të transmisionit dhe Tregut-KOSTT (viti 2006) që tani operon si entitet i veçantë. Shthurja e mëtejshme ka vazhduar me ndarjen e shpërndarjes dhe furnizimit nga KEK-u. Pas shthurjes, shpërndarja dhe furnizimi janë privatizuar në maj 2013 me kalim në pronësi të kompanive prestigjioze turke konsorciumit Çalik Holding dhe Limak. Në fund të vitit 2014 është bërë shthurja ligjore e shpërndarjes dhe furnizimit, që ka rezultuar me krijimin e dy kompanive KEDS dhe KES-CO.

Ndërmarrjet kryesore që operojnë me energji elektrike në Kosovë janë:

- Korporata Energjetike e Kosovës (KEK sh.a.),
- Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës (KOSTT sh.a.),
- Kompania Kosovare për Shpërndarje të Energjisë Elektrike (KEDS),
- Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike (KES-CO),
- Hidrocentralet (HC): Ujmani, Lumbardhi, Radaci, Dikanci dhe Burimi.

Prodhimi i energjisë elektrike në vend bëhet kryesisht nga Korporata Energjetike e Kosovës (KEK sh.a), e cila përbëhet nga dy termocentrale (Kosova A dhe Kosova B) si dhe Minierat e Qymyrit (Mihja e re Sibovci Jug-Perëndim dhe Sitnica), dhe në një masë të vogël nga Hidrocentrali Ujmani dhe HC-të tjera distributive(Lumbardhi, Radaci, Dikanci dhe Burimi). Kapacitetet e instaluar të termocentraleve janë 1478 MW, mirëpo për shkak të vjetërsisë së tyre, aktualisht kapaciteti operativ i tyre sillet rreth 915 MW. Kapacitetet e instaluar hidrike janë 48.18 MW.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur kapacitetet e instaluar gjeneruese sipas llojit dhe vitit të futjes në operim.

**Tabela 19. Kapacitetet gjeneruese në sistemin elektroenergjetik të Kosovës.**

Njësitë prodhuese	Kapaciteti i njërive (MW)			Futja në operim
	Instaluar	Neto	Min/max	
Termocentralet				
A1	65	Nuk operon		1962
A2	125	Nuk operon		1964
A3	200	182	100-130	1970
A4	200	182	100-130	1971
A5	210	187	100-135	1975
TC Kososva A	800	551		
B1	339	310	180-260	1983
B2	339	310	180-260	1984
TC Kososva B	678	620		
Total TC	1478	1171		
Hidrocentralet				
HC Ujmani	35	32		1983
HC Lumbardhi	8.08	8.00		1957 (2006)
HC Dikanci	3.34	3.18		1957 (2013)
HC Radavci	0.90	0.84		1934 (2010)
HC Burimi	0.86	0.80		1948 (2011)
Total HC	48.18	44.82		
Energjia nga era	1.35	1.35		2010
Total	1527.53	1217.17		

Kompania Kosovare për Shpërndarje të Energjisë Elektrike (KEDS) e licencuar nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë operon me shpërndarjen e energjisë elektrike. Kompania KEDS është e shpërndarë në 7 distrikte me lokacion në shtatë qytetet kryesore të Kosovës dhe në 30 nëndistrikte, ku përfshihen komunat e vendit. KEDS ka për detyrë që të bëjë shpërndarjen e energjisë elektrike deri te konsumatori i fundit, menaxhon dhe mirëmban asetet në teren. Në kuadër të KEDS janë të përfshira linjat e Tensionit të Mesëm 35 kV, 10 kV dhe 6 kV (kilovolt) së bashku me trafostacionet përkatëse, Trafostacionet 10/0.4 kV, linjat e Tensionit të Ulët 0.4 kV.

Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike, sh.a. (KES-CO), është kompani e themeluar nga aksionari Kosovo Çalik Limak Energy sh.a., si rezultat i shthurjes dhe ndarjes ligjore të aktiviteteve të furnizimit nga aktivitetet e shpërndarjes të KEDS. KESCO filloi aktivitetin më 1 janar 2015 dhe është i vetmi furnizues publik i energjisë elektrike në Kosovë, në bazë të licencës së lëshuar nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë në Republikën e Kosovës. KES-CO ka më shumë se 470 mijë konsumatorë të ndarë në tri kategori: konsumatorë të amvisërisë, komercial dhe industrial.

Sistemi i transmissioinit menaxhohet nga Operatori i Sistemit të Transmissioinit dhe Tregut (KOSTT sh.a.). Sistemi i transmissioinit të energjisë elektrike është i ndërlidhur me të gjitha sistemet fqinje në nivelin 400 kV përveç me Shqipërinë me të cilën ekziston linja 220 kV. Ndërtimi i linjës së re interkonektive 400 kV NS Kosovë B-NS Kashar (Tiranë) sa i përket pjesës së Kosovës ka përfunduar në fund të vitit 2015, dhe kjo linje parashikohet të hyjë

në operim pas përfundimit të projektit nga ana e Shqipërisë. Me hyrjen në operim të kësaj linje do të ndikojë në ngritjen e kapaciteteve transmetuese ndërmjet dy vendeve dhe regjionit, ngritjen e sigurisë dhe besueshmërisë së sistemit elektroenergjetik të Kosovës dhe Shqipërisë, si dhe optimizmin e punës së dy sistemeve.

Gjatësia e tërësishme e linjave të transmisionit (400 kV, 220 kV dhe 110 kV) është 1223km.

KOSTT sh.a menaxhon Sistemin e Transmisionit të Republikës së Kosovës duke operuar me nivele të tensionit të lartë 400 kV, 220 kV, 110 kV dhe tensionit të mesëm 35 kV, 10 (20) kV si pjesë përbërëse të transformatorëve energjetik në kufi me KEDS-in, duke siguruar në mënyrë të sigurt dhe të besueshme transmetimin e energjinë elektrike nga njësitë e gjenerimit deri të sistemi i shpërndarjes, 24 orë në ditë, 365 ditë në vit përfshirë rrjedhat ndërkufitare.

**Tabela 20 . Disa të dhëna numerike nga fillimi i operimit të KOSTT deri më tani.**

Viti	2006	2015
Kapaciteti N	930 MW	1550 MW
Kapaciteti N-1	645 MW	1100 MW
Piku	916 MW	1180 MW
Linja 400 Kv	181.4 km	188.49 km
Linja 220 kV	231.8 km	231.8 km
Linja 110 kV	643.5 km	776.3 km
Nënstacione nr.	4	6
Stacion shpërndarës nr.	1	1
Nënstacione të transferuar nga KEK nr.	0	28
Transformator energjetik nr./kapaciteti	10 TR / 2300 MVA	14 TR / 3150 MVA
Transformator energjetik të transferuar nga KEK nr./kapaciteti	0	50 TR / 1702.5 MVA
Humbjet	3.78 %	1.28 %

### Divizioni i prodhimit të qymyrit

Në qymyr planifikohen katër sisteme kontinuale dhe shtatë ekskavator rotor, (E-8, E-6, E-7, E-4, E-3, E-1, E-1). Dy sisteme janë të montuar në trasenë e re të minierës "Sibofci" JP dhe dy sisteme në trasenë e vjetër në shpatin verior "Mirash". Nuk planifikohet montim i linjës së dytë teleskopike në këtë periudhë pesë vjeçare. Nga këto sisteme me qymyr furnizohen TC "Kosova" A dhe B.

### Termocentrali "KOSOVA-A"

Përbëhet nga pesë blloqe të njohura si A1, A2, A3, A4 dhe A5. Blloku A1 i këtij termocentrali është lëshuar në punë në vitin 1962 me fuqi prej 65 MW; A2 në vitin 1965 me fuqi prej 65 MW; A3 në vitin 1970 me fuqi 200 MW; A4 në vitin 1971 me fuqi 200 MW dhe A5 në vitin 1975 me fuqi prej 210 MW.

Blloqet A3, A4 dhe A5 janë funksional. Prodhimi vjetor i energjisë elektrike nga TC Kosova A është rreth 1500 GWh.





*Mihja sipërfaqësore*



*Termocentrali "Kosova A dhe B"*

### **TERMOCENTRALI "KOSOVA-B"**

Përbëhet nga dy blloqe punuese të njohura si B1 dhe B2. Blloku i parë i këtij termocentrali është lëshuar në punë në vitin 1983 me fuqi prej 339 MW, kurse B2 në vitin 1984 me fuqi të njëjtë, 339 MW. Të dyja këto blloqe janë funksionale.

Prodhimi vjetor i energjisë elektrike sillet rreth 4500 GWh.

### **Identifikimi i rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe teknologjike**

#### **Rreziqet e identifikuar në KEK:**

- Vërshimet e ujit ( përmbytjet ) në kompleksin ku prodhohet energjia,
- Rrëshqitjet lokale të djerrinës dhe qymyrit,
- Rreziqet nga zjarri (zjarret masive të hamulloreve nën ose pran linjave të tensionit të lartë) , vetëndezja e qymyrit ,etj,
- Erërat e fuqishme (stuhitë) të përcjellura me mot të lig (linjat e tensionit të lart),
- Lirimi i gazrave toksike,
- Tym nga mbeturinat që digjen në vetvete,
- Kërcënimet nga bombolat dhe rezervuarët me H<sub>2</sub>, rezervuarët me naftë dhe mazut,
- Eksplozimet elektrike,
- Tërmetet,
- Trazirat dhe pakënaqësitë në vendin e punës.

#### **Rreziqet nga materiet dhe zonat e rrezikshme në TC-A**

Materiet eksplozive dhe lehtë ndezëse:

1. **Hidrogjeni (H<sub>2</sub>)**, i prodhuar në repartin e Elektrolizës, rrethi nr. 1, dhe i deponuar në rezervuarët adekuat me shtypje deri në 10 bar,
2. **Nafta**, e stacionuar në tre rezervuarë (500.000 lit. dhe 2 X 50.000 lit.),
3. **Deponia e vajrave dhe lubrifikanteve** (30-50 fuqi),
4. **Qymyri**, në sistemin e bartjes së qymyrit dhe në bunkerë (sasi prej 10 t),
5. **Shiritat e gomës.**



**Tabela 21. Materiet radioaktive-Izotopet.**

1	TC-A	Rezervuarët e pompave pneumatike	A3	4		
2	TC-A	Rezervuarët e pompave pneumatike	A4	4		
3	TC-A	Rezervuarët e pompave pneumatike	A5	4		
4	TC-A	Hinkat e filtrave	A5	12		
5	TC-A	Bunkerët e hirit	A3- A5	3	Të instaluar	Jashtë pune
6	TC-A	Bunkerët e hirit	A3-A5	2 ?	Të instaluar	Jashtë pune
7	SK	Bunkeri i izotopeve të varrosura	SK		Të varrosura	

Në zonën e DSK-së gjendet Bunkeri Special për deponimin e Burimeve të shpenzuara radioaktive. Burimet radioaktive janë kryesisht izotope të kobaltit ( $Co^{60}$ ) që kanë qenë të instaluar në gjeneratorët e repartit të Gazifikimit dhe të TC-A. Bunkeri Special për deponimin e burimeve radioaktive është i ndërtuar enkas për këtë qëllim. Bunkeri është nën ingjencat e AKMRrSB, por vazhdimisht monitorohet edhe nga ekipet e KFOR-it dhe FSK-ja, që bëjnë edhe matjen e radioaktivitetit. Vlerat e matura nuk janë të rrezikshme për kohë të shkurtra të ekspozimit.

Në Termocentralin "Kosova-A", në Bunkerin e vjetër të hirit edhe më tutje qëndrojnë tre kontejner me burime radioaktive, e të cilat duhet të largohen nga bunkeri i hirit dhe të dërgohen në Bunkerin Special për deponimin e materialit të njëjtë. Edhe përkundër sigurimit të gjitha lejeve të parapara sipas Ligjit për Agjencinë e Kosovës për Mbrojtjen nga Rrezatimi dhe Siguri Bërthamore, në mungesë të ofertuesve dhe për shkak të procedurave të prokurimit mbetet që këto burime t'i dislokojmë gjatë këtij viti 2015.

Me 10.01.2015 ekipi i Institutit të Mjekësisë së Punës - shërbimi i Mbrojtjes nga rrezatimi, me autorizimin e Agjencisë Kosovare për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguri Bërthamore, e kanë bërë inspektimin e burimeve radioaktive të cilat gjenden në deponinë (Bunkerin) e përkohshëm të Mbetjeve radioaktive në Termocentralin "Kosova A"-KEK (Gazifikim).

Secilit nga burimet i është bërë matja e dozës, gamaspektometria, është bërë grupimi sipas llojit të pajisjeve, i është shoqëruar një numër identifikuese i cili fillon nga Nr 1. Matjet janë bërë kur burimet janë në kontejner, përveç grupit të katërt.

**Tabela Nr.1. Inventarizimi i burimeve të shpenzuara radioaktive.**

Nr.	Grupimet sipas llojeve	Lloji i izotopit	Sasia(copë)	Nr. identifikues	Doza maksimale në kontakt
1	-I- rë	Co-60	26	1-26	24.0-30.8 µSv/h
2	-II- të	Co-60	12	27-38	5.4-8.6 µSv/h
3	-III- të	Cs-137	6	39-44	60.2-68.4 µSv/h
4	-IV- të	Co-60	10	45-54	68.8-74.7 µSv/h
5	-V- të	Nuk dihet	2	55-56	sfond
6	-VI- të	Co-60	2	57-58	0.5-0.9 µSv/h
7	-VII- të	Nuk dihet	13	59-71	sfond

Gjithashtu në hapësirat jashtë bunkerit me burime radioaktive gjenden tre rrufepritës radioaktiv të cilëve ju shoqërohet numri përkatës.

**Tabela Nr.2. inventarizimi i rrufepritësve radioaktiv.**

Nr.	Qyteti	Pronari	Vizita me	sasia	Nr. identifikues	Kategorizimi sipas IAEA
1	Obiliq	KEK-Gazifikim	16/12/14	1	1/15-1	4
2	Obiliq	KEK-Gazifikim	16/12/14	1	1/15-2	5
3	Obiliq	KEK-Gazifikim	17/12/14	1	1/15-3	4

Në hapësirat e Termocentralit "Kosova A" - bunkerit i vjetër i hirit dhe në objektin e transportit hidraulik të hirit.

**Tabela Nr.3. Inventarizimi i burimeve të montuara në objektet e TC-A.**

Nr.	Qyteti	Pronari	Vizita me	sasia	Nr. identifikues	Kategorizimi sipas IAEA
1	Obiliq	TC-A	16/01/15	1	1/15-4	
2	Obiliq	TC-A	16/01/15	1	1/15-5	
3	Obiliq	TC-A	16/01/15	1	1/15-6	
4	Obiliq	TC-A	16/01/15	1	1/15-7	
5	Obiliq	TC-A	16/01/15	1	1/15-8	
6	Obiliq	TC-A	16/01/15	1	1/15-9	
7	Obiliq	TC-A	16/01/15	1	1/15-10	

**Përfundim:**

Në pronësi të institucionit në fjalë gjenden:

- Në bunker 71 burime radioaktive të vendosura në kontejner (nga ta Cs-137 janë 6 copë, Co-60 janë 50 copë si dhe për 15 kontejner tjerë nuk i dihet lloji i burimit).
- Në hapësirat jashtë bunkerit si rrufepritës radioaktiv gjenden tre burime të vendosura në pikat më të larta të objekteve të kompleksit industrial të Gazifikimit.
- Në bunkerin e vjetër të hirit janë tre kontejner me burime radioaktive të shpenzuara.

Në objektin e transportit hidraulik të hirit janë të montuar si matës të nivelit dhe densitetit katër (4) burime radioaktive. *Shënim: këto burime radioaktive janë të regjistruara në listën e burimeve radioaktive të Republikës së Kosovës si pronë e jona dhe ne na obligon që t'i monitorojmë dhe për ndryshimet eventuale të raportojmë autoritetet.*

**Materiet kimike (kemikalet të cilat përdoren për trajtimin e ujrave në repartin e p.k.u. TC-A)**

1. Acid klorhidrik (HCl) 31-33%,
2. Hidroksid i natriumit (NaOH) 40-45%,
3. Gelqere e hidratizuar  $\text{Ca(OH)}_2$ ,
4. Aktifos 645,
5. Hidrazin hidrat (levoksin),
6. Dioksid karboni ( $\text{CO}_2$ ),
7. Hidrogjen,
8. Hidroksid i kaliumit.

*Vërejtje: Këto kemikate janë të deponuara në repartet e PKU dhe në depo të TC KOS.-A*

**Kimikatet të cilat përdoren si reagjentë për analizat e ujrave në laboratorin e përgatitjes kimike të ujit:**

Nr.	Emri i kimikatit	Sasitë
1	KLORUR MAGNEZI --- $\text{MgCl}_2$	0.5KG
2	OKSALAT NATRIUMI --- $\text{NaC}_2\text{O}_4$	1.4kg
3	KALIUM PERMANGANAT $\text{KMnO}_4$	5kg
4	DIKLOR MANGAN ---- $\text{MnCl}_2 \times 4\text{H}_2\text{O}$	
5	NATRIUM AZID ---- $\text{NaN}_2$	500gr.
6	SULFAT MANGANI --- $\text{MnSO}_4$	5kg
7	KARBONATI BAZIK I PLUMBIT --- $(\text{PbCO}_3) \times \text{Pb(CH}_3)_2$	4kg
8	KLORURI I BARIUMIT --- $\text{BaCl}_2$	2kg
9	KLORURI I KALIUMIT --- KCl	3.5kg
10	FENANTRALIN --- $\text{C}_{12}\text{H}_9\text{N}_2\text{Xh}_2\text{O}$	30gr.
11	KLORUR HIDROKSIDAMONI ---- $\text{HONH}_3\text{Cl}$	1kg
12	4-DIMETIL BENZALDEHID ---- $\text{C}_9\text{H}_{11}\text{NO}$	2kg
13	ACID OKSALIK $\text{C}_2\text{H}_4\text{O}_4 \times 2\text{H}_2\text{O}$	4kg
14	JODUR KALIUMI --- KJ	8kg
15	NATRIUM TETRABORAT	s,ka fare
16	INDIKATOR ERIOKROM I ZI-T	400gr.
17	KOMPLEKSONI -III-	4kg
18	PARAMETIL AMINOFENOL-SULFAT	250gr.
19	KALIUM CIANID --- KCN	3.5kg
20	OKSID BAKRI --- CuO	200gr.
21	SUDAN -III-	s,ka fare
22	KALIUM HIDROFOSFAT	500gr.
23	INDIKATOR METIL BLU	100gr.
24	DIKLOR I BAKRIT	1.5kg

25	ACID TARTARIK (VENE)	s,ka fare
26	NATRIUMI BISULFIT	200gr.
27	NITRAT AMONI	200gr.
28	KLORUR ZINGU	s,ka fare
29	BAKER ELEMENTAR	200gr.
30	TOLUIDIN	
31	REAGENS PER AMONJAK -WESSLER	100gr.
32	INDIKATOR METILORANZH	200gr.
33	SULFAT BAKRI	200gr.
34	NITRAT ARGJENDI	s,ka fare
35	KLORUR I ZHIVES	s,ka fare
36	KALLAJ (GRANULA)	100gr.
37	OKSALAT AMONI	250gr.
38	KALIUM NATRIUM - TARTARAT	250gr.
39	NATRIUM BISULFAT	250gr.
40	ETIL ACETAT	2lit
41	PEROKSID HIDROGJENI	2lit
42	TRETJE STANDARTE E JODIT	2lit
43	JOD KRISTALE	s,ka fare
44	ACID BORIK	1kg
45	INDIKATOR BLU 6B	
46	ACID PIKRIK	300gr.
47	DIOKSID PLUMBI	750gr.
48	JODUR I ZHIVES	75gr.
49	KARBONAT BARIUMI ---- $BaCO_3$	s,ka fare
50	SULFAT BAKRI ---- $CuSO_4$	1kg
51	ALFA 1 ----- $C_{10}H_8N_2$	5gr.
52	MUREKSID INDIKATOR	200gr.
53	4-DIMETIL AMINOBENZALDEHID	1kg
54	AMIDON	2kg
55	KLORUR NATRIUMI	10kg
56	ALKOOL ETILIK	7lit
57	ACETON	3lit
58	METANOL	2lit
59	ACID LIMONI	1kg.
60	NITRAT ARGJENDI - AMPULA 0,1N	s,ka fare
61	ACID SULFURIK 1N	s,ka fare
62	HIDROKSID I NATRIUMIT 0,1N	s,ka fare
63	NATRIUM TETRABORIK	s,ka fare
64	PIROGALLOLL	2kg
65	KALIUM DIKROMAT	5kg
66	NATRIUM TIO-SULFAT	1kg
67	FENOLFTALEIN-INDIKATOR	1.5kg
68	NITRAT I ZHIVES--- $Hg(NO_{3/2})_2$	100gr.
69	HIDRAZIN SULFAT	800gr
70	BIKARBON I NATRIUMIT	3kg
71	AMONJAK 25%	7lit
72	KLORUR AMONI	2kg
73	KLORUR MANGANI	250gr.

74	GLICERIN	s,ka fare
75	ACID FOSFORIK	s,ka fare
76	ACID NITRIK 65%	2lit
77	TRETJE PUFERIKE pH=7	3Lit
78	TRETJE PUFERIKE--- 9	3lit.
79	TRETJE PUFERIKE -4	2lit
80	TRETJE PUFERIKE -10	4lit.
81	AMONIUM HEPTAMOLIBDAT	2kg
82	NATRIUM SULFIT AMPULA 0,1N	s,ka fare
83	METOLL	1.5kg
84	KLOROFORM	3lit.
85	TRIPLEX AMPULA 0,1N	s,ka fare
86	ETIL METILKETON	
87	NITRAT ZHIVE 99%	250gr.
88	FERI AMONJUMSULFAT	1kg
89	TETRA KLORUR KARBONI	s,ka fare
90	KALIUM HIDROFOSFAT	500gr.
91	PERISULFAT I AMONIT	15kg
92	ACID KLORHIDRIK 37%	10lit.
93	HIDROKSID I KALIUMUIT	3kg

#### *Materiet kimike në Seperimet Kimike (SK)-Këto materie janë larguar nga DSK-ja*

90

Materiet e rrezikshme që kanë mbetur nga procesi teknologjik deri në vitet 1988/1989, kur ndalon punën reparti i Kimisë, gjenden të deponuara nënproduktet e gazit termik: **Uji fenolik / Zift, Katran** ( i rëndë / vaj i mesëm / benzol) **Fenol i koncentruar**.

Uji fenolik .....rezervuar , sasia 14.000 m<sup>3</sup>,

Ter i rëndë .....rezervuar , sasia 750 m<sup>3</sup> (800 - 1000) m<sup>3</sup>,

Fenol i koncentruar<sup>1</sup>, rezervuar, sasia rreth 1000 m<sup>3</sup>,

Fenol i papërpunuar Totali 18.000 m<sup>3</sup>.

Në Qershor 2006 nga një kompani Bullgare pati filluar largimin e benzolit, me çka janë hequr 60m<sup>3</sup>, por që u ndal më pas. Nga ujërat rrjedhëse të **Ngrohtores** janë liruuar **60/70 mg /l** të fenolit, ndërsa nga **Kimia** janë liruuar **700/800 mg/l** të fenolit.

**Normë: Fenoli i lejuar në ujërat rrjedhëse 0.03 mg/l (0.015mg/l).**

Ndërsa në kohën kur ka funksionuar Reparti i Kimisë, 3 mg/l.

Gjendja momentale: Nga Ministria e Mjedisit dhe KEK është angazhuar firma e specializuar për analizimin e gjendjes së tyre, kontaminimit të tokës dhe propozimet për formën e asgjësimit.

Kompania ende nuk ka prezantuar rezultatet dhe presim preferencat. Është evidente se mostrat e marra nga thellësia e tokës deri në 50m, nga kjo kompani, rezultojnë se nuk ka kontaminim të tokës në rrethinë e hapësirës ku gjenden këto deponime.

Në Harilaq është duke e përgatitur një deponi e materie të rrezikshme kimike për deponim, burim: Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë (MMPH).



## Materiet dhe zonat e rrezikshme në TC-B

Materiet eksplozive dhe lehtë ndezëse:

- **Hidrogjeni (H<sub>2</sub>)**, i prodhuar në repartin e Elektrolizës, rrethi nr. 1, dhe i deponuar në tre rezervuarët adekuat me shtypje deri në 10 bar,
- **Nafta**, e stacionuar në një rezervuarë (500.000 lit. 1 X 500.000 lit.),
- **Mazuti**, i stacionuar në një rezervuar (5.000.000 lit.) dhe rezervuari pranues (200 deri 300 ton),
- **Deponimi e vajrave dhe lubrifikanteve** (30-50 fuqi),
- **Qymyri**, në sistemin e bartjes së qymyrit dhe në bunkerë (sasi rreth 400t, për 8 h),
- **Shiritat e gomës**, në transportin e brendshëm duhet të zëvendësohen me shirita gome zjarrdurues.




Skema e impianteve me materie lehtë ndezëse

## Përshkrimi i shkurtër historik i ngjarjeve të ndodhura nga fatkeqësitë natyrore dhe teknologjike, që nga themelimi e deri në vitin 2014 (KEK)

Disa nga rreziqet e shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe teknologjike që kanë ndodhur në KEK:

- Avari në objektin e Elektrolizës së ujit ( me datën 06.06.2014 ne TC “Kosova-A”) me ç’rast ka ndodhur eksplozimi i rezervuarve të H<sub>2</sub> (Hidrogjenit). me pasoja në njerëz ( 2 të vdekur dhe 14 lënduar ).
- Rrëshqitja e masave të djerrinës dhe qymyrit në pjesën e Sibovcit JP.(me datën 06.01.2015) me çërast janë shkaktuar qarje tektonike në sheshin qymyror, pa pasoja në njerëz dhe makineri.





Harta nr.23. Harta tematike e KEK-ut.

### Përshkrimi i shkurtër historik i ngjarjeve të ndodhura nga fatkeqësitë natyrore dhe teknologjike, që nga themelimi e deri në KOSTT.

Ngjarje të ndodhura nga fatkeqësitë natyrore dhe teknologjike:

- **shkaku:** era e fuqishme e përcjellur me borë.
- **pasojat:** rrëzimi dhe dëmtimi i dy shtylla 220 kV në majën e Çiçavicës me dëm të konsiderueshme material dhe zvogëlim të besueshmërisë së furnizimit me energji elektrike.
- **shkaku:** era e fuqishme me shpejtësi të madhe.
- **pasojat:** rrëzimi dhe dëmtimi i dy shtylla 110 kV në teren të hapur në afërsi të nënstacionit 110/ 10 kV Gjakova 2 me dëm të konsiderueshëm material dhe zvogëlim të besueshmërisë së furnizimit me energji elektrike.
- **shkaku:** erozioni i tokës pranë bazamentit të shtyllës nga uji i rrëmbyeshëm pas daljes nga shtrati të Drinit të bardhë.
- **pasojat:** rrëzimi dhe dëmtimi i një shtylle 110 kV pranë shtratit të lumit Drini i Bardhë me dëm të konsiderueshëm material dhe zvogëlim të besueshmërisë së furnizimit me energji elektrike.

Ka pasur disa raste të rrëzimit të shtyllave nga veprimet vandale të personave të pa përgjegjshëm të cilat për pasojë kanë shkaktuar dëme të konsiderueshme materiale dhe rrezikim të punës normale të sistemit elektroenergjetik. Çdo rrëzim i shtyllave pavarësisht nga shkaku përcillet edhe me rënien e përçueseve në tokë, të cilët për shkak të rrymës, peshës, lartësisë dhe fuqisë goditëse mund të shkaktojnë edhe dëmtime tjera anësore në prona publike apo private si dhe në njerëz.

KOSTT trashëgoi një sistem transmetues me mungesë të madhe të kapacitetit transmetues, si dhe në pjesë të caktuara të tij me pajisje shumë të vjetruara dhe mos plotësim të kriterit N-1. Për pasojë deri në zhvillimin e kapaciteteve të reja dhe modernizimin e sistemit transmetues ka pasur disa raste të këputjes së përçuesve për shkak të mbingarkesës së vazhdueshme dhe seksionit të pamjaftueshëm, dëmtimin e një transformatori energjetike të stërvjetruar (mbi 50 vite), si dhe një bllokut të përgjithshëm (rënie e plotë e sistemit transmetues) për një kohë të shkurtër.

KOSTT mund të atakohet nga rreziqet natyrore p.sh.: tërmetet, rrëshqitjet masive të tokës (linjat në terrene të pjerrëta), përmbytjet (nënstationet në terrene të ulëta, shtyllat pranë lumenjve); erërat e fuqishme (stuhitë) të përcëlluar me mot të lig (linjat e tensionit të lart); zjarret në pyje ose zjarret masive të hamulloreve nën ose pranë linjave të tensionit të lart.

Rreziqet për shkak të procesit teknologjik të KOSTT-it p.sh.: manifestimi i zjarreve lokale në nënstatione, rrëzimi i shtyllave të tensionit të lartë (problem vjedhja e profileve metalike), këputja e përçuesve në linja të tensionit të lartë (mundësi për paraqitje të zjarrit dhe dëmtim të pronave). Të gjitha këto situata mund të shkaktojnë ndërprerje lokale ose regjionale të energjisë elektrike.



Harta nr 24. Rrjeti transmetues i Sistemit Elektroenergetik të Republikës së Kosovës.

### Konkludime:

1. Për shkak të shtrirjes së aseteve gjithandej Republikës së Kosovës cilado nga fatkeqësitë natyrore janë potencialisht të mundshme të kenë pasoja në KOSTT.
2. Zjarret e shkaktuar në përmasa të mëdha nga natyra apo njeriu.
3. Veprimet vandale dhe dukuria e vjedhjes së profileve metalike nga persona të papërgjegjshëm në shtyllat e tensionit të lart.

### Rekomandime:

1. Angazhimi i KOSTT-it në përmbushjen me sukses të detyrave dhe përgjegjësi konform ligjeve dhe licencave.
2. Shkëmbimi i informatave dhe bashkëpunimi i ndërsjellë mes KOSTT dhe institucioneve relevante.

Profili i rrezikut	
<b>Reziku:</b> Materiet radioaktive-izotopet.	
<b>Madhësia e mundshme (Përqindja e komunitetit që mund të goditet):</b> Kritike: 25 deri 50%.	
<b>Frekuenca e ndodhjes:</b> ▪ E mundshme, vitin e ardhshëm ose së paku një gjasë në 10 vitet e ardhshme.	<b>Modeli sezonal:</b> Gjatë tërë vitit.
<b>Zonat që mund të goditen më së shumti:</b> Objektet dhe hapësirat e TC Kosovës – A, si dhe lagjeja e Hashaneve në perëndim jashtë perimetrit të TC-A – Kastriot.	
<b>Kohëzgjatja e mundshme:</b> Relativisht e shkurtë 3 - 5 ditë.	
<b>Shpejtësia e mundshme e mësymjes (shuma e mundshme e kohës së paralajmërimit):</b> ▪ Paralajmërim minimal (apo fare). ▪ <u>Paralajmërim 6 deri 12 orë.</u>	
<b>Sistemet ekzistuese të paralajmërimit:</b> Siguria fizike – telefon dore.	
<b>A ekziston analiza e dobësive/cenueshmërisë?</b> Po <input type="checkbox"/> Jo <input checked="" type="checkbox"/>	

### Cënueshmëria nga goditjet në faktorët kyç të komunitetit

Profili	Pasojat e mundshme	Shkalla e goditjes
Banorët	Vdekje, lëndime apo sëmundje që rezultojnë në paaftësi të përhershme, akute, (për shkak të goditjes nga rrezatimi, kontaminimi).	E ashpër
Pasuria	Kontaminim dhe dëmtim i objekteve ne hapësirat e TC-A.	E ashpër
Infrastruktura vitale	Shkatërrim /dëmtim i rrjetit të ujësjellësit, kanalizimit, energjisë dhe telekomunikacionit ,trafostacioneve, etj.	E ashpër
Objektet e rëndësisë së veçantë	Nuk ka.	E ultë
Shërbimet emergjente	Dëmtime të mjeteve dhe pajisjeve të shërbimeve reaguese emergjente.	E mesme
Ambienti	Shkatërrim /degradim i mjedisit (për shkak të kontaminimit dhe rrezatimit ).	E ashpër
Trashëgimia kulturore	Nuk ka.	E ultë
Shërbimet shtetërore	Nuk ka.	E ultë
Dëmet ekonomike	Dëmtim i objekteve, shtëpive, pasurisë dhe infrastrukturës.	E mesme

### Skenari 1

Pas një shiu të vrullshëm në komunën e Obiliqit është vërsuar infrastruktura kritike e KEK-ut (hapësirat dhe objektet e TC-A), gjegjësisht bunkeri në të cilin gjenden materiet jonizuese. Në këtë rast janë kontaminuar objektet dhe hapësirat përreth bunkerit, në një perimetër prej 500 m.

**Skenari 2**

Pas një shiu treditor në komunën e Obiliqit është vërsuar infrastruktura kritike e KEK-ut ( hapësirat dhe objektet e TC-A), gjegjësisht bunkerit në të cilin gjenden materiet jonizuese. Në këtë rast janë kontaminuar objektet dhe hapësirat përreth bunkerit, punëtorët të cilët kanë qenë duke punuar në afërsi, ndërsa përmbytja e madhe ka shpërndarë këto materije edhe jashtë hapësirave të TC-A gjegjësisht edhe lagjet përreth.

**Skenari 3**

Një zjarr i madh ka kapluar bunkerin në të cilin janë të vendosura materiet radioaktive jonizuese, me ç'rast është shkaktuar një shpërthim i fuqishëm i cili ka shkatërruar bunkerin dhe ka dëmtuar rëndë objektet përreth në hapësirat e TC-A dhe objektet e banimit në dy lagjet në afërsi të TC-A. Eksplodimi ka shkaktuar vdekje, kontaminim të punëtorëve të TC-A dhe të qytetarëve në të dy lagjet, me pasoja të mëdha.

**Konkludim:**

Për shkak të masave të dobëta parandaluese, mungesës së personelit dhe pajisjeve në aspektin e certifikimit, licencimit, trajnimit dhe ushtrimeve për këto lloj situatash, konkludojmë se TC-A duhet të merr masa të shpejta dhe profesionale për të menaxhuar fatkeqësitë e këtij lloji.

**12.2 Aksidentet industriale**

Një objekt industrial mund të klasifikohet si "rrezik teknologjik" derisa aktiviteti i tij mund të jetë në origjinë të ngjarjeve aksidentale realizimi i të cilave do të kishte pasoja të rënda dhe të menjëhershme për shëndetin, sigurinë dhe mjedisin.

Shenjat kryesore të rreziqeve industriale janë:

- Zjarri nga ndezja e një materie në kontakt me tjetrën, të një flake ose të një pikë të nxehtë, me rrezik të djegieve dhe të asfiksionit.
- Eksplodimi nga përzieja e disa materieve dhe lirimi i menjëhershëm i gazit, shkakton pasoja direkte në njerëz dhe në infrastrukturë.
- Përhapja e materieve të rrezikshme me toksicitet, në ajër, ujë ose në tokë, të cilat merren përmes inhalimit, ushqimit ose kontaktit me prodhime të kontaminuara.

Burimet e rreziqeve janë:

- Toksiciteti.
- Eksplodimi.
- Zjarri.
- Ndotja.

Kosova ka mjaft burime natyrore, të tilla si qymyr, krom, bakër, lëndë drunore etj. Para vitit 1990, Kosova kishte një industri mjaft të zhvilluar, mirëpo gjatë viteve 1990 prodhimi industrial i Kosovës shkoi vazhdimisht duke rënë.

Si pasojë e rënies së aktivitetit industrial, industria dhe sistemet e instaluara teknologjike aktualisht nuk paraqesin rreziqet e ndjeshme teknologjike për popullsinë dhe të mirat materiale,

mirëpo një sasi materialesh, lëndësh e produktesh të rrezikshme, gjenden ende në stoke. Rreziku industrial ka të bëjë me mundësinë që pas një aksidenti në objekte industriale mund të shpërthejë zjarr i përcjellur me eksplozime, duke krijuar në ajër re toksike me substanca në gjendje të gaztë të cilat shkaktojnë pasoja në popullsi apo mjedis. Efektet e një aksidenti industrial mund të zbuten duke zbatuar masat të paracaktuara emergjente si brenda objektit industrial ashtu dhe jashtë tij.

### **Pikat e nxehta në Kosovë**

Pikat e nxehta mjedisore janë krijuar dhe të trashëguara si rezultat i veprimtarisë industriale të së kaluarës, të shkaktuara nga aktivitetet e minierave, nga deponitë e vjetra të pa menaxhuara, nga kimikate të deponuara, vajra mbeturinë, pesticide të skaduara etj. Pikat e nxehta kanë shpërndarje të ndryshme në territorin e Kosovës duke paraqitur kërcënimin e vazhdueshëm në mjedis dhe shëndetin e popullatës.

### **12.3.Mbetjet industriale dhe të rrezikshme**

Mbetjet industriale krijohen nga zhvillimi i proceseve tekniko-teknologjike që kanë si rezultat prodhimin e ndonjë produkti industrial. Republika e Kosovës në të kaluarën kryesisht ka pasur të zhvilluar eksploatimin e xehes dhe metalurgjinë, kështu që me kalimin e kohës shumica e kapaciteteve industriale dhe teknologjike janë vjetruar dhe kanë ndërprerë proceset. Disa substanca dhe përzierje në gjendje të ndryshme agregate kanë mbetur për shumë kohë pa u përdorur dhe aktualisht gjenden nëpër stabilimente, të vendosura në magazina dhe reparte të ndryshme industriale, të cilave iu ka skaduar afati apo janë degraduar duke ndryshuar përbërjen e tyre e që paraqesin shkallë të lartë të rrezikshmërisë për mjedisin dhe shëndetin e njeriut.

Deri më tani janë identifikuar 94 lokacione me këto materie, ku 71 prej tyre janë kompetencë e ekspertëve vendor (për mbikëqyrje-inspektim), ndërsa 23 janë nën mbikëqyrjen e KFOR-it, të cilat kanë shkallë të lartë të rrezikshmërisë.

Lokacionet e identifikuar me mbetje të rrezikshme industriale<sup>32</sup>, janë klasifikuar sipas shkallës së rrezikshmërisë. Masat parandaluese me qëllim të zvogëlimit të rrezikut janë ndërmarrë nga ekipi inspektues ( i mbështetur edhe me donatorë nga vendet tjera ) i përbërë nga FSK, KFOR-i, MMPH dhe AME.

Gjatë inspektimeve është konstatuar se gjendja e këtyre deponive në aspektin e sigurisë dhe mbikëqyrjes(kujdesit) nga përgjegjësit/ pronarët e ri të objekteve në shumicën e rasteve janë në nivelin e duhur të përgjegjësisë, por në disa raste të veçanta ka dobësi dhe pa përgjegjësi(mbikëqyrje jo e duhur dhe jo e mjaftueshme).

Në përgjithësi mbetjet e kimikateve të cilat gjenden në lokacionet e identifikuar kanë veti: eksplozive, oksiduese, të ndezshme, helmuese, korrozive, irrituese, kancerogjene, mutagjene dhe forma tjera të rrezikshme për mjedisin. Me një depozitim të tyre pa një standard të duhur të mbrojtjes dhe izolimit ndaj mjedisit, ato janë shkaktar të ndotjes së ujërave sipërfaqësor dhe nëntokësor, ajrit dhe tokës.

### **Masat parandaluese**

Bazuar në detyrat dhe përgjegjësitë, ekipi inspektues ka rekomanduar në vijimësi një mori masash dhe hartim planesh me qëllim të eliminimit të rreziqeve që mund të shkaktohen për njerëzit, florën, faunën, tokën ajrin dhe ujin.

32 Shih në shtojcë, Harta nr.25 Lokacionet e mbetjeve industriale të rrezikshme.

## Rekomandime

- Përcaktimi i lokacionit për grumbullimin, sistemimin, mbikëqyrjen dhe sigurinë e duhur të të gjitha këtyre mbetjeve industriale të rrezikshme.
- Trajnimi dhe aftësimi profesional i personelit të ngarkuar për mbikëqyrje të këtyre materieve.
- Rregullimi i infrastrukturës së nevojshme për plotësimin e kushteve për trajtimin, mbikëqyrjen rigoroze në aspektin e sigurisë së këtyre materieve.
- Pajisja e personelit me mjete adekuate për trajtimin e këtyre mbetjeve industriale.
- Krijimi i një baze të të dhënave për përmbajtjen, llojin, sasinë, efektin, rrezikun, etj.

Profili i rrezikut	
<b>Rreziku:</b> Rreziku nga aksidentet industriale.	
<b>Madhësia e mundshme (Përqindja e komunitetit që mund të goditet):</b> Kritike: 25 deri 50%.	
<b>Frekuenca e ndodhjes:</b>	<b>Modeli sezonal:</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ E mundshme: Mundësia midis 10 dhe 100% në vitin e ardhshëm, ose së paku një gjasë në 10 vitet e ardhshme.</li> </ul>	Gjatë tërë vitit .
<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <b>Zonat që mund të goditen më së shumti:</b> Zonat industriale dhe rrethina.</li> </ul>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <b>Kohëzgjatja e mundshme:</b> 2- 8 ditë.</li> </ul>	
<b>Shpejtësia e mundshme e mësymjes (shuma e mundshme e kohës së paralajmërimit):</b> Paralajmërim 12 deri 24 orë.	
<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <b>Sistemet ekzistuese të paralajmërimit:</b> numri i integruar 112.</li> </ul>	
<b>A ekziston analiza e dobësive/cenueshmërisë?</b>	
Po	<input checked="" type="checkbox"/>
Jo	<input type="checkbox"/>

Karakteristikat	Ashpërsia
Vdekje dhe lëndime të rënda që rezultojnë në paaftësi të përhershme.	E ashpër (kritike)
Ndërprerja e plotë e aktiviteteve në objekte/shërbime për së paku 2 javë.	
Më shumë se 25% e të mirave materiale të dëmtuara.	

Faktorët kyç të komunitetit				
Gjeografik	Demografik	Të mirat materiale	Infrastruktura kritike	Objektet e rëndësishë së veçantë
Tiparet e mëdha gjeografike.  Modelet tipike meteorologjike.	Madhësia e popullatës, shtrirja/ shpërndarja, përqendrimi.  Numri i njerëzve në zonat e cënueshme.  Popullatat e veçanta.  Kafshët.	Numri,  Lloji,  Vjetërsia,  Rregullat e ndërtimit,  Rreziqet e mundshme dytësore.	Sistemi i Ujësjetës, Energjia, Depot ushqimore, Mullinjtë, Kanalizimet.	Shkollat,  Foshnjoret,  Spitalet,  Ndërtesat qeveritare,  Ndërtesat publike,  Ndërtesat industriale,  Pikat e karburanteve.

Faktorët kyç të komunitetit			
Komunikacioni dhe Telekomunikacioni	Trashëgimia Kulturore	Ambienti	Humbjet Ekonomike
		Toka  Uji  Ajri	

**Cënueshmëria nga goditjet në faktorët kyç të komunitetit**

Profili	Pasojat e mundshme	Shkalla e goditjes
Banorët	Vdekje / lëndime të rënda që rezultojnë në paaftësi të përhershme.	E ashpër
Pasuria	Shkatërrim/dëmtim i pronës publike dhe private.	E ashpër
Infrastruktura vitale	Shkatërrim/dëmtim i rrjetit: rrugor, të ujësjetës dhe kanalizimit, energjetik, telekomunikacionit, etj.	E ashpër
Objektet e rëndësishë së veçantë	Shkatërrim/dëmtim i ndërtesave të administratës, bankat, zyrat, objektet shkollore, objektet qeveritare, dyqanet, qendrat tregtare, restorantet, etj.	E ashpër
Dëmet ekonomike	Shkatërrim/dëmtim i pasurisë publike dhe private .	E ashpër
Ambienti	Dëmtim / degradim i mjedisit për shkak të derdhjeve të ndryshme, gazrave dhe tymit, kontaminim i ajrit, ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, tokës pjellore, ushqimit dhe kafshëve.	E ashpër
Trashëgimia kulturore		E ultë
Shërbimet shtetërore	Dëmtim i shërbimeve shtetërore dhe shërbimeve për qytetarë.	E mesme
Shërbimet emergjente	Dëmtime të mjeteve dhe pajisjeve të shërbimeve reaguese emergjente.	E mesme

**Skenari: Derdhja e materieve të rrezikshme në Liqenin e Batllavës.**



## XIII.RREZIQET EPIDEMIOLOGJIKE

### 13.1 Rreziku i ndotjeve ( hedhjeve ) në ujë

Uji si resurs vital i aktivitetit të përditshëm njerëzor, gjenë përdorim në shumë lëmi, si në ambientin shtëpiak, atë bujqësor dhe industrial. Andaj ndotja e tij paraqet rrezik për popullatën, të mirave materiale, si dhe dëmtim e degradim të florës dhe faunës.

Me termin ndotje e ujrave nënkuptojmë të gjitha veprimet aksidentale, kriminale dhe të qëllimshme ,të cilat kryesisht janë të natyrës kimike, fizike dhe bakteriologjike. Burimi i rreziqeve mund të jetë industrial, natyror, nga faktori njeri ose si pasojë e aksidenteve gjatë transportit të materieve të rrezikshme, me ç’rast shkaktojnë ndotje në rrjedhat dhe burimet e ujit, ujërat sipërfaqësor dhe nëntokësor, impiantet etj, duke çrregulluar rëndë furnizimin me ujë të popullatës dhe ekosistemin.

#### Gjendja aktuale

Kosova është burim i ujërave<sup>33</sup>, e pasur me liqej/ujëmbledhës dhe lumenjë, disa nga të cilët rrjedhin në detëra të ndryshme. Lumenjtë kryesor janë Drini i Bardhë, Ereniku, Sitnica, Ibri, Morava, Lepenci dhe lumi Llap. Ujëmbledhësit më të mëdhenjë në Kosovë janë: Ujëmani(Gazivoda;380 milionë m<sup>3</sup>) në pjesën veri-perëndimore, Radoniqi (113 million m<sup>3</sup>) në pjesën jug-perëndimore, Batllava (40 milionë m<sup>3</sup>), Badovci (26 millionë m<sup>3</sup>) në pjesën veri-lindore dhe Përlepnicë (4.2 milion m<sup>3</sup> ujë), gjithashtu edhe ujvarat si:

- Ujvara e Drinit, 25 metra që ndodhet në grykëderdhje të lumit Drini i Bardhë, dhe
- Ujëvara e Mirushës që përbëhet prej një mori ujëvarash të lumit Mirusha, si njëra nga degët e Drinit, në komunën e Malishevës në perëndim të Kosovës, në pjesën lindore të regjionit të Dukagjinit.

Kurrizoret ujëndarëse të tri drenazheve kryesore ( Drini i Bardhë, Ibri dhe Lepenci ) takohen me njëri tjetrin afërsisht 16.5 km në perëndim të Ferzajit, në zonën kadastrale të budakovës -Komuna e Therandës (Suharekës).

Më këtë pikë kontakti të tri kurrizoreve ujëndarëse ndodhet mali i Dermanit me lartësi 1.359 m mbi nivelin e detit. Prej kësaj pike sipërfaqja ujore derdhet në drejtim të Detit Adriatik, Detit të Zi ose Detit Egje.

Qytetet kryesore të Kosovës furnizohen nga ujëmbledhësit:

- GAZIVODA (UJMANI) për Mitrovicën.
- BATLLAVA dhe BADOVCI për Prishtinën.
- RADONIQI për Gjakovën.
- PËRLEPNICA për Gjilanin.

#### Faktorët e përkeqësimit:

Cilësia e ujit të lumenjve fushor është shumë e dobët për arsye të mungesës së trajtimit të ujërave të zeza, ndërsa cilësia e ujit të lumenjve malorë është shumë e mirë. Disa nga lumenjtë kryesorë që kalojnë nëpër qytete të mëdha dhe industri ndoten rëndë sa që uji i tyre nuk mund të shfrytëzohet për ujë të pijes apo edhe për ujitje (p.sh. lumi Sitnica). Poashtu

edhe intervenimet e NATO-s janë një faktor tjetër përkeqësimi që ka ndikuar në cilësinë e ujit<sup>34</sup>. Sipas NATO-së rreth 31 000 predha janë përdorur gjatë konfliktit në Kosovë.<sup>35</sup>

Ujërat industriale në të shumtën e rasteve nuk trajtohen dhe ato derdhen drejtpërdrejt në lumenj, kontrollimet bakteriologjike tregojnë se shumica e lumenjve të Kosovës janë të ndotur.

### Karakterizimi i flukseve

Flukset e rrezikut që burojnë nga ky lloj i rrezikut janë:

- Thatësia,
- Ndotjet (industriale, bujqësore),
- Kontaminimet (parazitare, radioaktiv, biologjike, bakteriologjike),
- Vërshimet.

### Pasojat:

Këto rreziqe kanë pasoja në të mira materiale infrastrukturë vitale, mjedis, por shumë shpesh shkaktojnë edhe bilanc fatal të dëmeve në njerëz.

### Shenjat pararendëse

Situatat pararendëse mund të identifikohen vetëm në raste pasojash, dëmtim i vegjetacionet, peshqve etj.

## 13.2 Helmimet me ujë

Sëmundjet ngjitëse të sistemit tretës janë kozmopolite dhe ndër më masoviket në numër. Për shkak të karakteristikave epidemiologjike specifike, ky grup i sëmundjeve është mjaft kompleks si nga pasqyra klinike, epidemiologjike, masat luftuese ashtu edhe pasojat shëndetësore, ekonomike dhe sociale. Ky grup i sëmundjeve është i pranishëm kryesisht në vendet e pazhvilluara dhe ato në zhvillim. Janë këto vendet të cilat nuk e kanë të zgjidhur problemin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe kontrollin e kualitetit të ushqimit. Fatkeqësisht janë edhe shumë faktorë të tjerë që ndihmojnë në paraqitjen dhe bartjen e këtyre sëmundjeve (eliminimi johigjienik i mbeturinave, numri i madh i insekteve, fatkeqësitë elementare natyrore etj.) Nga Intoksikacionet alimentare janë regjistruar 460 raste. Po ashtu, në këtë vit janë regjistruar 56 epidemi familjare dhe kolektive nga Hepatiti A, Intoksikacione alimentare dhe Gastroenterokolite. Brengos fakti se numri i caktuar i këtyre sëmundjeve janë të pranishme edhe në Kosovë përkundër masave të ndërmarra.

Sipas MAPH, raportit për gjendjen e ujërave në Republikën e Kosovës/2015/, rreth 80 % e popullatës së Kosovës, furnizohet me ujë nga ujësjellësit publik, ndërsa rreth 60 % e popullatës ka qasje në rrjetin publik të kanalizimit.

Kosova është dhe vazhdon të mbetet zona endemike e sëmundjeve që përhapen me ujë dhe ushqim. Vetëm gjatë vitit 2008 sëmundjet të cilat përcillen me ujë dhe ushqim janë Diare akute 55%, HAV 43% nga numri total i rasteve të sëmundjeve ngjitëse të regjistruara në Kosovë.

34 NATO gjatë intervenimit në Kosovë ka përdorur municione me uranium të varfëruar në formë të predhave me kalibër 300 mm, nga aviacioni i luftës kundër tankeve. Çdo predhë e këtij kalibri përmban 300 gram të uraniumit të varfëruar.

35 Shih në shtojcë, Harta 27. Zonat e goditura artilerike me përmbajtje të uraniumit të varfëruar.

Verifikimi i vlerësimit të rrezikut gjatë epidemive hidrike në situata emergjente, përbëhet nga tri faza:

- Faza e identifikimit,
- Faza e përshkrimit, dhe
- Faza e evoluimit.

Epidemitë hidrike në situata emergjente prekin një numër të madh njerëzish (ose rrezikojnë ata), dhe kontaminimi i ujit mund të bëhet edhe me qëllim. Mundësitë e epidemive hidrike vijnë si pasojë e:

- Mungesës së sasive të mjaftueshme të ujit të rregullt higjienik;
- Mundësia e ndotjes së sasive ekzistuese të ujit me mjete kimike, radiologjike, biologjike, mikroorganizma.

Duke qenë se shumë mikrobe patogjene ruajnë aftësinë e tyre jetësore, së paku disa ditë në ujë, transmetimi nëpërmjet ujit është rrugë mjaftë e shpeshtë e përhapjes së shkaktarëve të sëmundjeve ngjitëse.

Njihen epidemitë hidrike të kolerës nga Gjon Snow në vitin 1854 në Londër, 1802 nga Robert Kohu në Hamburg me 17000 të sëmurë dhe 8605 të vdekur. Në Kosovë njihet epidemia e tifos abdominale në vitin 1984 në Mitrovicë dhe Shtime si pasojë e depërtimit të ujërave të zeza në rrjetin e ujësjellësit.

### **Furnizimi me ujë të pijshëm në Kosovë**

Prishtina furnizimin me ujë e ka nga liqeni akumulues i Batllavës, Badovcit dhe burime nëntokësore të Kuzmini, Mitrovica nga akumulacioni Gazivoda (Ujmani), Peja nga "Hidrodrini" (Uji i Zi dhe Burimi i Drinit), Gjakova nga Liqeni akumulues i Radoniqit, Prizreni nga bunarët e shpuara nëntokësore, Gjilani nga liqeni akumulues i Prelepnices (Guri i Hoxhës, burim nëntokësor) dhe Ferizaj nga lumi Nerodime.

Furnizimi i kompletuar, i qëndrueshëm dhe i sigurtë i banorëve me ujë të pijshëm është kur sigurohen:

- Kontinuiteti (furnizim i vazhdueshëm, pa ndërprerje),
- Kualiteti (Cilësia),
- Qasja,
- Sasia.

Uji është rrugë e përhapjes së rreth 200 sëmundjeve të cilat në mënyra të ndryshme lidhen me ujë, andaj OBSH këto sëmundje i ka sistemuar në 4 kategori:

1. Sëmundjet, shkaktarët e të cilave merren me ujë të kontaminuar: diarea, kolera, tifoja abdominale, skraja, parazitët, Hepatiti Viral A, etj.
2. Sëmundjet, e shkaktuara nga sasia dhe qasja jo adekuate ndaj ujit "sanitacioni i ulët" Skabiesi, Hepatiti Viral A, Tifo e Morrit, piodermite, Trahoma etj.
3. Sëmundjet, shkaktarët e të cilave futen në organizëm përmes lëndimeve trupore: Tularemia, Leishmaniaza.
4. Sëmundjet vektoriale, shkaktari i të cilave, një pjesë të ciklit jetësor e ka të lidhur me ujë: Malaria, Tularemia, Loa-loa, Ethet Denge, Ethet e Verdha, Ethet Hemorragjike.

## Faktorët e përkeqësimit

Faktorët jashtë shëndetësor:

Infrastrukturë jo mirë e rregulluar e sistemit të ujësjellësit dhe kanalizimit në nivel Kosovë, (Detyrë dhe obligim kjo e faktorëve relevant në nivel komune dhe shteti). Kushtet e dobëta higjienike-sanitare (sidomos në institucionet parashkollore, shkollore, familje dhe kolektive, ku nyjat sanitare janë në nivel higjienik të ulët.). Furnizimi me ujë johigjienik të pijes (pasojë e reduktimeve të shpeshta të ujit, rrymës dhe alternativat e furnizimit me ujë të pijes nga burime të ndryshme të pakontrolluara). Shpërndarja joadekuate e mbeturinave (sidomos në zonat rurale). Mungesa e edukatës shëndetësore e popullatës në lidhje me mbajtjen e higjienës personale, familjare (doket, veset etj) e veçanërisht në larjen e duarve para bukës dhe pas shkuarjes në WC etj.

Gjersa këto shkaqe ende vazhdojnë të jenë të pranishme, derisa nuk kemi rregullim të mirë të infrastrukturës së ujësjellësit dhe kanalizimit që do kishte “efektin e dominosë” në ngritjen e cilësisë së ujit të pijshëm.

## Karakterizimi i flukseve

Gjatë përdorimit të ujit të pasigurt mund të vijë deri te përhapja e epidemisë edhe në grupet e tjera të popullatës. Pasi që janë të papritura nuk kanë lidhje me sezonë.

## Periudhat e rrezikut

Rreziku i paraqitjes së epidemisë është permanent, por mund të jetë më i theksuar gjatë periudhave të mungesës së ujit, restriksioneve të ujit për kohë më të gjatë, si dhe përdorimit të ujit nga pusët johigjienike.

## 13.3 Helmimet me ushqim

### Identifikimi i rrezikut

Produkte ushqimore, pa dyshim janë mes ideal për qëndrimin e mikroorganizmave patogjen, saprofitë dhe kushtimisht saprofit, andaj ushqimi është rrugë ideale për transmetimin e sëmundjeve ngjitëse.

Me ushqim të kontaminuar me mikroorganizma patogjene mund të vijë deri te këto sëmundje:

1. Infeksionet alimentare-kontaminimi i produkteve ushqimore me mikroorganizma patogjene, të cilët pasi që futen në organizëm, pas një inkubacioni të caktuar vjen te lajmërimi i sëmundjes ngjitëse. Të tilla janë: Tifo abdominale, Paratifo, Kolera, Dizenteria, Hepatit ac. A, Tuberkulozi, Bruceloza etj.
2. Tokso-infeksionet alimentare vijnë si pasojë e konsumimit të ushqimit të ndotur me mikroorganizma të cilët pastaj zbërthehen në zorrë, duke liruar endotoksinat e tyre. Shkaktaret më të shpeshtë janë Sallmonella, Shigella, E. Coli, B. Faecalis Alkaligenes, B. Proteus etj.
3. Intoksikimet alimentare – janë kontaminimi i ushqimit me mikroorganizma patogjen të cilët më pastaj në gjërat ushqimore lirojnë ekzotoksinat e tyre si Staphylococcus aureus, Clostridium botulinum.
4. Invazionet alimentare-kontaminimi i ushqimit me parazit si Trihinella spiralis, Ehinococcus granulosus.

Gjatë helmimeve me ushqim me siguri se kujdes të veçantë duhet kushtuar moshave të shtyra, grave shtatzëna, të sëmurëve dhe fëmijëve. Kësaj kategorie të njerëzve duhet t'ju sigurohet optimumi fiziologjik i kalorive, proteinave (sidomos atyre animale), si dhe të gjitha materiet mbrojtëse si kompleksi i vitaminave B.

### **Faktorët e përkeqësimit**

Përkeqësimi vjen si pasojë e moszbatimit të masave higjienike - sanitare, në lokalet shoqërore dhe private. Furnizimi me ushqim të kontaminuar dhe të pakontrolluar (pasoje e mënyrës joadekuate të përgatitjes dhe ruajtjes së ushqimit dhe produkteve të saj, mënyra johigjienike e të ushqyerit të fëmijëve me qumështin e nënës dhe ushqimeve tjera etj.), Shpërndarja joadekuate e mbeturinave (sidomos në zonat rurale). Mungesa e edukatës shëndetësore të popullatës në lidhje me mbajtjen e higjienës personale, familjare (doket, veset etj) e veçanërisht në larjen e duarve para bukës dhe pas shkuarjes në WC etj.. Situata epidemiologjike me këto helmime në Kosovë është e pasigurt për arsye të kushteve të rënda socio- ekonomike, nivelit të ulët të kulturës higjienike të masës, mos respektimit të parimeve themelore higjienike në manipulimin me gjëra ushqimore.

Nuk kemi të dhëna të sigurta mbi helmimet me ushqim pasi që nuk bëhet paraqitja e saktë dhe e rregullt e këtyre rasteve pasi që shumica trajtohen në mënyrë ambulatorë.

### **Karakterizimi i flukseve**

Epidemitë alimentare shpërthejnë në mënyrë eksplozive. Sëmuren një numër i madh i personave që kanë konsumuar ushqimin e kontaminuar. Gjatë këtyre epidemive mund të sëmuren 30-40 % të atyre që e kanë konsumuar ushqimin e kontaminuar. Epidemitë marrin karakter dramatik pasi që përfshihen një numri i madh i të sëmurëve.

### **Periudhat e rrezikut**

Paraqiten më shpesh gjatë sezonës së verës ku kemi koncentrimet e grupeve më të mëdha të njerëzve në objekte hoteliere, mensat e studenteve, përdorimi i produkteve të qumështit (akulloret), ushqimet e shpejta (FAST FOOD).

### **Sëmundjet ngjitëse**

- Gripi pandemik : Gripi i shpendëve, Gripi i ri (derrave),
- Sëmundjet bio terroriste (Ethet hemorragjike, Brucelozë, Tularemia),
- Epidemitë e papritura,
- Helmimet masive me ujë dhe ushqim.

## 13.4 Gripi pandemik

Gripi tanimë është sëmundje sezonale. Zakonisht fillon nga muaji Tetor e vazhdon deri në muajin Maj të vitit pasues (nga java e 40 deri në javën 20 të vitit pasues). Përhapet me rrugë aerogjene nga personi i sëmurë në personin e shëndoshë, andaj numri i personave të infektuar në rast epidemie mund të jetë i madh. Sipas ekspertëve virusi i Gripit konsiderohet të jetë mutacion i 4 nëntipave të virusit A. Virusit përhapet me rrugë aerogjene gjatë kollitjes, teshtitjes si dhe gjatë kontaktit me gjësendet e kontaminuara. Burim i infeksionit është njeriu i sëmurë. Me rëndësi është se infeksioni bartet direkt nga njeriu, por edhe nga kafshët (derrat) apo edhe shpezët e sëmura tek njeriu i shëndoshë. Varësisht nga lloji i virusit që është në qarkullim, sëmundja mund të merr karakter epidemie apo pandemie.

Deri më sot janë regjistruar tri pandemi të mëdha në botë:

- Gripi spanjoll i vitit 1918/19,
- Gripi aziatik i viteve 1957-1958,
- Gripi i Hong Kongut i viteve 1968-1969.

Duke u bazuar në përvojën historike dhe karakteristikat biologjike të virusit të gripit, një pandemi tjetër globale është e pa evitueshme. Andaj përgatitja dhe përgjigja epidemiologjike mundëson parandalimin e valës goditëse apo së paku shtyrjen e shpërthimit masiv të pandemisë. Pasojat pas shpërthimit pandemik do të ndihen si në aspektin human, ashtu edhe në atë ekonomik.

Në fillim të qershorit kur janë regjistruar rastet e infeksionit me virusin H1N1 në shumë vende të botës, OBSH ka shpallur pandeminë e Gripit të ri duke theksuar se tani më virusi është i rrezikshëm.

Rasti i parë i konfirmuar i Gripit të ri H1N1 në Kosovë është regjistruar në korrik të vitit 2009. Nga korriku i vitit 2009 gjer më 15 nëntor 2009, janë regjistruar 39 raste të konfirmuara të gripit ( janë përfshirë edhe 3 rastet nga vendet e banuara me popullatë serbe).

### Faktorët e përkeqësimit

Duke marrë parasysh se infeksioni mund të merr përmasa pandemie (përfshin shumë shtete) faktorë i përkeqësimit është grumbullimi në vende publike dhe lëvizja e njerëzve nga një vend në tjetrin dhe kontrolli jo i rregullt veterinar i fermave ekzistuese.

### Karakterizimi i flukseve

Numri më i madh i rasteve pritet të jetë gjatë fundit të vjeshtës dhe gjatë dimrit edhe pse nga paraqitja e rastit të parë e gjer më tani, sëmundja është paraqitur edhe gjatë muajve të verës.

### Skenarët më të mundshëm

Janë adaptuar dy skenarë, përkatësisht i lehtë dhe i ashpër i pandemisë, për qëllim planifikimi. Këta skenar janë bazuar në përvojat e fituara në pandemitë e kaluara. Sipas **skenarit të lehtë** shkalla e sulmit 30%, numri i të sëmurëve 660.000, shkalla e vdekshmërisë 0.23%, numri i vdekjeve 1518. Sipas **skenarit të ashpër** shkalla e sulmit 30%, numri i të sëmurëve 660.000, shkalla e vdekshmërisë 2,1%, numri i vdekjeve 13.860.

Vdekshmëria në Kosovë, një vend me popullsi të re, mund të jetë relativisht e lartë pasi që pandemitë në të kaluarën kanë prekur në veçanti popullsinë e re.



### 13.5. Ethet Hemorragjike - Krime Kongo

Prej vitit 1989 e deri në vitin 2008 në shkallë vendi, regjistrohen 403 raste të konfirmuara të Etheve Hemorragjike - Krime Kongo me 46 të vdekur. Vetëm pas luftës janë raportuar 105 raste të sëmundjes me 8 të vdekur. Është sëmundje e cila paraqitet për çdo vit në vendin tonë.

EHKK është sëmundje ngjitëse virale që karakterizohet me sindrome të theksuar hemorragjike (gjakderdhje), shfaqet në vatra natyrore, pas pickimit të këpushave (rriqrave) gjatë sezonës pranverë-vjeshtë.

Ethet Hemorragjike - Krime Kongo, është sëmundje e rëndë ngjitëse e shkaktuar nga virusi me të njëjtin emër. Sëmundja radhitet ndër sëmundjet ngjitëse më vrastare të kohës pas Eboles. Letaliteti të kjo sëmundje sillet prej 20 - 50%. Sëmundja përhapet me rriqra të familjes Hyaloma (e njohur me emrin Hyaloma Marginatum), si dhe me gjakun e personave të prekur nga kjo sëmundje. Një karakteristikë e këtyre rriqrave është se pickojnë pa dhembje, e durojnë urinë me muaj deri në tre vite dhe e bartin infeksionin në mënyrë transovariale (prej gjenerate në gjenerate). EHKK është karakteristike për vendet me klime të butë, blegtori të zhvilluar, vise me shkurre që në tërësi i përgjigjet Kosovës Qendrore, duke përfshirë komunat e: Malishevës, Rahovecit, Therandës, Klinës, Drenasit, Prizrenit, Gjakovës, Pejës dhe Skenderajt.

Krime-Kongo për herë të parë në Kosovë është regjistruar në fshatin Nishor të Therandës (ish Suharekës) në vitin 1954 në një familje, me tetë (8) të vdekur. Në vitin 1989, EHKK paraqitet sërisht në fshatin Kijevë të Klinës (sot komuna e Malishevës) në një familje me katër (4) të sëmurë dhe dy (2) të vdekur. Rastet e kësaj sëmundje paraqiten edhe gjatë viteve 1991 dhe 1992. Në vitin 1995, në Kosovë ka qenë e përhapur një epidemi masive me 65 raste të EHKK (të dyshimta) të shtrira në 47 vendbanime me incidencë më të lartë në këto komuna: Malishevë, Klinë, Rahovec, Skenderaj dhe Drenas. Që nga viti 1995 deri në vitin 2015 në Kosovë janë regjistruar 240 raste të sëmundjes së EHKK. Në po të njëjtën periudhë kohore nga kjo sëmundje kanë vdekur 61 raste. Gjatë kësaj periudhe kohore sëmundja është shtrirë në 107 vendbanime, kryesisht të shtrira në komunat e lartëcekura.<sup>36</sup>

#### Faktorët e përkeqësimit

Nuk ka dilemë se Krime Kongo është problem madhor i shëndetësisë kosovare e sidomos i shëndetësisë publike. Prej vitit 1989 kjo sëmundje fatale regjistrohet në mënyrë sporadike në pjesët e Kosovës Qendrore dhe Jug - Perëndimore. Kjo sëmundje sot regjistrohet në 55% të territorit të Kosovës gjë që e bën edhe më alarmante situatën.

#### Karakterizimi i flukseve

Prej vitit 1995 e deri në vitin 2008, EHKK është regjistruar në 13 komuna apo në 37% të territorit të Kosovës. Duhet theksuar se këto komuna përbëhen prej 720 vendbanimeve rurale. Gjatë këtyre viteve, në 70 vendbanime rurale është regjistruar Ethja Hemorragjike Krime Kongo apo në 9.7% të tyre. Në viset e prekura jetojnë rreth 900 000 banorë (vlerësimi). Në përgjithësi mund të përfundojmë se janë 82 vatra hiperendemike me rrezik shpërthimi epidemik permanent apo vendbanimet më të rrezikuara në Kosovë për Ethen Hemorragjike Krime Kongo, janë këto vendbanime me përparësi hulumtimi. Nga shënimet e mësipërme mund të përfundojmë se në zonat e prekura nga Ethja Hemorragjike Krime Kongo jetojnë rreth gjysma e popullsisë së Kosovës dhe kjo e bën këtë problematike edhe më serioze.



Në të ardhmen e tërë veprimtaria parandaluese duhet të koncentrohet në këto vendbanime nëse dëshirojmë që sëmundja të mbahet nën kontroll dhe të pengohen shpërthimet epidemike.

### Skenari 1

*Skenari i ashpër* - Persona të pickuar nga rriqrat 7000, numri i të sëmurëve është 980 (14%) , shkalla e vdekshmërisë 20%, numri i të vdekurve 196.( zakonisht numri i të sëmurëve është 14% nga numri total i të pickuarve).

### Periudha e rrezikut

Sëmundja karakterizohet me paraqitje sezonale, zakonisht gjatë muajve të pranverës dhe verës. Numri më i lartë i rasteve të sëmundjes lajmërohet prej qershorit deri në shtator, kur dendësia dhe aktiviteti biologjik i rriqrave është jashtëzakonisht i shprehur. Rastet e sëmundjes fillojnë të paraqiten që nga muaji maj.

## 13.6: Bruceloza

Është sëmundje e cila shumë lehtë mund të shfrytëzohet për qëllime bio terroriste. Duke marrë parasysh se në Kosovë, një pjesë e konsiderueshme e popullatës merret me blegtori dhe niveli edukativo shëndetësor nuk është i kënaqshëm, Bruceloza si sëmundje dhe pasojat e saja rrezikojnë shëndetin publik në Kosovë në mënyrë permanente. Kjo sëmundje nëse nuk zbulohet me kohë dhe nuk trajtohet në mënyrë adekuate mund të lëjë invaliditet të përjetshëm. Nga kjo sëmundje më të rrezikuar janë veterinarët, barinjtë dhe amviset. Gjithashtu të rrezikuar janë edhe personat që merren me përpunimin e produkteve të kafshëve të sëmura si kasapët, punëtorët e thertoreve dhe lëkurëpunuesit, gjahtarët. Bruceloza mund të përhapet edhe pas konsumimit të produkteve të qumështit të papërpunuar (sidomos qumështi i dhisë). Gjerë më tani në Kosovë nuk janë të regjistruara raste të vdekjes nga kjo sëmundje.

Mirëpo, humbjet janë të mëdha në ekonomi (mungesat nga puna, invaliditeti i pacienteve, asgjësimi i kafshëve).

### Historiku

Bruceloza është sëmundje ngjitëse sistemike që shkaktohet nga bakteria e gjinisë *Brucella*. Sëmundja karakterizohet me rrjedhe akute apo të fshehtë, temperaturë intermitente me kohëzgjatje të ndryshme. Kjo sëmundja është zoonoze, e cila kryesisht haset tek kafshët shtëpiake (dhitë, gjedhet, delet, derrat dhe kuajt). Sëmundja konsiderohet jo kontagioze pasi nuk mund të bartet nga njeriu në njeri, por bartet nga kafsha e sëmurë në njeri. Sëmundja njihet që nga koha e Hipokratit. Të dhënat shkencore për këtë sëmundje datojnë që nga gjysma e dytë e shekullit XIX. Sëmundja për herë të parë është përshkruar me 1800 në ishullin Malte. Sëmundja është e përhapur në tërë botën. Shkalla e përhapjes është në lidhje të drejtpërdrejt me zhvillimin e blegtorisë dhe aplikimin e masave parandaluese. Situata epizotike dhe epidemike përkeqësohet dukshëm gjatë viteve '90. Në Kosovë, zonë endemike për Brucelozë konsiderohet i tërë territori. Nga të dhënat e IKSHPK nga viti 1985 gjerë më 2008, janë raportuar 1798 raste të brucelozës me 1 të vdekur në vitin 1993 në Therandë. Raste të brucelozës viteve të fundit janë regjistruar në formë të epidemive familjare me një mesatare prej 30 raste gjatë vitit. Në vitin 2013 ishin 63 raste, në 2014 ishin

34 raste. Sëmundja ishte e shprehur jo vetëm ndër familjet me blegtori të zhvilluar, por edhe me raste tjera sporadike<sup>37</sup>.

### Faktorët e përkeqësimit

Faktori i përkeqësimit është kontrolli jo i rregullt veterinar i fermave ekzistuese, si dhe amvisërive që mbajnë këto shtazë shtëpiake.

Shitblerja e pakontrolluar e shtazëve, mishit, qumështit dhe produkteve të tyre, si dhe përpunimi joadekuat i këtyre prodhimeve.

### Karakterizimi i flukseve

Sëmundja ka karakter sezonal edhe pse regjistrohet gjatë tërë vitit.

### Skenari 1

Shkalla e sulmit është 0.03%, numri i të sëmurëve është 600. Disponueshmëria me antibiotikë dhe nivel të edukimit shëndetësor mund të reduktoj sëmundshmërinë.

## 13.7. Tularemia

Duke marrë parasysh se sëmundja ka karakter endemik në Kosovë rreziku i paraqitjes së sëmundjes është permanent, sidomos kur dihet fakti se shumë lehtë mund të përdoret për qëllime bio terroriste.

Tularemia është sëmundje kryesisht e kafshëve, posaçërisht e brejtësve. Në kushte natyrore sëmundja shfaqet te më shumë se njëzet lloje kafshësh të egra dhe shtëpiake. Sëmundja bartet në njerëz përmes ujit/ushqimit të kontaminuar, ajrit të ndotur dhe me rriqra. Sëmundja prek të gjitha grup-moshat. Për herë të parë sëmundja është përshkruar në vitin 1653 në Norvegji. Tularemia nuk ka qenë asnjëherë e pranishme në Kosovë më herët, qoftë me tablo klinike të qartë apo në formë atipike. Rastet e para të sëmundjes në Kosovë janë paraqitur në Rajonin e Gjakovës, fshatin Brovinë në vitin 2000. Përderisa, sëmundja në fillim kishte shtrirje në Rrafshin e Dukagjinit, në vitet pasuese ishte përfshirë Rrafshi i Kosovës. Kështu sot tularemia ka përfshirë gjithë territorin e Kosovës<sup>38</sup>.

Gjerë më tani në Kosovë janë lajmëruar dy valë të epidemisë ajo e vitit 1999-2000 me 245 raste dhe ajo e vitit 2000-2001 me 338 raste. Në vitet pasuese rastet e sëmundjes ishin sporadike, por megjithatë konsiderohet si numër i lartë, 784 raste me shkallë mesatare të smundshmërisë 6.7 të sëmurë në 100 000 banorë. Në fund të vitit 2014 janë shtuar rastet e tularemisë,( të raportuara 105 raste me shkallë të sëmundshmërisë 5.8 në 100 000 banorë). Si zonë endemike me këtë sëmundje, ka pasur raste sporadike në mes dy valëve të epidemisë.

### Karakterizimi i flukseve

Sëmundja ka kryesisht karakter sezonal. Më tepër lajmërohet në vjeshtë, dimër dhe fillimin e pranverës, por, nuk përjashtohet mundësia e paraqitjes së rasteve gjatë tërë vitit.

37 Shih në shtojcë, harta nr 29. Zonat endemike me brucelozë në Kosovë

38 Shih ne shtojcë, harta nr 30. Zonat endemike te tularemise ne Kosove

## Skenari 1

Shkalla e sulmit është 0.05%, numri i të sëmurëve është 1000.

Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV) përmes Departamentit të Shëndetit të kafshëve duke u bazuar në Legjislacionin në fuqi, bën monitorimin e sëmundjeve të kafshëve në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

Si Ligj bazë për këtë departament është Ligji mbi Veterinarinë nr 21/2004 i aprovuar dhe miratuar me datën 31.07.2004 nga Kuvendi i Kosovës.

Prej vitit 2004 është punuar në hartimin e legjislacionit sekondar Udhëzimeve Administrative për kontrollin, preventiven dhe parandalimin e sëmundjeve të kafshëve, sipas programit të parë dhe të dytë të këtij ligji, duke e harmonizuar këtë legjislacion me legjislacionin e BE-së.

Ky departament e bën mbikëqyrjen e Shëndetit të Kafshëve të mëdha dhe të imta, peshqve, dhe bletëve duke u bazuar në marrjen e mostrave nga terreni për hulumtime diagnostike dhe dërgimin e tyre në Laboratorin Veterinar të Kosovës (LVK), dhe në raste specifike bëhet dërgimi i mostrave në Laboratorë Referent për konfirmimin përfundimtar të diagnozës.

Nga ana e këtij departamenti, implementohen edhe programet e vaksinimeve preventive për çdo vit, të cilat janë të planifikuara sipas Planit Qeveritar për sëmundjet, siç janë:

Tërbimi, Anthraxi, Mortaja Klasike e Derrave, Mortaja Atipike e Shpezëve dhe në vitin 2010 planifikohet implementimi i vaksinimit të deleve dhe të dhive në sëmundjen e Brucelozës.

Profili i rrezikut	
<b>Rreziku:</b> Rreziqet epidemiologjike.	
<b>Madhësia e mundshme (Përqindja e komunitetit që mund të goditet):</b> Kritike: 25 deri 50%.	
<b>Shpeshtësia e ndodhjes:</b> ▪ Shumë e mundshme: Mundësia afër 100% në vitin e ardhshëm.	<b>Modeli sezonal:</b> Verë /dimër.
<b>Zonat që mund të goditen më së shumti:</b> Tërë territori.	
<b>Kohëzgjatja e mundshme:</b> Permanente.	
<b>Shpejtësia e mundshme e mësymjes (afatet e mundshme të kohës së paralajmërimit):</b> Më shumë se 24 orë.	
<b>Sistemet ekzistuese të paralajmërimit:</b> Nuk ka.	
<b>A ekziston analiza e dobësive/cenueshmërisë?</b>	
Po	<input type="checkbox"/>
Jo	<input type="checkbox"/>

**Cënueshmëria nga goditjet në faktorët kyç të komunitetit**

Profili	Pasojat e mundshme	Shkalla e goditjes
Banorët	Vdekje / helmime masive ( për shkak të kontaminimit të ujërave, tokës dhe ambientit).	E ashpër
Pasuria	Shkatërrim/dëmtim i pasurisë publike dhe private ( shpenzime të mëdha në parandalimin e përhapjes së epidemive).	E ashpër
Infrastruktura vitale	Kontaminim i rrjetit të ujësjellësit, të puseve, burimeve tjera.	E ashpër
Objektet e rëndësisë së veçantë	Kontaminim i ujërave ( në ndërtesa të administratës, banka, zyra, objekte shkollore, objekte qeveritare, dyqane, qendra tregtare, restorante, etj).	E ashpër
Dëmet ekonomike	Kontaminim i infrastrukturës vitale, pasurisë, infrastrukturës teknike, etj.	E ashpër
Ambienti	Degradim i mjedisit ( për shkak të kontaminimit të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore).	E ashpër
Trashëgimia kulturore		E ultë
Shërbimet shtetërore	Dëmtim i shërbimeve shtetërore dhe shërbimeve për qytetarë.	E mesme
Shërbimet emergjente	Dëmtim/kontaminim i mjeteve dhe pajisjeve të njërive reaguese emergjente.	E mesme

**Skenarët e mundshëm**

**Skenari 1.** Ndotja me prejardhje kimike.

**Skenari 2.** Ndotja nga hidrokarburet.

**Skenari 3.** Rrezatimi radiolog.

## XIV. TRASHËGIMIA KULTURORE

### 14.1 Gjendja aktuale

Trashëgimia kulturo-historike shprehë identitetin e shoqërisë kosovare nëpër shekuj. Për shkak të injorimit të gjatë të një trashëgimie të tillë, gjatë regjimit të mëparshëm dhe më vonë me konfliktin e vitit 1999, trashëgimia kulturore dhe natyrore ka përjetuar degradim të madh. Me sulmet e vonshme të Marsit 2004, trashëgimia e rrezikuar u gjuajt përsëri, duke lënë një numër të objekteve të trashëgimisë kulturore dhe fetare (disa kisha) plotësisht të shkatërruara. Këto veprime treguan mungesën e vetëdijes dhe respektit të autoriteteve dhe popullatës ndaj trashëgimisë së tyre. Kjo, dhe mungesa e besimit në nivelet administrative dhe politike, ka keqësuar përparimin e dialogut mes komuniteteve në Kosovë mbi çështjet e trashëgimisë kulturore.

Bjeshkët e Nemuna janë pjesë tjetër e rëndësishme e biodiversitetit të Ballkanit, me gjithsej 750 lloje, prej të cilave 18 janë vendore dhe 100 të tjera janë lloje që rriten vetëm në Ballkan. Prioritet yni është shfrytëzimi i trashëgimisë për zhvillimin e turizmit dhe rekreacionit, ruajtja, mbrojtja dhe monitorimi i saj. Trashëgimia kulturo-historike - Zonat dhe objektet e trashëgimisë datojnë nga të gjitha periudhat historike. Sot, ato gjithnjë e më tepër po u ekspozohen ndikimeve që i rrezikojnë vlerat burimore të tyre, të manifestuara si rrënim i pjesërishëm ose i tërësishëm, mbindërtim, ndryshim destinimi, shkatërrim të mjedisit dhe ndërhyrje tjetër degraduese. Në bazë të dhënave momentale del se: 18 komuna posedojnë projekte për objekte me vlerë kulturo-historike (46% të përdorshme), 9 komuna nuk kanë projekte të tilla, kurse nuk janë deklaruar 2 komuna. Sipërfaqja e zonave me vlerë trashëgimore nën mbrojtje është 300 hektarë (për 14 komuna) kurse të tjerat nuk e kanë të definuar këtë sipërfaqe. Në shumicën e vendbanimeve komunale ekzistojnë ndërtime ilegale në zonat të cilat janë nën mbrojtje dhe kjo dukuri ende vazhdon. Përderisa, në vetëm disa sosh (7) është punuar në konservimin dhe restaurimin e objekteve dhe zonave me vlerë.

Në bazë të shënimeve ekzistojnë një numër i madh i objekteve që radhiten në listën e objekteve me vlerë trashëgimie si: Muzeu Arkeologjik dhe 99 lokalitete, shtëpi banimi (412 sosh), kulla (1570), qendra zejtare, xhamia (288), mejtepe (23), kisha (90), kisha katolike (19) kisha ortodokse (20), teqe (30), tyrbe (104), varreza (114), varreza islame-shqiptare (10), eshtore (1), manastire (11), hotel (1) dhe kanjon (1) etj. Shfrytëzimi trashëgimisë kulturo-historike për zhvillimin e turizmit dhe shprehja e identitetit të shoqërisë kosovare nëpër shekuj. Mbrojtja, ruajtja dhe mirëmbajtja e mjaftueshme e kësaj trashëgimie do të ishte kërkesë e kohës për shoqërinë në përgjithësi.<sup>39</sup>

**Tabela 21. Lista e institucioneve dhe monumenteve më rëndësi të veçantë.**

Emërtimi	Vendndodhja
Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve Kulturore	Prishtinë
Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve	Prishtinë
Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve	Pejë
Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve	Prizren
Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve	Gjakovë
Qendra për Trashëgimi Kulturore	Gjilan
Qendra për Trashëgimi Kulturore	Mitrovicë
Muzeu Kombëtar i Kosovës	Prishtinë
Kompleksi Muzeor “ Emin Gjiku”	Prishtinë
Muzeu Etnologjik	Gjakovë
Muzeu Etnologjik	Pejë
Muzeu – Mitrovicë	Mitrovicë
Muzeu Arkeologjik	Prizren
Kompleksi Muzeor “ Lidhja Shqiptare e Prizrenit”	Prizren
Kompleksi “ Adem Jashari”	Prekaz
Kompleksi “ Haxhi Zeka”	Pejë
Arkivi i Kosovës	Prishtinë
Arkivi Ndërkomunal	Prishtinë
Arkivi Ndërkomunal	Gjakovë
Arkivi Ndërkomunal	Gjilan
Arkivi Ndërkomunal	Pejë
Arkivi Ndërkomunal	Prizren
Arkivi Ndërkomunal	Mitrovicë
Biblioteka Kombëtare e Kosovës	Prishtinë
Biblioteka Ndërkomunale “ Hivzi Sulejmani”	Prishtinë
Biblioteka e Verbërve “ Syri Ynë”	Prishtinë
Biblioteka Nërkomunale “Anton Çeta”	Ferizaj
Biblioteka Nërkomunale “Asim Vokshi”	Gjakovë
Biblioteka Nërkomunale “Fan S. Noli”	Gjilan
Biblioteka Nërkomunale “Latif Berisha”	Mitrovicë
Biblioteka Nërkomunale “Azem Shkreli “	Pejë
Biblioteka Nërkomunale “Sveti Sava”	Leposaviq
Biblioteka - Prizren	Prizren
Teatri i Kombëtar i Kosovës	Prishtinë
Teatri Profesional – Gjakovë	Gjakovë
Teatri Profesional – Gjilan	Gjilan
Teatri Profesional – Prizren	Prizren
Teatri Profesional – Pejë	Pejë
Teatri Profesional – Mitrovicë	Mitrovicë
Teatri Profesional – Ferizaj	Ferizaj
Orkestra e Filarmonisë dhe Operës së Kosovës	Prishtinë
Ansambli i Këngëve dhe Valleve - “ SHOTA”	Prishtinë
Galeria e Arteve e Kosovës	Prishtinë
Kompleksi Isa Boletini – Boletin	Boletin

## XV. STRUKTURAT PËR MBROJTJE, SHPËTIM DHE NDIHMË

### 15.1 Kategorizimi i SSHMN-ve

Njësitë e SSMHN-ve janë themeluar <sup>40</sup> sipas qëllimit si në vijim:

- Njësitë për intervenime të specializuara,
- Njësitë e specializuara, dhe
- Njësitë për intervenime të përgjithshme.

Ndërsa këto struktura sipas kategorive të tyre ndahen në:

- Njësia për mbrojtje dhe shpëtim nga rrënojat - KSHU,
- Njësia për mbrojtje dhe shpëtim nga ujërat, dhe
- Njësia për mbrojtje dhe shpëtim nga lëndët kimike, biologjike, radiologjike dhe nukleare - KBRN,
- Njësia për logjistikë.

Në Republikën e Kosovës momentalisht funksionojnë 35 Njësi Profesionale të Zjarrfikjes dhe Shpëtimit, me 787 zjarrfikës dhe 224 automjete për intervenime të ndryshme.



## XVI. VLERËSIMET PËRFUNDIMTARE

Bazuar në historikun e të dhënave për fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, Republika e Kosovës nuk iu është ekspozuar një rreziku të përmasave të mëdha, por kjo nuk nënkupton që në të ardhmen e afërt vendi ynë nuk do të përballet me fatkeqësi të natyrave të tilla, marrë për bazë ndryshimet klimatike në botë dhe zhvillimin e hovshëm tekniko-teknologjik, të cilat mund të jenë indikator të rreziqeve dhe kërcënimeve të shumëllojshme.

Aktivitetet e përbashkëta të institucioneve përgjegjëse në fushën e menaxhimit dhe reagimit në raste fatkeqësish, pastaj personave juridik dhe fizik, nga niveli qendror deri te ai lokal, do të jenë garanci për sigurinë tonë kombëtare.

Kapacitetet ekzistuese ( resurset humane dhe teknike ) si forcë reaguese për mbrojtje dhe shpëtim ende nuk kanë arritur nivelin e dëshirueshëm, prandaj kërkohet ngritje më e lartë profesionale me qëllim të rritjes së efikasitetit dhe efektivitetit të tyre reagues, përmes trajnimeve profesionale, testeve të nivelit të gatishmërisë me anë të ushtrimeve të ndryshme si dhe bashkëpunimit rajonal.

Ky dokument i vlerësimit të rreziqeve në të ardhmen do të shërbejë si pikë referente për Planin e Reagimit Kombëtar (PRK), planifikimin hapësinor, hartimin e dokumentit të vlerësimit të rreziqeve në nivel lokal, etj.

Me qëllim të integritetit të akterëve të ndryshëm në menaxhimin emergjent duhet realizuar një sërë prioritetesh dhe detyra:

- Implementimi i Ligjit për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera dhe konsolidimi me resurse njerëzore, materiale dhe financiare, në mënyrë që të fuqizohen kapacitetet e duhura operative për reagim emergjent efikas.
- Harmonizimi i ligjeve tona dhe arritja e kompatibilitetit në fushën e Menaxhimit Emergjent me ato BE -së, të strukturave për mbrojtje shpëtim dhe ndihmë, në aspektin teknik, operativ dhe strategjik, në mënyrë që të jenë të gatshme të veprojnë edhe jashtë vendit, me forcat si motra ndërkombëtare.

Zbatimi i masave parandaluese në planifikimin hapësinor me qëllim të zvogëlimit të rreziqeve, si dhe pasojave të rreziqeve nga fatkeqësitë.

Aplikimi i praktikave më të mira në masat për mbrojtjen e shëndetit dhe jetës të njerëzve, si dhe ruajtjen e ambientit për gjeneratat e ardhshme.

Hartimi, zhvillimi dhe aplikimi i programeve aftësuese për koordinim dhe drejtim i të gjitha forcave operative për mbrojtje dhe shpëtim në nivel kombëtar, në nivel të njësive regjionale dhe lokale, si dhe në aspektin e projekteve bilaterale dhe multilaterale për bashkëpunim ndërkombëtar në fushën e mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës.

Ndihma reciproke ndërkombëtare në rast të fatkeqësive


Rekomandimet e Gr.Punues

1. Hartimi i Planeve parandaluese /preventive për secilin nga institucionet, bazuar në vlerësimin e rreziqeve.
2. Hartimi i një programi të ushtrimeve dhe gadishmërisë emergjente në nivel vendi, si dhe ndarja e një fondi permanent / për çdo vit, për mbajtjen e ushtrimeve për FNFT.
3. Grupi punues rekomandon që të ngritet në nivel vendi një fond me vlerë prej një milion Euro, për reagim emergjent në nivel vendi, bazuar në historikun e rreziqeve, si dhe vlerësimin e dëmeve të mundshme që mund të shkaktohen nga FNFT.
4. Organizimi i punëtorive për ndërtimin dhe ushtrimin e skenarëve ( TTX ) për zyrtarët e ministrive dhe agjencive relevante. Kostoja e përgjithshme buxhetore 25500 euro.




## XVII. HARTAT


Harta nr 1. Ndarja administrative e komunave të Republikës së Kosovës.



Harta nr.3. Gjeologjia e Kosovës.




Harta nr 4. Shpërndarja e objekteve shkollore.






**Harta nr 5 .Vatrat e zjarreve pyjore.**




Harta nr.6. Rreziku nga vërshimet.







Harta nr.7. Zonat e prekura nga vërshimet.




**Harta nr 8. Sizmiciteti ( Harta e epiqendrave të tërmeteve në territorin e Kosovës, periudha 1456-2014 ).**




Harta nr.9. Zonat e rrezikut sizmik në Kosovë.




Harta nr 10. Zonat me rrëshqitje.



**Harta nr.11. Zonat me rrokullisje të shkëmbinjve.**




Harta nr 12. Lokacionet e minierave sipërfaqësore ( guroreve) në Kosovë.






Harta nr.13. Deponitë minerare në Kosovë







Harta nr 14. Gjeorreziqet në Republikën e Kosovës.




Harta nr 15. Rrjeti Mikrovalor.



Harta nr 16. Rrjeti Optik.



Harta 17.Rrjeti i infrastrukturës rrugore.






Harta nr. 18. Rrjeti i rrugëve kryesore dhe rajonale.




Burimi: Ministria e Infrastrukturës.

Harta nr.19. Qarkullimi ditor i veturave private.





Harta nr. 20. Qarkullimi ditor i autobusëve.






Hara nr.21. Rrjeti hekurudhor i Kosovës.



Burimi nga: Studimi për rehabilitimin e hekurudhës 10

Harta nr.22.Aeroporti ndërkombëtar.





Harta nr.26 Hidrologjia e Kosovës.






Harta nr 27 Zonat e goditura artilerike me përmbajtje të uranit të varfëruar.



Harta nr 28 Zonat endemike me EHKK në Kosovë.






Harta nr 29 Zonat endemike me Brucelozë në Kosovë.




Harta nr 30 Zonat endemike të Tularemisë.




Harta nr 31. Lumenjtë e Kosovës.



Harta nr 32 Deponitë dhe vendgrumbullimet e mbeturinave në territorin e Kosovës.



Harta nr. 33. Minerat pasive në Kosovë.



**Legjislacioni**

- Ligji për Pyjet, 2003/6), (2004/40) me plotësimet e tij,
- Ligji për Konservimin e Natyrës (2006/22),
- Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit (2003/9),
- Ligji për Ujërat (2004/41),
- Ligji për Planifikim Hapësinor (2003/30),
- Ligji për Parkun Nacional Mali i Sharrit (1986),
- Ligji për Gjuetinë (2006/41),
- Ligji për Peshkatari dhe Akuakulturë (2006/58),
- Ligji për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera,
- Ligji për Zjarrfikje dhe Shpëtim,
- Ligji për Mbrojtje nga Zjarret,
- Dokumenti për Politike dhe Strategji për Zhvillimin e Sektorit të Pylltarisë 2010-2020,
- Dy Inventarizime Nacionale të Pyjeve (2003 dhe 2012),
- Planet Menaxhuese për Njësitë Menaxhuese (në dixhital),
- Softueri Fis-Kos,
- Marrëveshje të ndryshme sektoriale.

## Udhëzimet administrative për:

- Vlerësimin e ndikimit mjedisor (Nr.09/2004-MESP),
- Formën dhe mënyrën e mirëmbajtjes së Regjistrit qendror të zonave të natyrës për konservim (Nr.04/2006-MMPH, Shtator 2006 ),
- Strategjia për zhvillimin e pyjeve, 2010-2020,
- Udhëzimi administrativ, MA-Nr. 22/2007'' për mbrojtjen e pyjeve nga zjarret pyjore,
- Udhëzues terreni për pylltari,
- Manual të ndryshëm.

Rregullore nr 28/2012 për metodologjinë e hartimit të vlerësimit të rrezikshmërisë.

Rregullore (QRK) nr.28/2015 për organizimin e njërive të strukturave për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë.



VLERËSIMI I RREZIQEVE NGA  
FATKEQËSITË NATYRORE DHE  
FATKEQËSITË TJERA

---

Prishtinë  
Korrik, 2016